HYRJE

Ky libër mësuesi është organizuar dhe shtjelluar në përshtatje të plotë me tekstin mësimor të letërsisë 10, i cili është ndërtuar mbi bazën e programit të Letërsisë 10, si pjesë e ***fushës Gjuhët dhe Komunikimi.*** Ai u vjen në ndihmë mësuesve që do të përdorin këtë tekst në disa drejtime:

- Së pari këtu do të gjejnë në mënyrë të detajuar ***planin sintetik dhe analitik vjetor*** të ndarë në tre tremujore siç kërkohet. Plani ruan kronologjinë dhe shpërndarjen sipas tekstit mësimor, i cili është menduar mirë për të qenë praktik, i larmishëm dhe sa më pak i lodhshëm.
- Plani mësimor është konkretizuar duke pasur parasysh të mësuarit me bazë ***kompetencat*** si më poshtë:
  - kompetencat e komunikimit dhe të të shprehurit;
  - kompetencat e të menduarit;
  - kompetencat e të nxënit;
  - kompetencat për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
  - kompetencat qytetare;
  - kompetencat digjitale.
- Në mënyrë që nxënësi t'i fitojë këto kompetenca, mësuesit në këtë libër pune i jepen disa ***metoda*** që u shkojnë për shtat temave mësimore dhe rubrikave të tekstit. Ja cilat janë disa nga prej tyre:
  - nxjerrja e informacionit të ri nga teksti, mbajtja e shënimeve, leximi i pjesshëm, leximi i strukturuar, leximi koherent etj.;
  - krijimi i skedave;
  - harta e personazheve dhe e koncepteve;
  - loja me role;
  - puna me projekte;
  - puna me fokus të veçantë;
  - stuhia e mendimeve;
  - puna e drejtuar;
  - aktiviteti në grup;
  - punë dhe krijimtari e pavarur;
  - piramida e mendimit;
  - pema e mendimit;
  - diskutimi;
  - analiza;
  - vlerësimi;
  - shpjegimi hap pas hapi;

- di-dua të di-mësova;
- tabela T;
- pyetje - përgjigje;
- ditari dypjesësh;
- llojet e shkrimeve funksionale si: parafraza, përmbledhja e strukturuar, zgjerimi i kuptimit, reflektimi përmes mesazheve, komente mbi opinione të ndryshme, shpjegime të vazhdueshme, ese, portretizime, përshkrime etj.

- Ndarja ***rezultatet e të nxënit*** u jep mësuesve disa alternativa mbi pritshmërinë e të nxënit te nxënësi për secilën temë mësimore. Dhënia e tyre ndihmon në përcaktimin e duhur të strategjisë për të qenë efektiv në secilën temë dhe për të gjitha nivelet e nxënësve.
- E rëndësishme është konceptuar edhe dhënia e disa prej fjalëve ***kyçe*** për temat referuese. Përcaktimi i tyre përmbledh në të njëjtën kohë përqendrimin më të madh të konstatimit, të analizës dhe të vlerësimit. Ato u jepen nxënësve për të menaxhuar kujtesën dhe për ta bërë të menduarit përzgjedhës dhe të matshëm. Këto fjalë ndihmojnë për të kuptuar informacionet dhe detajet më të rëndësishme në një temë mësimore.
- ***Rubrika e vlerësimit*** është vetëm një kujtesë që mësuesi të motivojë nxënësit përmes saj. Veçanërisht jemi ndalur te rekomandimi i vlerësimit gjatë punës në grupe, me projekte dhe asaj që zbulon dhe zhvillon kreativitetin.
- ***Burimet*** janë referuar drejt tekstit mësimor, teksteve metodologjike, drejt veprave dhe autorëve të tyre si edhe drejt informimit të shumëfishtë përmes internetit. Kjo e fundit ndihmon edhe në perspektivën digjitale të mësimdhënies për këtë lëndë.
- Teksti i mësuesit u rekomandon mësuesve aftësi integruese, u kujton atyre kujdesin në ***lidhjen me shkencat e tjera*** dhe sidomos aftësitë pedagogjike dhe eksploruese të tyre.
- Çdo rubrikë ndihmon që të realizohet duke njohur ***psikologjinë e secilit nxënës, elementet sociale të auditorit dhe filozofinë e menaxhimit të situatave*** për të përftuar një performancë sa më të lartë të nxënësve në klasë.
- Teksti ngacmon aftësitë personale të mësuesve, duke u kujtuar atyre metodat dhe jo duke ua diktuar ato.
- Në këtë tekst mësuesi do të gjejë material ndihmës për të gjitha ***llojet e temave si***:
  - tema mbi teorinë e letërsisë;
  - tema mbi folklorin;
  - tema mbi rrymat letrare;
  - tema mbi jetën dhe veprën e autorëve;
  - tema mbi analizat e veprave;
  - tema mbi komentet, analizat dhe vlerësimet e fragmenteve nga veprat letrare përkatëse;
  - tema mbi bisedat letrare;
  - tema mbi orët e dramatizimeve;
  - tema mbi orët shkrimore si parafraza dhe përmbledhja etj.;
  - tema për përsëritjet;
  - tema mbi testimet.

Ju urojmë ***suksese*** në punën me këtë tekst ndihmës.

Përmbajtja

Hyrje 3

Plani mësimor 6

Plani analitik për tremujorin e parë (shtator - dhjetor) 10

Plani analitik për tremujorin e dytë (janar - mars) 16

Plani analitik për tremujorin e tretë (prill - maj) 21

Planifikimi i orës mësimore 27

Modele testi 153

PLANI MËSIMOR
FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI
LËNDA: LETËRSI
KLASA X

Plani sintetik
36 javë x 2 orë = 72 orë

	Kompetencat e fushës		Shkathtësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1.	Kompetencat që do të zhvillojë nxënësi: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale	70%	Njohurive të reja në: • Teori letërsie • Folklor • Rryma letrare • Jetë dhe vepër autori • Analizë vepre • Komente, analizë dhe vlerësim fragmentesh nga veprat e autorëve të programit mësimor	53
2.	Përpunim njohurish duke: • Analizuar dhe interpretuar tekste **të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.** • Vlerësuar tregues të pjesshëm dhe të plotë nga letërsia shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare. • Diskutuar dhe analizuar **në** biseda letrare dhe duke interpretuar në projekte të ndryshme. • Përdorur forma shkrimi të konsoliduara **përmes llojeve shkrimore të programit si parafraza dhe përmbledhja.** • Konkluduar **në situata vlerësuese përmes testeve të ndryshme.**	30%	**Përsëritje**	4 orë
			Biseda letrare	4 orë
			Testime	2 orë
			Punë me shkrim	**4 orë**
			Projekt (dramatizim)	**5 orë** 19 orë
	Gjithsej	100%		72 orë

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI
Lënda: LETËRSI
Shkalla: 5
Klasa: X
Viti shkollor: 2017-2018

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyçe:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Nxënësi/ja: - shprehet përmes një forme komunikimi për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material; - diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në gjuhën amtare, apo në një gjuhë të huaj, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme; - lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhën amtare, të përbërë prej 3-5 paragrafëve, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit, stilet e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve; - përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, e-mail (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.; - lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në një gjuhë të huaj ose në gjuhën amtare, të përbërë prej disa paragrafëve, si dhe tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së asaj gjuhe me gjuhën amtare; - shkruan një tekst në gjuhën amtare ose në një gjuhë të huaj për një temë nga jeta e përditshme, me tre-pesë paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë; - shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje; - prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, për një temë të caktuar, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera; - përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.

Kompetenca e të menduarit.

Nxënësi/ja:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e mbledhjes, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar;
- ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh., temë nga shkenca, nga kultura, nga arti,nga sporti, nga shëndetësia, nga shoqëria, nga mjedisi etj.);
- krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë, apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore,duke e zbërthyer në hapa të vegjël dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit;
- krijon një vepër artistike me pamje dy dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.

Kompetenca e të nxënit.

Nxënësi/ja:

- demonstron shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në matematikë, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre, aktiviteti në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur dhe efektive, teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informimi për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat më pas i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;
- kërkon dhe shfrytëzon në mënyrën e duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritura (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, vepre artistike etj.);

- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh., burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

- harton një projekt me faza të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë), pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme dhe inicion zgjidhje konkrete;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, komune dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura, procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke i evidentuar masat përmes, të cilave synon të mbështesë avancimin personal, në përparësitë që ka dhe masat përmes të cilave synon të përmirësojë dobësitë personale;
- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në aktivitete të tjera kulturore dhe në mënyrë konstruktive menaxhon emocionet e veta;
- ilustron me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe me gjerë.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

- demonstron shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh.: në familje, në shkollë, në komunitet, lokal dhe shtetëror), gjatë diskutimit tregon tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstron veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore,historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë *për zhvillimin e njohurive;*
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve **të filmuara apo të animuara;**
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Plani analitik
PËR TREMUJORIN E PARË
(Shtator - Dhjetor)

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
	Java I	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Funksioni dhe vlera e letërsisë	- Funksionet dhe vlerat e letërsisë si lloj arti. - Lidhjet e letërsisë me artet e tjera. - Tiparet kryesore të gjinisë epike, lirike dhe dramatike .	Pyetje përgjigje Diskutim	Vlerësim diagnostikues Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra artistike të gjinive të ndryshme
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Figurat letrare	Njohuri rreth figurave letrare: epiteti, antiteza, krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, metonimia, anafora.	Hartë konceptesh	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra të pjesshme apo të plota me shembuj të ndryshëm figurash letrare
	Java II	Përpunim njohurish	Përsëritje-figurat letrare	Ushtrime rreth figurave letrare	Punë ilustruese dhe shpjeguese	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Elemente të tekstit letrar	- Fabula, subjekti. - Personazhet. - Tema dhe motivet e veprës letrare. - Mjedisi, koha dhe atmosfera. - Stili dhe gjuha.	Pyetje përgjigje Diskutim Hartë koncepti Hartë personazhesh	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra konkrete për shembuj të secilit rast
	Java III	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Folklori shqiptar	- Folklori dhe llojet e tij. - Mbledhësit dhe studiuesit e folklorit.	Dua, dua të di, mësova	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra nga Th Mitko. De Rada. Përmbledhje të ndryshme nga folklori
		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Folklori shqiptar	- Karakteristikat kryesore të folklorit.	Nxjerrje informacioni nga teksti	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
	Java IV	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Cikli i Këngëve të Kreshnikëve	- Mjedisi. - Personazhet. - Rrjedha e ngjarjeve. - Këndvështrime mbi ciklin.	Punë individuale Lexim i strukturuar	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Autobiografia e popullit në vargje nga Ismail Kadare

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Gjergj Elez Alia	Studim teksti	Koment Analizë Përshkrim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
	Java V	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Gjergj Elez Alia	Studim teksti	Vlerësim Mendim i pavarur	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
		Përpunim njohurish	Bisedë letrare për Ciklin e Kreshnikëve	Studim teksti	Diskutim Ritregim Shkrim funksional	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Një nga botimet e ciklit të kreshnikëve
	Java VI	Përpunim njohurish	Punë me shkrim Parafrazimi	Shkrimi i parafrazës	Shkrim hap pas hapi Shkrim sipas modeleve Punë individuale Punë krijuese	Vlerësim paraprak	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
		Përpunim njohurish	Punë me shkrim Parafrazimi	Shkrimi i parafrazës	Përmbledhje Përshtatje Punë me modele Punë krijuese	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
	Java VII	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Antikiteti greko-romak	- Zhvillimi i letërsisë greko-romake	Nxjerrje informacioni nga teksti Shpjegim dhe interpretim faktesh	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Homeri, jeta dhe vepra	- Çështja homerike - Rëndësia e Homerit	Krahasim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
	Java VIII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: Poemat homerike	- Struktura e poemave - Studim teksti: Iliada	Vlerësim i strukturuar	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Zemërata e Akilit	Studim teksti	Koment analizë interpretim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
	Java IX	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Hektori pret Akilin për duel	Studim teksti	Vlerësim dhe punë krijuese	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Eskili, jeta dhe vepra	- Jeta e Eskilit - Veprat e Eskilit	Lexim i strukturuar Marrje informacioni	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
	Java X	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: "Prometeu i mbërthyer"	- Roli i korit - Funksioni i prologut - Studim teksti	Lexim i drejtuar Lexim me fokus çështje të caktuara	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragmenti: "Prometeu i mbërthyer". Akti I, skena III	Studim teksti	Analizë dhe koment	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
	Java XI	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragmenti: "Prometeu i mbërthyer", akti I, skena III	Studim teksti	Vlerësim dhe punë krijuese të pavarur	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Prometeu i mbërthyer", akti V	Studim teksti	Krahasim dhe punë në grup	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
	Java XII	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Euripidi, jeta dhe vepra	- Veprimtaria - Veçoritë artistike	Shpjegim dhe strukturim informacioni	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës "Medea"	- Origjina e veprës - Subjekti - Struktura e veprës - Figura e Medeas	Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI
Lënda: LETËRSI
Shkalla: 5
Klasa: X
Viti shkollor: 2017-2018
Plani analitik
PËR TREMUJORIN E DYTË (Janar - Mars)

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
25.	Java XIII	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Fragment: "Medea"	Studim teksti	Portretizim Hartë personazhi	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
26.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Medea" Akti i fundit, skena e dytë	Studim teksti	Vlerësim dhe Sintezë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
27.	Java XIV	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Medea", akti i fundit, skena e dytë	Studim teksti	Krahasim dhe diskutim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
28.		Përpunim njohurish	Bisedë letrare për antikitetin	- Rëndësia e letërsisë greko-romake. - Sfondi historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. - Përfaqësuesit dhe veprat e tyre kryesore.	Rrjeti i mendimit Diskutim Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Portofoli i nxënësit
29.	Java XV	Përpunim njohurish	Përsëritje	Përsëritje: Folklori shqiptar, antikiteti greko-romak.	Tabela T	Vlerësim diagnostikues	Portofoli i nxënësit
30.		Përpunim njohurish	Testim	Testim për kontrollin e njohurive të marra.	Punë individuale përmbledhëse dhe sintetizuese	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Fletore e testimit
31.	Java XVI	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Letërsia e vjetër shqipe	- Fillimet e letërsisë shqipe. - Autorët humanistë. - Veprat e para në shqip. - Autorët arbëreshë.	Informacion i ri	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
32.		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Marin Barleti, jeta dhe vepra.	- Vlera letrare dhe të dhëna historike.	Shpjegim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
33.	Java XVII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: "Historia e Skënderbeut"	- Koha e shkrimit të veprës. - Qëllimi dhe rrethanat e krijimit. - Botimet e veprës dhe ndikimi i saj.	Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
34.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Historia e Skënderbeut" (libri i parë)	Studim teksti	Koment dhe shpjegim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
35.	Java XVIII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Historia e Skënderbeut" (libri i parë)	Studim teksti	Analizë dhe krahasim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
36.		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Pjetër Bogdani, jeta dhe vepra	Veprimtaria dhe vlerësime rreth autorit	Shpjegim Informacion i ri dhe i strukturuar	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
37.	Java XIX	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: "Çeta e profetëve"	- Struktura e veprës - Cikli i poezive të Sibilave	Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
38.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Sibila Libika "Krijimi i rruzullimit"	Studim teksti	Lexim i drejtuar	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
39.	Java XX	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Pjetër Budi, jeta dhe vepra	Studim teksti	Informacion i ri	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
40.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment nga "Doktrina e Kërshtenë"	Studim teksti	Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
41.	Java XXI	Përpunim njohurish	Bisedë letrare për letërsinë e vjetër shqipe	- Kushtet historike dhe kulturore në të cilat u shkrua letërsia e vjetër shqipe. - Përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së vjetër shqipe.	Diskutim Stuhi mendimesh	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
42.		Përpunim njohurish	Prezantim dhe njohje me temën e projektit. Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta"	Faza I	Prezantim	Vlerësim paraprak, shtytës dhe motivues	Portofoli i nxënësit

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
43.	Java XXII	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Rilindja, Dante Aligieri, jeta dhe vepra	- Figura e Beatriçes. - Shkolla stilnoviste. - Veprat e Dantes.	Hartë konceptesh	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
44.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës. "Komedia hyjnore"	Veçoritë e veprës	Analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
45.	Java XXIII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Kënga I	Studim teksti	Koment	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
46.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Kënga V Paolo e Françeska	Studim teksti	Hartë personazhi Përshkrim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra e plotë
47.	Java XXIV	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: Kënga X	Studim teksti	Vlerësim dhe punë e pavarur	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor
48.		Përpunim njohurish	Kontroll i ecurisë së projektit. Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta"	Diskutim rreth ecurisë së projektit.	Kontroll hap pas hapi Verifikim Provë Analizë	Vlerësim reflektues	Portofoli i nxënësit

Lënda: LETËRSI
Shkalla: 5
Klasa: X
Viti shkollor: 2017-2018
Plani analitik
PËR TREMUJORIN E TRETË (Prill - Maj)

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
49.	Java XXV	Përpunim njohurish	Punë me shkrim.	-Karakteristika të përmbledhjes. - Udhëzime për të shkruar një përmbledhje.	Shkrim i strukturuar	Vlerësim paraprak motivues	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
50.		Përpunim njohurish	Punë me shkrim. Përmbledhja	-Shkrimi i një paragrafi përmbledhës. -Shkrimi i një skede libri. -Shkrimi i përmbledhjes së një fragmenti.	Shkrim sipas modelit Shkrim i iirë	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Fletore të punëve me shkrim, Portofoli i nxënësit
51.	Java XXVI	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare.	Humanizmi dhe Rilindja evropiane	-Zhvillimi i humanizmit dhe i Rilindjes evropiane. -Përfaqësuesit kryesorë në Evropë.	Informacioni i ri Evokimi	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
52.		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare.	Miguel De Servantes Saavedra, jeta dhe vepra	-Përvojat, krijimtaria, rëndësia e Servantesit.	Shpjegim Strukturim i informacionit të ri	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
53.	Java XXVII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.	Analizë e veprës: "Don Kishoti i Mançës" Rilindja dhe Servantesi Donkishotizmi	-Konteksti letrar. -Struktura e romanit -Subjekti -Personazhet -Mendimi kritik	Stuhi mendimi Analizë Hartë personazhi	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
54.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.	Fragment: Prologu I "Don Kishoti"	Studim teksti	Lexim individual Pema e mendimit	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
55.	Java XXVIII	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.	Fragment: Kreu XXII- XXIII	Studim teksti	Punë në grupe Diskutim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm	- Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
56.		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Uilliam Shekspir, jeta dhe vepra	- Filozofia humaniste e veprës shekspiriane. - Kryeveprat e Shekspirit.	Tabela dua, di, mësoj	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
57.	Java XXIX	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: "Hamleti"	- Subjekti - "Hamleti", përfaqësues i idealeve të Rilindjes - Mendimi kritik për "Hamletin"	Hartë koncepti dhe personazhi Pema e mendimit	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
58.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Hamleti", akti I, skena II-III	Studim teksti	Lexim i strukturuar Punë në grupe Diskutim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
59.	Java XXX	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Hamleti", akti II, Skena II, Akti III	Studim teksti	Punë në grupe Vlerësim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
60.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Hamleti", akti V, Skena I-II	Studim teksti	Punë në grupe Shkrim funksional	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
61.	Java XXXI	Përpunim njohurish	Bisedë letrare për Rilindjen	- Zhvillimi i Humanizmit dhe i Rilindjes Europiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike. Përfaqësuesit e saj kryesorë.	Punë e pavarur Diskutim Tabela përmbledhëse	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Portofoli i nxënësit
62.		Përpunim njohurish	Projekt: Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta"	Faza III	Lojë në role	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
63.	Java XXXII	Përpunim njohurish	Projekt: Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta"	Faza IV	Reflektim Interpretim dhe analizë	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
64.		Përpunim njohurish	Projekt: Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta"	Faza V	Lojë në skenë interpretim dhe vlerësim	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
65.	Java XXXIII	Përpunim njohurish	Përsëritje	Përsëritje: Letërsia e vjetër shqipe Humanzimi, Rilindja.	Informacion i strukturuar Diskutim	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Portofoli i nxënësit
66.		Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Klasicizmi. Përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e tyre.	- Tiparet dhe parimet estetike të klasicizmit. - Parimet e klasicizmit. - Elemente të klasicizmit në letërsinë shqipe.	Informacion i ri	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
67.	Java XXXIV	Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare	Molieri, jeta dhe vepra	- Vlera universale të teatrit të Molierit. - Veçoritë e teatrit të Molierit dhe rëndësia e tij.	Analizë vlerësuese	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor
68.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Analizë e veprës: "Tartufi"	- Struktura - Subjekti - Personazhet	Hartë personazhi dhe koncepti	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vlerësimi për të nxënë
69.	Java XXXV	Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Tartufi", Akti I, Skena V	Studim teksti	Koment dhe analizë	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë

Nr.	Java	Kompetenca	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
70.		Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	Fragment: "Tartufi", akti III, skena II; akti IV, skena V	Studim teksti	Punë në grupe Diskutim	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	- Teksti mësimor Vepra e plotë
71.	Java XXXVI	Përpunim njohurish	Përsëritje	Përsëritje për njohuritë vjetore	Diskutim	Vlerësim diagnostikues	Portofoli i nxënësit
72.		Përpunim njohurish	Testim vjetor	Kontroll i njohurive të marra gjatë vitit.	Testim	Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës)	Fletë të testimit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Teoria e letërsisë
Tema mësimore: Funksioni dhe vlera e letërsisë</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
3. Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Përkufizon termin letërsi.
2. Rendit degët e shkencës së letërsisë.
3. Shpjegon tiparet dalluese midis epikës, lirikës dhe dramatikës.
4. Diskuton me shembuj mbi vepra të ndryshme sipas gjinive.</td><td>Fjalët kyçe: letërsi, funksion estetik, gjini letrare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti mësimor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjuha shqipe, retorika.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: informacion i ri, stuhi mendimesh, reflektim dhe rifreskim njohurish, praktikë e drejtuar, punë e pavarur.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Organizimi i orës së mësimit
➢ Punë parapërgatitore:
Lexojmë pjesë të ndryshme:
1. një fragment nga një roman;
2. një tekst shkencor;
3. një poezi;
4. një material historik.
Pas leximit të tyre diskutojmë mbi ndryshimet e këtyre teksteve: karakteristikat që ato kanë: veçoritë gjuhësore etj.
Hapi i parë: Informacioni i ri
Letërsia si art i fjalës ka në thelb të saj njeriun dhe botën. Funksioni i letërsisë lidhet me rolin, ndikimin që ajo ka mbi njeriun dhe vlera e saj përcaktohet nga rëndësia që ky art zë në jetën e tij. Funksioni estetik është thelbi i letërsisë.
Shkenca për letërsinë është studimi i sistemuar i letërsisë dhe lindi si domosdoshmëri për shpjegimin e saj. Ajo ndahet në tri degë:
1. Historia e letërsisë e cila e studion letërsinë si një produkt me një ndikim intelektual, gjuhësor, religjioz dhe artistik të përmbledhur në disa periudha kryesor historike.
2. Teoria e letërsisë i studion veprat letrare në planin teorik
3. Kritika letrare është parashtrimi i një analize dhe gjykimi mbi vlerat ose jo të një vepre letrare të cilat lidhen me shijen e lexuesit dhe të artit në përgjithësi.</td></tr>
</table>

Letërsia lidhet me pikturën, muzikën, kinematografinë



Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

1. Çfarë është letërsia sipas jush? Si do ta përkufizonit atë?
2. Cilat janë disa nga funksionet kryesore të letërsisë? A mendoni se ndonjëri prej tyre është më i rëndësishëm se të tjerët?
3. Çfarë aftësish zhvillon letërsia te njeriu?
4. Cilat janë degët e shkencës për letërsinë?
5. Ç'është gjinia ose lloji letrar? Sa gjini dallohen?
6. Në cilat forma i ndeshim gjinitë letrare sot?
7. Si lidhet letërsia me artet e tjera?
8. Pse themi që letërsia shkakton kënaqësi dhe nxit imagjinatën?
9. Si ndryshon stili i një autori nëse krijon gjini të ndryshme letrare?
10. Cilat janë tiparet dalluese midis epikës, lirikës dhe dramatikës?

Hapi i tretë: Reflektim dhe rifreskim dijesh. Punë në grupe

Grupi i parë: tregon degët më interesante që përmbush interesat ndaj letërsisë

Grupi i dytë: diskuton mbi skemën e gjinive letrare

Grupi i tretë: diskuton mbi karakteristikat e gjinive letrare duke u ndalur te veprat e Shekspirit, Çajupit, Poradecit, Kadaresë

Hapi i katërt: Fjala dhe përdorimi i saj. Punë e drejtuar

Pasi lexojmë një poezi të Edgar Poe, diskutojmë se si krijohet lidhje e ndërsjellë midis muzikës dhe fjalës; ç'rol luan fjalori në mënyrën e të shprehurit në gjinitë letrare (poezia "Korbi" dhe "Për Enin")

Hapi i pestë: Praktikë e pavarur. Punohet pika 1 dhe 3

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e orës sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Nisur nga thënia e Horacit "Poezia është si piktura" gjeni përmes internetit shembuj frymëzues të pikturës prej poezisë dhe veprave të tjera të njohura.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Teoria e letërsisë **Tema m**ësimore**:** Figurat letrare		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin 3. Kompetenca personale		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Organizon sipas ndërtimit dhe funksionit artistik të figurave letrare. 2. Gjen shembuj të figurave letrare. 3. Analizon ngjashmërinë midi: metaforë-metonimi, metaforë- hiperbolë, krahasim-similtudë etj.		**Fjalët kyçe:** *figura të kuptimit, figura tingëllore, t*ë *sintaks*ës*, t*ë *leksikut.*
Burimet: teksti i mësimor, mjete shkollore, foto te ndryshme		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** retorika.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: kontroll, stuhi mendimesh, piramida e mendimit.		

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë duke diskutuar mbi to.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

1. Çfarë janë figurat letrare?
2. Si organizohen ato sipas ndërtimit dhe funksionit artistik?
3. Cilat janë figurat letrare që keni ndeshur më shpesh në veprat që keni lexuar?
4. Pse figuracioni është i rëndësishëm në letërsi?
5. A mendoni se ka disa figura që i shkojnë më shumë një gjinie sesa një tjetre?
6. A e rëndon krijimin letrar përdorimi i figurës si qëllim në vetvete?

Hapi i tretë: Informacioni i ri



Hapi i katërt: Punë në grupe Grupi i parë: shembuj te figurave të kuptimit Grupi i dytë: shembuj të figurave të tingullimit Grupi i tretë: shembuj të figurave, të fjalëve dhe shprehjeve Grupi i katërt: shprehje të figurave sintaksore Grupi i pestë: shembuj të figurave leksikore Materiale plotësuese: Poezi nga : Naim Frashëri, Lasgush Poradeci, Ismail Kadare. **Hapi i pestë**: Praktikë e drejtuar 1. Gjejmë një metaforë dhe një hiperbolë dhe analizojmë funksionin e tyre stilistik (*natyra qeshte, pluhuri u ngrit dymbëdhjetë pashë mbi dhe*) 2. Të tregojmë ngjashmëritë midis krahasimit (si zog) dhe similitudës (porsi kanga e zogut të verës). **Hapi i gjashtë**: Diskutim ➢ Figurat janë mënyra të përcaktuara të shprehjes gjuhësore të cilat dallojnë nga të folurit e drejtpërdrejtë ➢ Vëreni lidhjen që ekziston midis epitetit dhe mbiemrit si shprehi e tij
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë.
Detyrë: Krijoni një poezi ose një prozë ku të përdorni figura të ndryshme letrare.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Teoria e letërsisë **Tema m**ësimore: Përsëritje		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. *Njeh funksionin estetik të letërsisë dhe veçantinë e saj në lidhje me artet e tjera.* 2. *Kupton ndikimin e ndërsjellë që ka letërsia me fushat e tjera (kinematografi, pikturë, muzikë).* 3. Analizon figurat në një poezi . 4. *Flet për raportin estetik që krijon letërsia me artet e tjera.* 5. *Grupon figurat letrare.* 6. Analizon ngjashmërinë: metaforë - metonimi; metaforë -hiperbolë; antitezë-antonim.		**Fjalët kyçe:** *funksion estetik, figura letrare, raport estetik etj.*

Burimet: teksti i mësimor.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuha shqipe, kinematografia, piktura etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: kontroll, stuhi mendimesh, diskutim, punë individuale, shkrim i lirë, analizë.	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë duke diskutuar mbi esenë dhe karakteristikat që ka eseja argumentuese

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

- Çfarë kanë thënë figura të njohura për letërsinë?
- Shpesh thuhet se letërsia është arti i fjalës. Po piktura, muzika apo kinematografia çfarë kanë në qendër të artit të tyre?
- Flisni për raportin estetik që krijon letërsia me artet e tjera
- Ç'lloj teorish letrare nevojiten për studimin e një vepre letrare?
- Si grupohen figurat letrare?

Hapi i tretë: Reflektim dhe vlerësim dijesh. Diskutim.

Nxënësit janë të lirë të japin mendimin e tyre duke ilustruar dhe me shembuj.

Diskutojmë së bashku me nxënësit mbi këto probleme

a) funksioni estetik i letërsisë dhe ajo që e dallon nga artet e tjera;
b) ndikimi i ndërsjellë që ka letërsia dhe kinematografia;
c) shpjegojmë shprehjet: muzika e gjuhës, gjuha e muzikës, pikturë fjalësh, përshkrim si pikturë;

Hapi i katërt: Fjala dhe përdorimi i saj. Punë individuale

Secili nxënës gjen kuptimin e fjalëve zhanër, funksion, dukuri, trillim, epikë, dramatikë nga fjalori. Më pas diskutojmë rreth kuptimeve të tyre

zhanër – lloj- funksion- roli që luan gjuha në shoqëri

Hapi i pestë: Analizë përmes shembujsh

1. Historia e letërsisë merret edhe me kronologjinë e paraqitjes së veprave. Rëndësia në studimin e një vepre
2. Kritika krahas letërsisë. Si na ndihmon ajo për të kuptuar natyrën e letërsisë?
3. Në poezinë e Lasgush Poradecit "Gjeniu i Anijes" dhe të Fan Nolit "Anës Lumenjve" të gjenden figurat tingëllore

Të përshkruajmë bukurinë që fiton fjala nga dy-kuptimësia në një tekst letrar (qeshte natyra- metaforë, Akil këmbëshpejti- këmbëshpejtë)

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë.

Detyrë: Përzgjidhni një poezi, gjeni figurat letrare dhe shpjegoni funksionin e tyre në krijimin e imazhit poetik.

Shkruani një ese argumentuese mbi mesazhin e një poezie.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X Shkalla V
Rubrika: Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare **Tema m**ësimore: Elemente të tekstit letrar		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Tregon kuptimin e fabulës dhe të subjektit. 2. Rendit pikat kryesore të subjektit. 3. Shpjegon karakterin objektiv dhe subjektiv të stilit të autorit. 4. Analizon dhe shqyrton elementet e tekstit letrar.		**Fjalët kyçe:** *fabul, subjekt, narrator, personazh, motive, stil.*
Burimet: teksti mësimor, tekste të ndryshme letrare.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** retorika.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, përmbledhje e strukturuar, pyetje -përgjigje, punë në grup.		

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Diskutim

Kujtojmë ç'dimë rreth fabulës dhe subjektit, rolin që luan personazhi dhe narrator, mjedisi si një pjesë e rëndësishme e një vepre letrare.

Nxënësit janë të lirë të japin mendimin e tyre duke marrë shembuj veprash të ndryshme (Kronikë në gur. I. Kadare)

Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar



Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje 1. Cili është kuptimi i fabulës dhe i subjektit?Me se është i lidhur secili prej tyre? 2. Si lidhen këto koncepte: subjekt,ngjarje, rend? 3. Cilat janë pikat kryesore të subjektit? 4. Si zgjidhet narratori në një vepër? Cili është roli i tij ? 5. Cilat janë disa nga karakteristikat e personazhit? **Hapi i katërt**: Punë me grupe Merret si shembull një vepër artistike. Nxënësit janë të lirë të zgjedhin një vepër. Ndajmë klasën në grupe. Grupi I: Dallon fabulën e romanit. Grupi II: Dallon temën dhe idenë. Grupi III: Shpjegon se si mjedisi dhe koha krijojnë atmosferën e veprës.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë
Detyrë: Zgjidhni një vepër letrare dhe shqyrtoni elementët e tekstit letrar që mësuat.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Folklori shqiptar **Tema m**ësimore**:** Folklori dhe llojet e tij. Mbledhësit dhe studiuesit e folklorit		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 4. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Lexon pjesë të ndryshme folklorike. 2. Përcakton kuptimin e fjalës " folklor". 3. Përmend folkloristët e parë shqiptarë dhe veprat e tyre.		**Fjalët kyçe:** *folklor, folkloristikë, mbledhës.*
Burimet: teksti mësimor.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuha shqipe, kinematografia,piktura etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, përmbledhje e strukturuar, punë e drejtuar.		
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë**: Diskutim Në videoprojektor shohim dhe dëgjojmë pjesë të ndryshme folklorike si: ninulla, këngë dasmash,vaje etj. Në të njëjtën kohë diskutojmë mbi to për rëndësinë dhe bukurinë që sjellin në historinë e letërsisë shqiptare, referuar (https:||www.shqipëria.com, folklori shqiptar *youtube*)		

Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar
Folklor- Krijimtari artistike e përcjellë nëpër shekuj, e cila përfshin krijimet gojore, muzikore, koreografike etj. të një populli.Folklori si tërësi krijimesh të larmishme të kulturës materiale e shpirtërore është mjaft i hershëm. Në të përfshihen krijime të tilla si : këngë,valle, përralla, fjalë të urta, gjëegjëza, lojëra e pantonima, formulime ritualesh në festa fetare, në dasma, lindje, vdekje, në punët bujqësore e blegtorale, zbukurime në veshje,në orenditë shtëpiake, në veglat e punës dhe instrumentet e larmishme muzikore: fyell, curle, lahutë, sharki, gajde. Folkloristika - shkenca që merret me hulumtimin dhe studimin e kësaj krijimtarie. Ndër më të njohurit mbledhës dhe studiues të folklorit shqiptar përmendim: Z. Jubani, S. Dine, dhe sidomos Th. Mitko me përmbledhjen : "Bleta shqiptare" arbëreshët: V. Dorsa, Dh. Kamarda. Një punë të çmuar arriti sidomos De Rada përmes përmbledhjes me 72 këngë arbëreshe "Rapsodi të një poeme arbëreshe".

Llojet e folklorit: → përralla; → Legjenda

Hapi i tretë: Punë e drejtuar
1. Dëgjojmë: Një valle të kënduar (valle e kënduar tropojane),një këngë dasme(këngë dasme shkodrane e vjetër- Të morëm nuse),një këngë vaji (kënga e Çelo Mezanit).
Si pasqyrohet përvoja e një populli përmes krijimeve gojore, muzikore, koreografike?
Materialet në *youtube.*
2. Shohim: Një objekt të punuar me dorë(punë - dore, qilima në foto),në ritual(tradita e dasmave shqiptare - *youtube*), një veshje karakteristike. Si evidentohet natyra e një kombi nëpërmjet tyre?
3. Dëgjojmë një ninullë,disa gjëegjëza e proverba që tregojnë marrëdhënie të ndryshme njerëzore.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë.

Detyrë: Gjeni pjesë nga krijimtaria e Thimi Mitkos dhe e Jeronim De Radës.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Folklori shqiptar **Tema m**ësimore: Karakteristikat kryesore të folklorit		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**:** 1.*Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2.*Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3.*Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.*Rendit tiparet e folklorit.* 2.*Analizon tiparet nëpërmjet shembujve.*		**Fjalët kyçe:** *folklor, tipare, lirika, epika, dramatika, sinkretizmi etj.*

Burimet: teksti mësimor,materiale të ndryshme folklorike.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuha shqipe, kinematografia, piktura etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim, përmbledhje e strukturuar, diskutim.	
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë**: Lexim Kontrollojmë dhe lexojmë pjesët qe nxënësit kanë zgjedhur nga krijimtaria e Thimi Mitkos dhe e Jeronim De Radës. **Hapi i dytë**: Përmbledhje e strukturuar **Karakteristikat kryesore t**ë **folklorit** : 1. Anonimati – krijimet kanë një fillesë autoriale, por që humbet e nuk përbën rëndësi gjatë përc jelljes së krijimit në kohë e mjedise të ndryshme 2. Kolektiviteti – krijimet interpretohen dhe përcillen në mënyrë kolektive në festa,gëzime e situata të ndryshme familjare etj. 3. Motërzimi – ka të bëjë me mënyrat se si përcillet kjo krijimtari në kohë dhe mjedise të ndryshme. 4. Sinkretizimi – lidhet me parimin e gërshetimit dhe të shkrirjes brenda një krijimi të disa zhanreve artistike. **Hapi i tretë**: Diskutim Dëgjojmë dhe shohim valle të kënduara nga krahina të ndryshme të vendit tonë. Diskutojmë mbi bukurinë që sjell sinkretizimi.	
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë.	
Detyrë: Sillni ndonjë shembull që tregon se një krijim ka pasur fillimisht një emër autori dhe më pas është njohur nga lexuesi si krijim popullor.	

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Folklori shqiptar **Tema m**ësimore: Cikli i këngëve të Kreshnikëve		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Reciton pjesë nga Cikli i Kreshnikëve. 2. Rendit figurat kryesore të ciklit. 3. Analizon dukurinë e zmadhimit si karakteristikë e këtij eposi. 4. Diskuton mbi ngjarjet e Ciklit të Kreshnikëve në këngë analoge ballkanike.		**Fjalët kyçe:** *epikë legjendare, Cikli i kreshnikëve, Muji, Halili, agallarë etj.*

Burimet: teksti mësimor, botime të ndryshme të folklorit.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** krijimtaria gojore e popullit.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: dëgjim, informacion i ri, stuhi mendimesh, diskutim.	
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë:** Dëgjim Dëgjojmë të recituara pjesë nga "Cikli i Kreshnikëve" **"**Ajkuna qan Omerin". Muzikë: "Kreshnikët e lirisë" **Hapi i dytë**: Përmbledhje e informacionit të ri Mitologjia shqiptare ka ardhur te ne në trajtë të copëzuar dhe ka në qendër të saj figura si : zana, floçka,gërshetëza etj. Folklori shqiptar njeh edhe Ciklin e Kreshnikëve si epos ku Muji e Halili bëhen protagonistë në një botë sa reale aq edhe imagjinare. **"Cikli i këngëve të Kreshnikëve"** ose si quhet ndryshe "Këngët e Mujit dhe të Halilit" bën pjesë në Epikën Legjendare Shqiptare. Karakteristika të kësaj epike janë pasqyrimi tejet i zmadhuar i ngjarjeve dhe i veprimeve të heronjve, veshja e tyre me tipare e dhunti të jashtëzakonshme, legjendare. Mjedisi ku zhvillohen ngjarjet e këtyre këngëve janë blegtorale dhe mendohet që ato të jenë krijuar në periudhën e shekujve XII-XV. Boshtin e këtyre këngëve e përbëjnë bëmat e Mujit dhe të Halilit,të cilët janë vëllezër dhe shoqërohen nga një çetë me 30 agallarë. Figurë e njohur është Ajkuna,e shoqja e Mujit dhe Omeri djali i tyre. Ngjarjet e këtyre këngëve përcillen nëpër situata e vende nga më të ndryshmet. Betejat e dyluftimet mes heronjve dhe kundërshtarëve të tyre janë mjaft të ashpra e shkojnë deri në shkatërrime banesash e në rrëmbime grash. **Hapi i tretë**: Stuhi mendimesh 1. Cilat janë figurat e mitologjisë shqiptare? 2. Pse përdoret dukuria e zmadhimit? Ç'rol luan ajo në zhvillimin e subjektit të tyre? 3. Kujt periudhe i përkasin këto këngë dhe si mendohet të kenë ardhur deri në ditët tona? 4. Cilat janë figurat kryesore të ciklit? Pse është mbresëlënëse trimëria e Mujit? **Hapi i katërt**: Diskutim Vendosim përballë këngët e Ciklit të Kreshnikëve dhe poemën "Iliada". Tregojmë ngjashmëritë.	
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.	
Detyrë: Gjeni pjesët më të bukura të Ciklit të Kreshnikëve dhe tregoni arsyen e zgjedhjes.	

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Folklori shqiptar
Tema mësimore: Fragment: Gjergj Elez Alia (ora e parë)</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
3. Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Ndërton subjektin e këtij fragmenti.
2. Lexon dhe shpjegon teksti.
3. Analizon figurën e Gjergj Elez Alisë dhe të Bajlozit.</td><td>Fjalët kyçe: Gjergj Elez Alia, nëntë plagë, bajlozi, nderi i familjes, nderi i kombit, përjetësi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti mësimor, folklori shqiptar.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Cikli i Kreshnikëve.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim, stuhi mendimesh, punë në grupe.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Organizimi I orës së mësimit
Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim
Lexojmë fragmentin dhe shpjegojmë tekstin.
Cila është mënyra e dhënies së subjektit në këtë fragment?
a) Shmangia nga ngjarjet e parëndësishme.
b) Mungesa e figuracionit.
c) Dhënia vetëm e një motivi kryesor.
d) Dhënia e çdo elementi të subjektit.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh
1. Vargu i parë i këngës është hyrës,tregues, parashikues apo përshkrues? (tregues)
2. Për çfarë lufton personazhi kryesor i kësaj kënge? Kujt i drejtohet ai në këtë këngë? (për mbrojtjen e nderit dhe të dinjitetit familjar e kombëtar)
3. Ku bazohet krijimtaria e mësipërme në rrëfim apo përshkrim?
4. Cili është detaji numerik që haset më shpesh në këngë? (numri nëntë)
5. Në këtë fragment përshkruhen dy stinë. Cilat janë ato dhe si lidhet paraqitja e tyre me dy ngjarjet kryesore të fragmentit?
Hapi i tretë: Punë në grupe
Grupi i parë: Të shpjegojnë me fjalët e tyre vargun “Ka gjetë kulmin të tanë shembë përdhe?”</td></tr>
</table>

Grupi i dytë: Gjejnë vargjet ku Gjergji u drejtohet shokëve dhe arsyen pse. Pa ndigjoni more shokët e mi Falë u qofshin sarajet e mia Falë u qofshin tanë paret e mia Grupi i tretë: Portretizon personazhet.Tregojnë: Çfarë përfaqësojnë, cili është qëllimi i luftës që bëjnë dhe me mjete e realizojnë? Grupi i katërt: Të gjejnë hiperbolat dhe anaforat në këtë fragment e të shpjegojnë funksionin e tyre. HIPERBOLA: Dymbëdhjetë pash n lëndinë u ngul topuzi Dymbëdhjetë pash përpjetë, si re, a çue pluhni
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.
Detyrë: Dëgjojeni eposin në variantin e kënduar me lahutë.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Folklori shqiptar **Tema m**ësimore: Fragment: "Gjergj Elez Alia" (ora e dytë)		
Rezultatet e të nxënit sipas **kompetencave kyçe** 1.*Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2.*Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3.*Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Dallon elementet reale dhe fantastike. 2.Analizon fragmentin nga ana gjuhësore dhe për figuracionin e përdorur. 3.Krahason "Kënga e Gjergj Elez Alisë" dhe "Tringa" "Lahuta e malcisë" Gjergj Fishta.		**Fjalët kyçe:** *Gjergj Elez Alia, nënt*ë *plag*ë*, bajlozi, nderi i familjes, nderi i kombit,*p*ë*rjet*ë*si.*
Burimet: teksti mësimor.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** epika legjendare shqiptare.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: informacion i ri, stuhi mendimesh, reflektim dhe rifreskim njohurish, praktikë e drejtuar, punë e pavarur.		

Organizimi i orës së mësimi

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

- Gjeni elementet reale dhe fantastikë të shkrira me njëra-tjetrën.
- Pse kënga e Gjergj Elez Alisë konsiderohet një himn i dashurisë për atdheun dhe familjen?
- Cila është pema karakteristike që vendoset në nderim të trimit?A është kjo pjesë e mendësisë në krijimtarinë popullore?

- Në cilën prej veprave të mëposhtme,të bazuara ne eposin e një vendi tjetër,haset lidhja e fortë mes motrës e vëllait?

"Orestia" _____ "Medea" _____ "Odisea" _____ "Edipi mbret" _____

Hapi i dytë: Punë individuale
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me rubrikën: Fjala dhe përdorimi i saj.
Hapi i tretë: Di, Dua të di, Mësova

Çfarë dinim më parë rreth Ciklit të Kreshnikëve?	Çfarë mësuam deri tani për Ciklin e Kreshnikëve?	Çfarë duam të mësojmë më tej rreth Ciklit të Kreshnikëve?
Janë pjesë të folklorit tonë.	Datojnë rreth shek XI-XII. Kanë vende reale dhe fantastike,natyra në funksion të personazheve. Elementët mitologjikë (zanat,orët, shtojzovallet). Vargu 11 rrokësh i parimuar.	Duam të mësojmë se çfarë thotë kritika shqipe dhe ajo e huaj për këtë lloj krijimtarie? Duam të njohim botime të ndryshme të eposit.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore, sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Shkruani një ese: "Që të mbahesh mend për mirë duhet të kryhesh vepra të mira "tema e së cilës mbështetet te personazhi i Gjergj Elez Alisë dhe te vargu i fundit: Kërkund s' ndesha n'Gjergj Elez Ali".

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Bisedë letrare **Tema mësimore**: Cikli i Kreshnikëve		**Situata e të nxënit**: Të flasim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton temat kryesore të Ciklit të Kreshnikëve. 2. Portretizon personazhet. 3. Analizon rolin e qenieve mitologjike në vepër.		**Fjalët kyçe**: *Muji, Halili, agallarë, zana, Orët shqiptare,ora malazeze,Tanusha,krajli, Kotorre të reja, Lugje të Verdha etj.*	
Burimet: teksti I nxënësit, material.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** me historinë, gjeografinë, folkloristikën shqiptare.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, analizë, lexim dhe interpretim , dëgjim.

Organizimi i orës së mësimit

Kjo orë mësimi mund t'i lihet në dëshirë mësuesit për ta zhvilluar atë. Kjo orë mund të trajtojë në përgjithësi Krijimin e Ciklit të Kreshnikëve ose mund të merret një pjesë nga Cikli dhe mund të trajtohet. Nxënësit janë vënë në dijeni disa orë më përpara për këtë temë,ku dhe ata të kenë mundësi të bëhen pjesë aktive,me materiale të ndryshme nga interneti, fragmente të ndryshme. Ne marrim "Martesën e Halilit", pjesë nga Cikli I Kreshnikëve. Të gjithë nxënësit kanë përpara fragmentin.

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë "Cikli i Kreshnikëve" dhe nxënësit e plotësojnë atë.



Hapi i dytë: Analizë

Analizohet vepra "Cikli i Kreshnikëve".

Ky cikël ka në përbërjen e saj nga një varg rapsodish, në të cilat tregohen bëmat e dy vëllezërve, Mujit dhe Halilit, si dhe të tridhjetë shokëve të tyre, të cilët quhen agallarët e Jutbinës. Ky cikël është një nga perlat e gjerdanit të folklorit tonë. Megjithëse koha në këtë cikël është e papërcaktuar studiuesit mendojnë se ngjarjet zhvillohen aty nga shek XI-XII. Këto këngë këndohen vetëm në zonat Veriore të Shqipërisë dhe në Kosovë të shoqëruara me lahutë. Në këto vargje dëshmohet fantazia e pasur e popullit dhe ndjeshmëria artistike. Një nga të veçantat e këtij cikli është fakti që njerëzit dhe ngjarjet paraqiten të hiperbolizuar si edhe veprimet, jeta dhe mendimet e tyre, të cilat përzihen me qenie përrallore siç janë Orët e Malit, shtojzovallet etj. Pikërisht kjo rimarrje e momenteve jetësore reale me ato fantastike i japin këtij Cikli karakterin legjendar.

PERSONAZHET DHE VEÇORITË E KËNGËVE TË KRESHNIKËVE

Në panteonin e gjallë të figurave të këtij cikli secili personazh me prejardhje reale, historike apo fantastike ka karakteristikat e veta dhe secili plotëson panoramën e plotë.





Ashtu si Muji, edhe Halili (që herë-herë quhet edhe Sokol Halili, Halil aga i ri) është një figurë madhështore e ciklit të Kreshnikëve, deri diku një antitezë, por edhe një plotësim i figurës së vëllait të tij të madh, Mujit; i pashëm, gjaknxehtë e zemërak, Halili nuk është më pak trim sesa i vëllai, te Halili, ashtu siç e kërkonte zakoni kalorësiak, ishte luftëtar dhe kalorës i rrallë dhe dashnor i përsosur. Halili është një nga elementët që lidhet me mjedisin e armiqve, kryesisht nëpërmjet vajzave të tyre.

Hapi i tretë: Lexim dhe interpretim

Nxënësit lexojnë dhe interpretojnë edhe punët e tyre. Diskutojnë mbi personazhet,vendet reale dhe të krijuara, rëndësia e martesave, mbajtja e besës etj. Për ta bërë më konkrete merren fragmente nga Cikli i Kreshnikëve.

Martesa e Halilit

Martesa është vetëm një episod në krahasim me gjithë bëmat e trimërisë së kreshnikut Halil. Ajo është një martesë me rrëmbim dhe sjell jehonën e kohëve të lashta dhe atë të periudhës së kalimit në martesën jashtë fisit.Rrëmbime të tilla në atë kohë quheshin akte trimërie. Etj…

Hapi I katërt. Nxënësit analizojnë subjektin,përcjellin mesazhet,idenë,përdorimin e figurave letrare.



Hapi i katërt: Dëgjim
Dëgjojmë të interpretuar pjesë të ndryshme me lahutë.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje dhe bëhen disa vlerësime

Detyrë: Të lexojnë pjesë të ndryshme nga Cikli i Kreshnikëve

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Punë me shkrim **Tema m**ësimore: Parafrazimi (ora e parë)		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1.*Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2.*Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3.*Kompetenca personale* 4.*Kompetenca digjitale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Përcakton termin "parafrazim". 2.Rendit karakteristikat e parafrazimit. 3.Rendit ndryshimet që pësON teksti burimor gjatë parafrazimit.		**Fjalët kyçe:** *parafrazë, tekst burimor, zëvendësim*

Burimet: teksti mësimor.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjuha shqipe

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, përmbledhje e strukturuar, lexim.

Organizimi i orës së mësimi

Hapi i parë: Diskutim

Kontrollojmë detyrat e shtëpisë. Më pas zgjedhim esetë më të bukura dhe bëjmë dhe disa vlerësime.

Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar

Parafraza është një frazë e jotja e ndërtuar mbi bazën e një personi tjetër, pra është përshtatja fjalë pas fjale dhe kuptim pas kuptimi e tekstit që krijohet kundrejt atij të origjinës. Çdo tekst letrar apo jo letrar mund të parafrazohet. Ajo është një formë përmbledhjeje.

Karakteristika të **parafrazimit**

- Parafraza është ndryshim, por edhe përshtatje.
- Parafraza ndryshon mënyrën si thuhet, por kurrsesi kuptimin fillestar.

Teknikat e parafrazimit

- Lexim i strukturuar
- Lexim i pjesshëm
- Mbajtja e shënimeve
- Krijimi i skedave
- Ndërthurja e elementeve të ndryshëm
- Përcaktimi i detajeve të rëndësishme
- Ndërtimi i hartës së konceptit apo e personazhit etj.

Hapi i tretë: Lexim

Lexojmë modele parafrazash.

Model 1

Fjalë e urtë

Buza gaz, shpirti po plas. Elbasan → Parafrazimi: Buzëqesh edhe pse jam i trishtuar.

Qesh me dashurinë ai që nuk ka qenë i brengosur prej saj. Shekspir → Parafrazimi: Dashuria gëzon dhe lumturon më tepër atë që i ka njohur këto ndjenja më parë.

Model 2

“ Vetmia e artistit ndryshon në mënyrë të dyfishtë, ajo fsheh jo vetëm një raport real me publikun, por edhe rindërtimin e një publiku të specializuar” Zhan Pol Sartri

Parafrazimi: Artisti ndihet vetëm,nuk kuptohet nga askush deri në momentin e gjetjes së lexuesit ideal,lexuesit të duhur të veprës së tij.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Ktheni në prozë poezinë “ Trioleta “ nga Lasgush Poradeci.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Punë me shkrim
Tema mësimore: Parafrazimi (ora e dytë)</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2.Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
3.Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1.Lexon modele parafrazash.
2.Kthen në prozë poezi të ndryshme.
3.Analizon ndryshimet që pëson teksti në parafrazë.</td><td>Fjalët kyçe: parafrazë, tekst burimor, ndryshim, ruajtje e kuptimit, model etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti mësimor, fragmente të ndryshme.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: epika legjendare shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, praktikë e drejtuar, punë e pavarur.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Organizimi i orës së mësimit
Hapi i parë: Stuhi mendimesh
• Ç’është parafraza? Përse bëhet ajo?
• Cilat janë disa nga karakteristikat e parafrazave?
• Çfarë ruhet nga teksti burimor në parafrazim?
• Çfarë ndryshimesh pëson teksti burimor gjatë parafrazimit?
• Cilat janë teknikat e parafrazimit?

Hapi i dytë: Praktikë e drejtuar
Lexojmë modelet e parafrazimit të fragmentit të shkëputur nga “ Komedia hyjnore” e Dante Aligerit: Çfarë është ruajtur dhe çfarë jo gjatë këtij procesi.

Hapi i tretë: Praktikë e pavarur
Rilexojmë dhe njëherë Këngën e Gjergj Elez Alisë. Më pas nxënësit në mënyrë të pavarur parafrazojnë këtë fragment.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Detyrë: Të kthejnë në prozë poezinë “ Vdekja e Nositit” nga Lasgush Poradeci.</td></tr>
</table>

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Kultura e antikitetit **Tema m**ësimore: Antikiteti greko-romak		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe**:** 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton kushtet që ndikuan në zhvillimin e letërsisë antike greke. 2. Tregon format e para të rrëfimit. 3. Identifikon motivet kryesore të lirikës.		**Fjalët kyçe:** *antikitet, periudha jonike, helenistike, klasike.*
Burimet: teksti mësimor, material nga historia, videoprojektor etj.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** letërsia e vjetër greke.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit, përmbledhje e strukturuar, stuhi mendimesh.		

Organizimi i orës së mësimi

Hapi i parë: Pema e mendimit



Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar



Hapi i tretë: Stuhi mendimesh

1. Ç' kuptojmë me termin letërsi antike greke? Cilat kushte ndikuan veçanërisht në zhvillimin e kësaj letërsie?
2. Cilat janë format e para të rrëfimit?
3. Me cilët autorë përfaqësohet periudha joniane? Si ndërthuret epizmi i Homerit, aventura e Odisesë me tematikën praktike të veprave praktike të Hesiodit?
4. Cilat janë motivet e lirikës?
5. Cilët janë tragjedianët e mëdhenj të periudhës klasike?
6. Mbi ç' lloj filozofie u organizua dhe u orientua letërsia në periudhën helenistike?
7. Në çfarë formash u shkrua letërsia romake? Pse themi që ajo frymëzoi të gjitha letërsitë e mëvonshme?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Të shohin dhe të diskutojmë rreth filmit "Troja".

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td colspan="2">Klasa: X Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Antikiteti
Tema mësimore: Homeri, jeta dhe vepra.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
3. Kompetenca personale
4. Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Diskuton për hipotezat e ndryshme në lidhje me ekzistencën e Homerit dhe veprën e tij.
2. Vlerëson rëndësinë e Homerit në letërsinë e mëvonshme.</td><td>Fjalët kyçe: çështje homerike,mite,perëndi,kori,fate të paracaktuara.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet: teksti mësimor.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, folklori mitologjia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, praktika e drejtuar, tabela e pyetjeve.</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në tabelë emrin e Homerit dhe u kërkon nxënësve të thonë se çfarë dinë rreth kësaj figure dhe veprave të tij.



Hapi i dytë: Praktikë e drejtuar

Lexojmë informacionin e tekstit mbi çështjen homerike por dhe rëndësinë që ka Homeri në letërsinë greke.

Hapi i tretë: Tabela e pyetjeve

Pyetje	**Përgjigje**
Çfarë simbolizon Homeri? Cilat janë hipotezat që ekzistojnë për të dhe veprën e tij?	
Pse Homeri konsiderohej i verbër? Si e shihnin figurën e tij qytete të ndryshme të asaj kohe?	
Mendoni se përmbajtja e veprave homerike është thjesht një tregues i shijeve personale apo i gjithë kulturës së kohës? Si quhet ndryshe vepra e Homerit?	
Cila është rëndësia e Homerit si babai i gjuhës dhe letërsisë greke?	

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Punë kërkimore: Informacione të ndryshme, foto, video etj. mbi Homerin dhe veprat e tij.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema m**ësimore: Poemat homerike. Analizë e veprës "Iliada"		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Identifikon veçoritë e poemës epiko-heroike. 2. Lexon pjesë nga poema. 3. Analizon poemën, duke u ndalur te veçoritë e poemës. epike: struktura e veprës, koha e rrëfimit, sistemi i personazheve, heroizmi, teknika e rrëfimit.		**Fjalët kyçe:** çështje homerike, Akil, Hektor, Helena, 24 këngë, 10 vjet.
Burimet: teksti mësimor, poema '"Iliada".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** mitologjia greke, historia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, vëzhgim, stuhi mendimesh, punë në grupe.		

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Diskutim

Kontrollojmë dhe diskutojmë mbi detyrat e shtëpisë. Lexojmë pjesët me intonacionin e duhur.

Hapi i dytë: Vëzhgim

Hartimi i skedës së poemës. Nxënësit lexojnë për disa çaste materialin në libër e më pas plotësojnë skedën.

Titulli	Iliada
Autori	Homeri
Lloji	Poemë epiko-heroike
Struktura	24 libra
Tema	Lufta e Akejve kundër Trojanëve
Hapësira	Troja (Ilion)
Sistemi i personazheve	Akili dhe Hektori: kulti i heroizmit Paridi dhe Helena: kulti i dashurisë Hektori dhe Andromaka: kulti i familjes Agamemnoni: kulti i sundimtarit
Mesazhi	Tragjizmi dhe heroizmi
Rrëfimi dhe përshkrimi	Teknika e rrëfimit dhe e përshkrimit është themelore. Nuk përshkruhet e gjithë lufta e Trojës, por vetëm 51 ditët e fundit të luftimeve.
Rrëfyesi	Mban distancë me lexuesin.
Stili	Ligjërim i lartë, stil heroik, elemente fantastike, elemente heroike

Hapi i tretë: Stuhi mendimesh U përgjigjemi pyetjeve**.** 1. Si shihen sot veprat homerike përmes ngjashmërive dhe dallimeve? 2. Çfarë rrëfen Iliada? Në cilin moment të luftës së Trojës zhvillohen ngjarjet në këtë vepër?Tregojini ato sipas kronologjisë dhe renditni ngjarjet kyçe mbi të cilat mbështetet ajo. 3. Iliada shquhet për skena të qarta dhe fantastike narracioni. Nga se karakterizohet ky narracion? 4. Nga buron karakteri epik i Iliadës?Cilat janë tiparet kryesore të këtij epizmi? **Hapi i katërt**: Punë në grupe Sipas sistemit të personazheve klasa ndahet në 4 grupe, ku secili grup rendit tiparet e veçantitë e personazheve.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.
Detyrë: Nënvizoni figurat letrare te fragmenti "Zemërata e Akilit" vargjet 1-19.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla**: V
Rubrika: Antikiteti **Tema m**ësimore**:** Fragment "Zemërata e Akilit"		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Bën koment të fragmentit,duke u ndalur te hyrja e poemës, fillesa e konfliktit, kulti i heroizmit, kulti i sundimtarit. 2. Gjen të dhënat që flasin për personazhin kryesor dhe personazhet e tjera. 3. Gjen figurat letrare dhe tregon funksionin e tyre stilistik. 4. Parafrazon vargjet, duke respektuar mjetet shprehëse gjuhësore të ligjërimit heroik.		**Fjalët kyçe:** *Akil Pelidi, Akej, Agamemnoni, Kriseida, Zeus.*
Burimet: teksti mësimor, poema Iliada.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, letërsia e vjetër greke.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: prezantimi i punës, pyetje- përgjigje, analizë, ditari dypjesësh, punë e pavarur.		

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Prezantimi i punës

Nxënësit lexojnë të dhëna për Ciklin e Atridëve, Agamemnoni, Menelau, Akili.

Hapi i dytë: Pyetje-përgjigje

Njihen nxënësit me temën dhe objektivat që duhet të arrijnë hap pas hapi. Një nxënës lexon fragmentin e dhënë. Më pas u përgjigjemi pyetjeve.

1. Nga buron zemërimi i Akilit?Pse autori i jep rëndësi ndjenjës së këtij kreshniku? Ç'lloj fatkeqësish sjell zemërimi i tij?
2. Në këtë këngë, zemërimi i Akilit nënkuptohet ose paralajmërohet. Si e realizon këtë autori? Cilat janë shenjat që paralajmërojnë që nga kjo nuk vjen asgjë e mirë?
3. Si hapet kënga? Çfarë kulture të kohës sjell folja *Këndo* dhe adresimi i këngës te hyjnesha?

Hapi i tretë: Analizë

1. Në këtë fragment vend të dukshëm zë figura e Agamemnonit. Cili është roli i tij në ushtrinë helene dhe si i kanë zemëruar hyjtë veprimet e tij? (kreshniku Atrid Agamemnon zëmadhi,/O lavdiploti Atrid lakmues për kamje)
2. Shpjegoni disa rite apo zakone të luftës në vargjet 160-170. (mbledhja e taksave,shitja e njerëzve si plaçkë lufte)
3. Analizoni përmes ilustrimeve nga fragmenti mbështetjen që hyjtë u japin personazheve dhe ngjarjeve në vepër. (167-170,230)

Hapi i katërt: Ditari dypjesësh

Punojmë me rubrikën Reflektim dhe vlerësim dijesh.

1. Agamemnoni për Krizidën dhe Klitemnestrën, Brizidën

Vargje	**Komenti**
Për vasho Krizidën,që e lakmoja aq tepër Ta mbaj për grua, e përnjëmend e dua	Bëhet komenti.
Klitemnestrën bashkëshorten time	--------
Brizidën faqetrëndafilen, Robinën tënde do ta rrëmbej n' çadër	--------

Në vepër triumfojnë parimet dhe ligjet hyjnore mbi ndjesitë dhe arsyet individuale. Shpjegoni mençurinë e mbretit dhe rëndësinë e mbizotërimit të detyrës mbi dëshirat personale, përmes tolerancës së Agamemnonit.

Vargjet	**Komenti**
Por megjithatë pranoj ta dorëzoj,(151 – 160 Në qoftë më mirë,pse unë ngaherë për popullin Dëshroj shpëtim e vdekjen kurrë nuk ia dua	Bëhet komenti.

Hapi i pestë: Punë e pavarur

Punojmë me rubrikën: Fjala dhe përdorimi i saj.

Analizojmë mbiemrat e përbërë: largshigjetuesi, zëmadhi, syvezulluesi janë epitete. Nga ana gjuhësore janë kompozita. Nxënësit punojnë duke treguar fjalëformimin e tyre.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Shkruani një tregim në prozë mbështetur mbi përmbajtjen e kësaj kënge,duke respektuar natyrën epike në rrëfim,përshkrimin e personazheve si dhe përdorimin e figurave letrare në këtë këngë të Iliadës.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema m**ësimore: Fragment " Hektori pret Akilin në duel"			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe 1.*Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2.*Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3.*Kompetenca personale* 4.*Kompetenca qytetare*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1.Lexon fragmentin. 2.Portretizon figurën e Priamit. 3.Analizon se si shfaqet njerëzorja në këtë fragment. 4.Parafrazon betejën midis Akilit dhe Hektorit.		**Fjalët kyçe:** *Akil Pelidi, Akej, Agamemnoni, Kriseida, Zeus, Hektor, duel.*	
Burimet: teksti mësimor; poema Iliada		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, letërsia e vjetër greke.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: prezantim, lexim dhe shpjegim teksti, analizë, rrjeti i diskutimit, praktikë e drejtuar.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Prezantim

Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë. Zgjidhen dy punët më të mira dhe bëjmë dhe vlerësime.

Hapi i dytë: Lexim dhe shpjegim teksti

Lexojmë fragmentin duke punuar dhe me pyetjet e rubrikës : studim teksti

1. Si del Priami në këtë këngë? Pse gjendja e tij psikologjike është e dyzuar? (vargjet 32, 45-49, 81-82)
2. Çfarë këshille i jep plaku të birit? Si lidhet kjo këshillë me mallkimin që vjen më pas?"

   Mos prit,Hektor,o biri im i dashur,
   Vetëm larg shokëve në mejdan t'i dalësh (këshillë)
   Dhe qentë e hëngshin (mallkim)
3. Pse vendimmarrja e Hektorit qëndron mbi gjithçka?Ku qëndron vlera e fjalëve të tij në dy vargjet e fundit? (144-145)
4. Në Iliadë shumë prej personazheve shohin nga kënde të ndryshme:
   a) Dikush nga fushëbeteja
   b) Një tjetër nga larg
   c) Një tjetër nga distanca

Hapi i tretë: Analizë

Komentojnë vargjet: "Dhe që e thërrasin qeni i Orionit/ Ndonëse ndër yje është më vezulluesi?/ Kobzi u del e dergje edhe rrënime u sjell të mjerëve…". (antitezë: vezullues – kobzi)

Si ndryshon rrëfimi tani që në skenë del Priami? Çfarë tonesh fiton ai? Gjeni figurat letrare. Si shfaqet njerëzorja në këtë fragment?

Hapi i katërt: Rrjeti i diskutimit

Si e shohin veten Me njëri -tjetrin	**Akil, Agamemnon, Hektor**	**Një sy i jashtëm**

Hapi i pestë: Praktika e drejtuar

1. Shpjegoni rolin e foljes "vegoi". Pse nuk thuhet pa apo vështroi?
2. Si ndryshon fjalori i Priamit kur përshkruan daljen e Akilit në betejë dhe më pas të Hektorit?

   Akili: Si gjarpri i malit, sytë e llahtarshëm shigjetonin përqark.

   Hektori: Biri im, Hektor punëmadhi.
3. Çfarë paralajmëron togu i fjalëve "natë e zezë"?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë:

- Atmosfera e dyluftimit ndihet sidomos në dy vargjet e fundit. Përshkruani në një tregim të shkurtër betejën midis Akilit dhe Hektorit, ashtu siç ju e përfytyroni.
- Gjeni në fragment krahasimin e zgjatur që i referohet Akilit dhe bazuar në këtë figurë letrare,krijoni një portret në vargje të këtij personazhi.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X **Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema m**ësimore: Eskili, jeta dhe vepra.		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin* 3. *Kompetenca personale* 4. *Kompetenca qytetare*		
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Eskilit,që ndikuan në krijimtarinë e tij. 2. Veçon veprat kryesore të Eskilit. 3. Analizon tiparet dalluese të krijimtarisë së Eskilit.		**Fjalët kyçe:** *dyluftim, Hektor, Akil, qeni i Orionit.*

Burimet: teksti mësimor, shkumësa me ngjyra.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, letërsia e vjetër greke.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: prezantim , stuhi mendimesh, praktikë e drejtuar, rrjeti i diskutimit.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Prezantim
Kontrollojmë dhe lexojmë detyrat e shtëpisë. Nxënësit paraqesin punët e tyre.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh
Mësuesja shkruan emrin e Eskilit në dërrasë. Nxënësit plotësojnë çfarë dinë rreth tij.



Hapi i tretë: Punë e drejtuar
Nxënësit lexojnë materialin në tekst për disa nga veprat e Eskilit dhe më pas diskutojmë rreth tyre. Punojmë me studimin e tekstit.

1. Sa nga veprat e Eskilit kanë mbërritur deri në ditët tona? (7 tragjedi)
2. Cilat vepra dhe autorë të mëvonshëm nga letërsia botërore u mbështetën në veprën e Eskilit dhe ne fatin e Orestia? (Shekspir, Orestia)
3. Cili është elementi i ri skenik te Persët? Ku është mbështetur autori për të shkruar këtë vepër? (hapja e tragjedisë nga kori i pleqve, për të shkruar këtë vepër është mbështetur në shpartallimin e armatës së Kserksit në Salaminë)
4. Pse një nga tragjeditë e Eskilit titullohet "Të shtatë kundër Tebës"? Tregoni pjesët e kësaj trilogjie. (subjekti i marrë nga Teba) (Llaji, Edipi, Sfinksi)
5. Diskutoni mbi karakterin meditues të tragjedisë Lutëset? Çfarë mesazhi përcillet përmes saj?
6. Cilët janë tri pjesët e tragjedisë Orestia? (Agamemnoni, Koeforet, Eumenidet) Ç' përfaqësojnë koeforet? Po vetë Oresti?

Hapi i katërt: Rrjeti i diskutimit		
PO	Fataliteti në veprën e Eskili. Problemi i së Drejtës si një nga konceptet më të famshme Letrare dhe filozofike të të gjitha kohërave.	JO
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore.		
Detyrë: Mësoni përmendësh një fragment nga një prej tragjedive të Eskilit.		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** XI	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikitet **Tema mësimore**: Analizë: "Prometeu i mbërthyer"		**Situata e të nxënit**: heronjtë mitologjikë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Ndërton historinë e mitit mbi të cilin mbështetet ky subjekt dramatik. 2. Shpjegon rolin e korit në strukturën e veprës dhe në zhvillimin e konfliktit. 3. Analizon raportin dinamik midis Prometeut dhe Zeusit.		**Fjalët kyçe**: *Prometeu i mbërthyer, kori, Zeusi, pushteti i dhunës.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga internet.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: prezantim, stuhi mendimesh, punë në grupe, reflektim kuptimor.			
Organizimi i orës së mësimit **Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme** **Hapi i parë:** Prezantim Nxënësit recitojnë pjesë të ndryshme nga tragjeditë e Eskilit. Ato lexohen me intonacionin e duhur, duke respektuar shenjat e pikësimit. Për të qenë më brenda veprës në sfond mund të ketë muzikë të vjetër greke.			

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh
Pyeten nxënësit se ç'dinë rreth Prometeut? Kush ishte ai dhe çfarë solli në letërsinë e vjetër greke ai?



Hapi i tretë: Punë në grupe
Ndahen detyrat sipas grupeve.
Grupi i parë:Të shpjegojë historinë e mitit mbi të cilin mbështetet ky subjekt dramatik.
Grupi i dytë:Të shpjegojë rolin e korit të Oqeanideve në strukturën e veprës dhe në zhvillimin e konfliktit dramatik.
Grupi i tretë:Të përcaktojë funksionin e prologut të veprës dhe të identifikojnë temat kryesore.
Grupi i katërt: Të analizojë raportin dinamik midis Prometeut dhe Zeusit.
Pas 10 minutash përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e grupit.

Hapi i katërt: Reflektim kuptimor
Nxënësit japin mendimet e tyre, por edhe reflektojnë mbi problematikat e ngritura.
A) Pse figura e Prometeut është simbolike?
B) Çfarë dëshmon fundi i tragjedisë Prometeu për lexuesin e ditëve të sotme?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i disa nxënësve me notë dhe nxirren konkluzionet e kësaj ore sipas objektivave të përcaktuara.

Detyrë: Të krahasojnë portretin e heroit siç e jep miti dhe siç e jep Eskili.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda:
Letërsi</td><td>Klasa: VI</td><td>Shkalla: III</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Antikiteti
Tema mësimore: Fragment “ Prometeu i mbërthyer”, akti I, Skena III (ora e parë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3.Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1.Rendit shpjegimet e Prometeut nga fillimi i fjalës e deri në fund.
2.Ilustron me shembuj rëndësinë e korit në këtë vepër.
3.Shpjegon qëndrimet e korit.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Kori, Prometeu.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, Prometeu i mbërthyer.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim, interpretim, ditari dypjesësh.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi i parë: Lexim , interpretim dhe shpjegim teksti
Lexojmë sipas roleve aktin I, skenën III. Lexojmë duke iu përgjigjur pyetjeve.
Me nxënësit po ndërtojmë në formën e një pazëlli figurën e Prometeut sipas pyetjeve të rubrikës
1.Konflikti: Pjesë e rëndësishme e subjektit. Prometeu u jep njerëzve zjarrin pa e pyetur Zeusin, i cili del nëpërmjet fjalëve të korit.
2.Gjatë këtij rrëfimi zbulohet dënimi që Zeusi i ka dhënë Prometeut. (sherri midis hyjnive për rrëzimin e Kronit dhe vendosjen në vend të tij të Zeusit, ndihma që i dha Zeusit, mosmirënjohja nga ana e tij, shpirtligësia e Zeusit për ta shfarosur fare racën njerëzore, krijimi i një tjetre sipas dëshirës së tij, dalja kundër këtij vendimi të Zeusit e Prometeut etj…, Fjala e Prometeut)
3.Zeusi: servil, mosmirënjohës, shpirtzi, dredharak etj.
4.Mosmirënjohja e Zeusit ndaj Prometeut (vargjet (23-53). Këtu del fytyra e vërtetë e sundimtarit.
5.Këshilla: Nëna ime e quajtur Temis edhe Tokë
Q’ishte një fytyrë,po ka shumë emra
Më kish parafolur se në kohë të ardhme
Dhe nuk do t’ ish nevojë për fuqi e forcë
Po dredhia vetëm do të triumfonte</td></tr>
</table>

Hapi i dytë: Ditari dypjesësh
Nxënësit japin mendimin e tyre.
Komentoni vargjet e korit

Vargjet	**Komenti**
Zbuloi të gjitha dhe thuaj fajin Për të cilin Zeusi ty të ka dënuar Me këtë dënim t' egër e t' hidhur Na e thuaj neve në s'të sjell mërzi	Nxënësi komenton

Shpjegoni dy qëndrimet e korit në këto vargje:

Vargjet	**Shpjegimi**
Zbuloi të gjitha dhe thuaj fajin Për të cilin Zeusi ty të ka dënuar Me këtë dënim të egër e të hidhur Na e thuaj neve në stë sjell mërzi	Nxënësi shpjegon dhe argumenton

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Ç'përfaqëson për ju tashmë Prometeu?

Detyrë: Megjithëse vepra si Prometeu i kanë të qarta mesazhet që përcjellin,duhet të dimë të veçojmë vargjet ku jepen ato dhe të parafrazojnë apo të krijojnë ide rreth kuptimit të tyre të mëtejshëm.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema m**ësimore: Fragment "Prometeu i mbërthyer", akti I, skena III (ora e dytë)		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 4. Përcakton momentet ku Prometeu shfaqet si : misionar, liridashës, luftarak. 5. Analizon mesazhet që përcjell ky fragment. 6. Gjen dhe shpjegon antitezën në fragment që e tregon atë fajtor dhe të pafajshëm në të njëjtën kohë. 7. Gjen shprehje dhe epitete që tregojnë tiraninë e Zeusit		**Fjalët kyçe:** *kori,Prometeu.*	
Burimet: teksti i nxënësit, vepra "Prometeu".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare**: historia, fjalori mitologjik.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe prezantim, reflektimi kuptimor, tabela e figurave.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Leximi dhe prezantimi i detyrave të shtëpisë
Lexojmë detyrat disa parafrazime që nxënësit kanë krijuar.
Hapi i dytë: Reflektim kuptimor
Bashkë me nxënësit reflektojmë mbi ato që mësuam duke iu mbështetur edhe në pyetjet e rubrikës.

1. Misionar: Në shpirt u kam kallur shpresë
   Unë edhe zjarrin u dhurova atyre
   Prej këtij dhe artet do mësojnë shumë
2. Prometeu nëpërmjet realizimit të këtij misioni u dha njerëzve shpresë.
3. Zeusi nga Prometeu : tiran i hyjve, Zeusi nga Kori: zemër hekur, zemër gur.

Hapi i tretë: Tabela e figurave

Figura	**Shpjegimi**
Antiteza: faj me dashje	
Shprehje: zemër ka të hekurt dhe është prej guri,tiran i hyjve	Tregohet natyra dhe karakteri i Zeusit.
Pyetje retorike: Mos ke shkuar vallë edhe ca më tej?	Të gjithë e dinin veprën e Prometeut.
Është dhuratë e vyer.	Për njerëzit kjo ishte një rilindje, një jetë e re.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit.

Detyrë: Ndaluni te dy vargjet e fundit dhe shkruani një ese me teme: "Fat i keq që sillet dhe shkon kudo/ Ky i prek të gjithë dhe i bie kujtdo".

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema mësimore**: Fragment "Prometeu", akti V, skena I,		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan figurën e Prometeut në këtë fragment. 2. Analizon shkallëzimin rritës në etiketimet që Hermesi i bën Prometeut. 3. Shpjegon rolin e figurave letrare në këtë skenë. 4. Gjen elementet skenike që ndihmojnë në përfytyrimin për ngjarjen.		**Fjalët kyçe**: *Prometeu, kori, Mërkuri*	

Burimet: teksti i nxënësit, material.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, fjalori mitologjik.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: prezantim , lexim dhe shpjegim teksti, pyetje-përgjigje, tabela e figurave, punë e pavarur.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Prezantim
Lexojmë detyrat e shtëpisë.
Hapi i dytë: Lexim dhe shpjegim teksti
1. *Prometeu parashikues: Do shoh si do përmbyset dhe të tretin*
Prometeu ironik: Ai që sundon tani në qiell do bjerë
Më shpejt dhe më me turp sesa të tjerët
Prometeu moskokëçarës: Vër majat nga ke thembrat! Mbathja shpejt

2. Shkallëzimi rritës që Hermesi i bën Prometeut: Me ty,që pasurove njerëzit e vdekshëm/ Me ty,hajdut i zjarrit të perëndive etj.
3. Elementet skenike janë: dialogu, pyetjet, pasthirrmat etj.

Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje
4. Çfarë i bën më shumë përshtypje Hermesit në natyrën e Prometeut?Ç'ndien ai për të?
1. Pse Prometeu nuk ka frikë nga asgje?
2. Si e vlerëson kori të gjithë këtë dialog midis dy personazheve?
3. Si del Hermesi në këtë fragment?Ku duken servilizmi dhe keqdashja e tij?
4. Si e quan Prometeu,Hermesin?
5. Pse Eskili parashtron më vete aftësinë parashikuese të Prometeut?Ç' synon ai përmes saj? Ç' mesazh përcjell?

Hapi i katërt: Tabela e figurave

Figura		**Roli i tyre**
Anafora	Me ty, o dhelpër,tallës e përbuzës, Me ty, o tradhtar i perëndive	Përsërit veprimet e bën më tingëlluese dhe e thekson
Epiteti	Të rinj,të bindur	

Nxënësit dallojnë figurat dhe plotësojnë tabelën duke treguar dhe rolin e tyre.
Hapi i pestë: Praktika e pavarur
Nxënësit gjejnë pasthirrmat dhe foljet që tregojnë tonin urdhërues. Nxënësit gjejnë edhe shkallëzimin rritës me synim zbërthimin e rolit dhe natyrës së "shërbyesit" të Zeusit.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Pse Eskili me Prometeun bëhet zëdhënës i kohëve moderne?* Vlerësohen nxënësit me notë.

Detyrë: Interpretoni dialogun midis Prometeut , Hermesit dhe Korit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema mësimore**: Euripidi, jeta dhe vepra.		**Situata e të nxënit**: Tragjedia antike	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Euripidit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij. 2. Veçon veprat kryesore të Euripidit. 3. Analizon tiparet karakteristike të tragjedive të tij. 4. Vlerëson risitë që solli Euripidi në letërsinë.		**Fjalët kyçe**: *Euripidi, tragjedian, Medea, heronj kontradiktorë etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale të ndryshme,shkumësa me ngjyra etj.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, arti.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, pyetje-përgjigje, diagrami i Venit, reflektimi kuptimor.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Në dërrasë mësuesja shkruan emrin e Euripidit. Nga ato që nxënësit dine, por edhe me ndihmën e mësueses shkruajnë ç' dinë rreth tij.



Veçoritë artistike:

- Euripidi solli një frymë të re në artin e kohës, duke u quajtur filozof i skenës.
- Qendërzimi i figurës së gruas dhe trajtimi i saj si e barabartë me burrin.
- Depërtoi në thellësi të personazhit, duke krijuar dramën me konflikt psikologjik.
- Thjeshtësia, kuptueshmëria.
- Ndryshoi format tradicionale.

Hapi i dytë: Pyetje-përgjigje

Lexojnë materialin në libër e më pas mësuesja u drejton pyetje klasës.

1. Si portretizohej Euripidi nga bashkëkohësit në jetën e përditshme
2. Mbi çfarë idesh u formua botëkuptimi i Euripidit?

3.
4. Me cilët nga autorët e tjerë të antikitetit ishte në konkurrencë të përhershme ai?
5. Pse Euripidi u vlerësua më shumë pas vdekjes?
6. Cilat janë arsyet që e bëjnë Euripidin një nga tragjedianët më të mëdhenj të të gjitha kohërave?
7. Ç'peshë i dha tragjedisë dhe artit skenik ndërfutja e duetit gjatë interpretimeve aktoriale?
8. Pse themi që Euripidi krijoi dramën psikologjike?

Hapi i tretë: Diagrami i Venit

Novatorizmi i Euripidit në krahasim me Eskilin dhe Sofokliun.



Hapi i katërt: Reflektim kuptimor

Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre.

	Diskutim	
	Thjeshtësia e veprës së Euripidit	

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Cili është vendi i Euripidit në letërsinë botërore dhe ç'përcjell vepra dhe psikologjia e saj për të gjithë ne sot?*

Detyrë: Renditni disa personazhe femra që zënë vendin qendror në veprat e Euripdit.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema mësimore**: Analizë e veprës "Medea"		**Situata e të nxënit**: tragjedia "Medea"	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Ritregon mitin mbi të cilin mbështetet tragjedia "Medea". 2. Rendit motivet që e udhëheqin hakmarrjen e Medeas. 3. Rendit personazhet e veprës dhe përshkruan psikologjinë e secilit prej tyre. 4. Analizon efektin " deux ex machine" (zgjidhjen artificiale) mbi lexuesin. 5. Diskuton mbi elementet e intrigës, të peripecisë dhe të ngjarjes së jashtëzakonshme. 6. Shpjegon se si në këtë vepër pasioni ecën paralelisht me urrejtjen.		**Fjalë kyçe**: *Medea, Jasoni, Kreoni, hakmarrje, karrocë fluturuese etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale të ndryshme,foto.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, fjalori mitologjik.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim, stuhi mendimesh, hap pas hapi , praktikë e drejtuar, rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim
Lexojmë Mitin e Jasonit dhe diskutojmë mbi të. Tregojmë se si e mori Euripidi lëndën e parë dhe e trajtoi atë .
Hapi i dytë: Stuhi mendimesh
I lëmë nxënësit për 15 minuta të lexojnë materialin në libër e më pas diskutojmë mbi veprën "Medea".



Hapi i tretë: Hap pas hapi
Mësuesja i drejton pyetje klasës rreth informacionit të ri.
1. Çfarë rrëfehet në këtë tragjedi?
2. Në ç'rrethana e vendos Medean Euripidi?
3. Cilat motive e udhëheqin hakmarrjen e saj?
4. Pse themi që tragjedia ka subjekt të thjeshtë? Si paraqitet kompozicioni i strukturës së tragjedisë?
5. Në anën e kujt qëndron Euripidi në këtë tragjedi?

Hapi i katërt: Praktikë e drejtuar
Të renditin personazhet e veprës dhe të përshkruajnë psikologjinë e tyre Medea, Jasoni, Pedagogu.



Hapi i pestë: Rrjeti i diskutimit



Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Ç'përfaqëson Medea sot?

Detyrë: Ritregoni mitin mbi të cilin mbështetet tragjedia Medea.

<table>
<tr><td>Rubrika: Antikiteti
Tema mësimore: Koment: “Medea”, konflikti psikologjik i Medeas (ora e parë)</td><td>Situata e të nxënit: Punë me tekstin</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3. Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Tregon bisedën që zhvillohet midis Medeas dhe Pedagogut.
2. Rendit dhe numëron çdo dëshirë që nëna shpreh për fëmijët ë saj.
3. Gjen momentet kur Medea shpreh nota dyshimi, krenarie, dileme dhe guximi të pandalshëm.
4. Përshkruan kompleksitetin e figurës së Medeas.</td><td>Fjalët kyçe: Pedagogu, Medea nëna korbë, djemkat e nënës.</td></tr>
<tr><td>Burimet: teksti i nxënësit, shkumësa me ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia, fjalori mitologjik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lidhja e temës me njohuritë e mëparshme, lexim dhe shpjegim, diskutim, punë e pavarur.</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Ritregojmë mitin duke e lidhur me subjektin e tragjedisë "Medea".

Hapi i dytë: Lexim dhe shpjegim

Lexojmë dialogun midis Medeas dhe Pedagogut duke nxjerrë në pah konfliktin psikologjik të saj.

- Çfarë shtrohet për diskutim midis Medeas dhe Pedagogut? Cili është roli i këtij të fundit?Ç'kërkon të arrijë Medea? Largimi i Medeas, Pedagogu porositet t 'i përgatitë djemtë për t'u ndarë nga e ëma, meqenëse ajo është e detyruar të largohet sipas urdhrit të Kreonit).
- Komentoni vargun: *Po si njerëz që jemi duhet të durojmë çdo fatkeqësi.*
- Ç' nënkupton shprehja: *Ah e mjera unë!?*
- Cilat janë ëndrrat e prishura të Medeas nënë? A e përgatit situatën Euripidi, në mënyrë që përmes tyre të justifikojë veprimin e mëvonshëm të Medeas? (Fjala e Medeas, vargjet 16-42)

Hapi i tretë: Diskutim

Një nga konceptet mbizotëruese në tragjedi është konc epti i fajit të Jasonit. Si është i lidhur ai me konceptin në antikitet, sipas së cilit disa zgjidhje bëheshin për arsye politike, siç është rasti i poligamisë dhe i martesave për arsye politike.

Hapi i tretë: Praktika e pavarur:

Përshkruajnë kompleksitetin e figurës së Medeas.



Vlerësimi:

Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Si mund ta përshkruanit me një paragraf figurën e Medeas?*

Detyrë: Si i përshkruan Medea fëmijët? Diskutoni rreth këtij përshkrimi dhe mesazhit që ai përcjell. Me çfarë mjetesh apo figurash letrare realizohet ky përshkrim?

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: VI</td><td>Shkalla: III</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Antikiteti
Tema mësimore: Koment: “Medea”, konflikti psikologjik i Medeas (ora e dytë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Punë me tekstin</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3.Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Përshkruan brishtësinë dhe natyrshmërinë e Medeas nënë para se ajo të vendosë për kryerjen e krimit.
2. Shpjegon raportin midis Medeas nënë dhe Medeas hakmarrëse.
3. Identifikoni fjalët kyçe që tregojnë hap pas hapi gjendjen psikologjike të Medeas.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: kokë e shtrenjtë, fëmijës tim, Medea, pedagogu.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, shkumësa e ngjyra.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: analizë përmes shembujve, Diagrami i Venit, praktikë e pavarur.</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Analizë përmes shembujve

Lexojmë monologun e Medeas dhe më pas u japim përgjigje pyetjeve duke e ilustruar me shembuj.

1. Medea në monologun e saj duket e butë, e dobët, plot përulje dhe falje. Ky monolog e zbulon më së miri natyrën e saj.
2. Medea nuk tërhiqet nga vendimi I saj: Vaftë mu në dreq?/ Plani im i parë/ Do t'i heq fëmijët/ nga ky vend këtu. (ajo nuk heq dorë për shkak te urrejtjes ndaj Jasonit)
3. Medea dyshuese: Obobo! Ç' të bëj?/ Shpirti më këputet etj.

Medea është në dilemë: Si? Vallë mos duhet/ Që t'i lë fatkeq etj.

Hapi i dytë: Diagrami i Venit

Analizojmë raportin midis Medeas nënë dhe Medeas hakmarrëse. Nxënësit mund të shtojnë elemente të tjera rreth saj.



Hapi i tretë: Praktikë e pavarur

1. Nxënësit identifikojnë fjalët kyçe që tregojnë gjendjen psikologjike të Medeas. (nëna korbë, syrgjyn, koka ime e fortë, thesar të nënës, shpirti me këputët, shpiti frikacak etj.)
2. Vaji i Medeas shoqërohet me thirrma rrëqethëse. (O djemkat e nënës, o! Ç'mjerim më solli, Obobo! Ç' të bëj?, Oh e mjera unë etj.)

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: A mendoni që Medea është një figurë komplekse që ka dhe nuk ka të drejtë në të njëjtën kohë?

Detyrë: Bazuar në natyrën komplekse të Medeas, analizoni antitezën e fortë të këtyre vargjeve: Duhet të guxoj/ Sa e dobët qenkam.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Bisedë letrare **Tema mësimore**: Letërsia antike greke: "Bretkosat", Aristofani		**Situata e të nxënit:** Bisedë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Kupton rëndësinë e letërsisë greko-romake 2. Njihet me sfondi historik dhe kulturor ku u zhvillua kjo letërsi. 3. Njihet me Euripidin, jetën dhe veprën e tij. 4. Analizon veprën "Bretkosat".		**Fjalët kyçe**: *Dionisi,Eskili, Euripidi,kori.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historinë, gjuha shqipe, fotografia, piktura,teatri.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, subjekti, lexim dhe interpretim, ditari dypjesësh, punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Kujtojmë ç'dimë për Aristofanin.



Hapi i dytë: Subjekti

Nxënësit tregojnë subjektin e veprës.

Kjo komedi i kushtohet posaçërisht problemeve të artit e cila u shfaq në vitin 405. Në këtë kohë ende ishte I freskët kujtimi i dy poetëve të mëdhenj Sofokliut dhe Euripidit që kishin vdekur një vit më parë.

Perëndia Dioniz, aty ku ka zanafillën tragjedia është i shqetësuar për vdekjen e dy poetëve se mendon se teatri i Athinës do të mbetet shkretë. Kjo është arsyeja që e çon Dionisin të shkojë në botën tjetër. Me qëllim që të marrë me vete Euripidin. Dionisi vesh lëkurën e luanit për t'u mbrojtur. Mbas një udhëtimi të gjatë e plot rreziqe në botën e Hadit, ku Dionisin e shoqëron kori I Bretkosave,autori na çon në pallatin e Plutonit, ku skllavi Eak e kujton si Herakliu dhe i turret ta rrahë.

Aristofani nuk e pranon metodën letrare për të hyrë brenda botes së personazheve për të zbuluar ndjenjat prirjet,të shkëputura këto nga idealet dhe detyrat ndaj popullit. Ideali i poetit për Aristofanin është Eskili që e edukon popullin me një poezi të lartë,plot patos qytetar e ndjenja sublime. Dueli letrar në komedi vazhdon I ashpër midis dy poetëve,të cilët analizojnë një për një vargjet dhe prologët e veprave të tyre,nxjerrin gabimet e njëri-tjetrit në fjalë,shprehje,figura,derisa më në fund, Dionisi detyrohet t'i vendosë në peshore fjalët e tyre. Peshorja herë anon nga Euripidi ,po më shumë nga Eskili,i cili pas një lufte të ashpër del fitues. Dionisi e merr Eskilin me vete në botën e të gjallëve dhe e bën përsëri zot në skenën greke

Hapi i tretë: Lexim dhe interpretim

Lexojmë aktin V, skena I nga Bretkosat. Në këtë fragment zhvillohet një bisedë midis Dionisit, Eskilit, Euripidi dhe korit.

Në këtë debat Aristofani kërkon të jetë i paanshëm, megjithatë simpatia e tij anon nga Eskili. Në vargjet e saj shprehet mendimi për secilin nga ata.

- Euripidi niset nga parimi"mbrojtja më e mirë është sulmi"
- Eskili supozohet se përdor "fjalë të mëdha"

Hapi I katërt: Ditari dypjesësh

Në këtë komedi hidhen fillesat e para të debatit intelektual dhe letrar. Fragmentet më pikante ato që trajtojnë një problem apo përcjellin një mesazh nxënësit I komentojnë.

a) Në Greqinë antike demokratizimi i artit arriti kulmin e vet. Komentojmë fjalët e korit.

Vargjet	**Komenti**
Ejani dhe shihni… Se tashti po nis Një garë e madhe, Gara e diturisë	Gara, konkursi ishte peshorja, e cila nuk gabonte në matjen e vlerave. Ky është një tregues I vërtetë për një shtet demokratik dhe të mendosh se ndodh mijëra vjet më parë.

b) Aristofani vë në pah veset e realitetit.

Vargjet	**Komenti**
Unë në skenë nxjerr ato gjëra Që ndodhin n' jetën tonë përditë, Që I përdorim,që I jetojmë, Kështu kritikës s'i shpëtoj dot.	Për një shkrimtar nuk është e lehtë të pasqyrojë veset e realitetit të përditshëm. Roli i tyre është pikërisht ky.

c)Fjalët e Dionisit

Vargjet	Komenti
Këtu, këtu E quajnë të ditur,ay atje Më kënaq shpirtin	Arti përvese funksionit njohës ka edhe një funksion estetik. Nëpërmjet së bukurës ai ndikon emocionalisht te lexuesi.

Hapi i tretë: Punë në grupe

Mbështetur në argumentet që sjellin Eskili dhe Euripidi në garën e madhe të tragjedisë, plotësojmë tabelën.

Grupi 1: Eskilin

Grupi 2: Euripidin

Argumenti	Eskili	Euripidi
Ndërtimi I tragjedisë		
Personazhet		
Subjektet		
Stili		
Roli i korit		
Misioni i artistit		
Funksioni i artit		

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Ç'*mësuam* në këtë orë?

Detyrë: Improvizoni një garë mes dy shkrimtarëve shqiptarë që njihni. Shkruani 5 pikat mbi të cilat do të ngrihet ky debat letrar.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Antikiteti **Tema mësimore:** Përsëritje		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Rendit tiparet kryesore të folklorit. 2. Zbulon disa nga mitet më të njohura të antikitetit grek. 3. Analizon vlerën e veçantë te krijimtarisë së Thimi Mitkos dhe Jeronim De Radës. 4. Kupton rolin e Ciklit të Kreshnikëve në krijimtarinë gojore. 5. Krahason eposin tonë me atë grek. 6. Portretizon një nga personazhet kryesore: Medea, Gjergj Elez Alia, Oresti, Akili. 7. Diskuton mbi dialogun dhe monologun në veprat e Euripidit dhe të Eskilit. 8. Parafrazon pjesë të ndryshme nga Cikli i Kreshnikëve dhe nga antikiteti grek.		**Fjalët kyçe**: *folklor, antikitet, mit, tipar, Cikli i Kreshnikëve.*	

Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare**: historia, gjeografia, fjalori mitologjik, folklori shqiptar, "Bleta Shqiptare" Thimi Mitko etj.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: konkurs, pyetje-përgjigje, pyetje me shtjellim.	

Organizimi i orës së mësimit

Kjo orë mësimi mund të zhvillohet si bashkëbisedim ose në formë konkursi.

Hapi i parë: Klasa ndahet në grupe

Ndarja mund të bëhet midis vajzave dhe djemve,sipas alfabetit ose sipas bankave.

Pyetjet do të ndahen në disa stade:

1. Pyetje përgjigje: Secilit grup i drejtohen pyetje të ndryshme.
   - Cilat janë tiparet kryesore të folklorit?
   - Çfarë dëshmojnë krijimet folklorike për jetën, natyrën, njerëzit dhe marrëdhëniet mes tyre?
   - Cilët janë disa nga mbledhësit më të mëdhenj të folklorit vendas dhe të huaj?
   - Ç'është mitologjia shqiptare? Si përfaqësohet ajo në krijime të ndryshme?
   - Në ç'mënyrë dhe formë vijnë këngët e Ciklit të Kreshnikëve deri në ditët tona? Ku qëndron vlera e tyre?
   - Cilat janë disa nga mitet më të njohura mbi të cilat u mbështetën veprat më të mëdha të antikitetit?
   - Ku qëndron thjeshtësia e motiveve dhe temave që trajtojnë veprat Iliada dhe Odisea?
   - Kush qëndron në qendër të trilogjisë Orestia?
   - Ku qëndron thelbi tragjik i Medeas? Po kompleksiteti i figurës së saj?
   - Çfarë kanë të ngjashme zakonet e vjetra jetësore të Gjergj Elez Alisë, Iliada dhe Eskili?
   - Pse Homeri u quajt "babai" i gjuhës greke?
   - Ç'nënkupton shprehja: "Zemërimi i Akilit"?
2. Pyetje me shtjellim. Në këtë stad pyetjet kanë nevojë për shtjellim dhe për një përgatitje më të madhe nga ana kuptimore. Në fillim drejtohet pyetja e më pas nxënësve u lihet pak kohë (5 minuta) për t'u përgatitur.

Grupi 1:
- Ritregoni brendinë e këngës Gjergj Elez Alia, duke nxjerrë në pah madhështinë e personazhit të saj.
- Përshkruani shkurtimisht portretet e kryetrimave në Iliadë dhe raportet si: baba, komandant, bashkëshort.
- Interpretoni një ninullë dhe një këngë dasme (vargjet).
- Përshkruani figurën e Medeas si nënë dhe si grua.
- Parafrazoni një fragment nga vepra Iliada

Grupi 2:
- Renditni temat dhe motivet që trajtojnë dy veprat më të rëndësishme të letërsisë antike Iliada dhe Odisea.
- Përmendni dy vepra të Thimi Mitkos dhe Jeronim De Radës dhe tregoni vlerën e veçantë që sollën në kohën që jetuan

• Interpretoni një këngë historike dhe një gjëegjëzë (vargjet). • Përshkruani figurën e Andromakës si bashkëshorte dhe si grua. • Parafrazoni një fragment nga Gjergj Elez Alia.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit dhe vlerësohen disa prej tyre.
Detyrë: **Grupi 1.** Bëni një ese krahasuese rreth personazheve femra të portretizuara deri tani. **Grupi 2.** E drejta është një mekanizëm lëvizës. Shkruani një ese me këtë temë, duke pasur parasysh trajtimin e këtij koncepti nga Eskili.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: **Tema mësimore**: Testim		**Situata e të nxënit**: Të shkruajmë së bashku	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Konsolidon njohuritë e deritanishme. 2. Njoh dhe përcakton gjinitë letrare dhe figurat letrare. 3. Shpjegon mbi autorë të ndryshëm të antikitetit. 4. Analizon vepra të antikitetit. 5. Vlerëson këto vepra në kontekstet e ditëve tona. 6. Zbulon lloje të ndryshme folklorike. 7. Analizon shembuj nga folklori. 8. Vlerëson folklorin përmes Ismail Kadare.		**Fjalët kyçe**: *subjekt, kompozicion, personazh, motive, mesazhi, fabula, letërsi antike, mitet, personazhet etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale të bisedave letrare, leximet e ndryshme plus që keni zhvilluar.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, kinematografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, punë e drejtuar, punë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimit			
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i testit.			
Detyrë: Njohja me natyrën e testit dhe qëllimin e zhvillimit të tij. Shembuj testesh.			

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsia e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Letërsia e vjetër shqipe		**Situata e të nxënit:** Shkrimet e para, Perikopeja e Ungjillit të Pashkës, Formula e pagëzorit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Analizon kushtet historike dhe kulturore në të cilat u shkrua letërsia e vjetër shqipe. 2. Veçon dhe vlerëson përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së vjetër shqipe dhe krijimtarinë e tyre letrare.		**Fjalët kyçe:** *dokumentet e shqipes së vjetër, humanistë shqiptarë, Marin Barleti, Meshari I Gjon Buzukut.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare**: historia, gjeografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit , lexim dhe diskutim, stuhi mendimesh.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Pema e mendimit



Hapi i dytë: Lexim dhe diskutim

Lexojmë material plotësuese: pjesë nga " Meshari", etj. Më pas diskutojmë me nxënësit mbi këtë material.

Hapi i tretë: Stuhi mendimesh • Me cilët tregues historikë dhe letrarë është i lidhur emërtimi i Letërsisë së vjetër shqipe? • Cili është funksioni fillestar i kësaj letërsie? • Cilat janë format e lëndës së pasur gjuhësore? • Çfarë paraqesin dy veprat e njohura të kësaj letërsie: Këngët e Sibilave dhe Gjella e Shën Mërisë Virgjër? • Si vlerësohet humanizmi i autorëve të kësaj periudhe dhe ku mbështetet ai? • Ç'interes shfaqin vlerat e kësaj periudhe?
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke i vlerësuar ata.
Detyrë: Sillni materiale të ndryshme mbi autorët e letërsisë së vjetër shqipe.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsia e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Marin Barleti, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Barletit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij 2. Vlerëson figurën dhe kontributin e Marin Barletit.		**Fjalët kyçe:** *Barleti, Humanizmi, letërsia e vjetër, historia etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia,fjalori mitologjik, folklori shqiptar, "Bleta Shqiptare" Thimi Mitko etj.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, pema e mendimit, reflektim kuptimor, stuhi mendimesh.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Diskutim

Lexojmë materialin " Mbi Barletin dhe shkrime të tjera" nga Dhimitër Shuteriqi dhe më pas diskutojmë mbi figurën e tij.

Hapi i dytë: Pema e mendimit

Mësuesja shkruan në dërrasë emrin e Marin Barletit dhe më pas nxënësit e plotësojnë.



Hapi i tretë: Reflektimi kuptimor

1. Kujtoni qëllimin e letërsisë humaniste. Pse Barleti konsiderohet humanisti i madh i letërsisë shqipe.



Hapi i katërt: Stuhi mendimesh

Çfarë qëndronte në bazë të veprimtarisë së tij?

Pse themi që vepra e Barletit ka karakter subjektiv?

Pse informacioni që jep Barleti u shfrytëzua më vonë nga shumë autorë?

Cila është vlera dhe rëndësia e dyfishtë e kësaj vepre sipas studiuesve të të gjitha kohërave?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke i vlerësuar ata.

Detyrë: Gjeni materiale të ndryshme mbi jetën, veprën e Marin Barletit.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X</td><td>Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Letërsia e vjetër shqipe
Tema mësimore: Analizë: “Historia e Skënderbeut”, Marin Barleti</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Skënderbeu heroi ynë kombëtar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë \
3. Kompetenca personale
4. Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Ritregon përmbajtjen e veprës.
2. Zbulon rolin e kronologjisë në këtë vepër.
3. Ilustron me shembuj figurash leksikun e pasur poetik të kësaj vepre.
4. Diskuton rreth tipareve humaniste që mbart vepra.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Skënderbeu, 13 pjesë, dokumente historike, ligjërim shprehës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti, vepra: “Historia e Skënderbeut” e Marin Barletit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, harta e veprës, praktikë e drejtuar, praktikë e pavarur, përmbledhje e strukturuar.</td></tr>
</table>

Organizimi i orës së mësimit

Punë parapërgatitore: Shohim pjesë nga filmi " Skënderbeu".

Hapi i parë: Diskutim

Së bashku me nxënësit diskutojmë mbi figurën e Skënderbeut. Si e njohim ne atë nëpërmjet historisë, cili ishte roli i tij në shek XV. Cilët shkrimtarë e kanë trajtuar figurën e Skënderbeut etj.

Autorët shqiptarë që janë mbështetur në veprën e Marin Barletit janë: Naim Frashëri, "Historia e Skënderbeut"; S.Godo, "Skënderbeu"; Fan S.Noli "Historia e Skënderbeut". Sjellim informacione të ndryshme.

Hapi i dytë: Harta e veprës.

Nxënësit e plotësojnë vetë hartën.



Hapi i tretë: Praktikë e drejtuar

Të tregojnë në përmbajtjen e subjektit sipas rendit kronologjik.

Kjo vepër jepet në mënyrë kronologjike: që nga momenti i lindjes e deri në vdekjen e Skënderbeut.

Hapi i katërt: Praktikë e pavarur

Nxënësit të Ilustrojnë me shembuj figurash leksikun e pasur poetik të kësaj vepre (krahasime, antiteza etj.)

Hapi i pestë: Përmbledhje e strukturuar

Së bashku me nxënësit tregojmë tiparet humaniste që përmban vepra.

Tipare të humanizmit:

- Natyra njerëzore
- Ndryshimi ndërmjet natyrës njerëzore dhe hyjnore
- Njerëzit duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin
- Ekzaltim për njeriun
- Adhurimi për lirinë
- Liria e mendimit
- Kërkimi i drejtësisë
- Ligjësia morale

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke i vlerësuar ata.

Detyrë: Lexoni fragmentin duke e vënë veten në vendin e Skënderbeut.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X</td><td>Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Letërsia e vjetër shqipe
Tema mësimore: Fragment nga “ Historia e Skënderbeut” libri I parë (ora e parë)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Shek XV</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3. Kompetenca personale
4. Kompetenca digjitale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Lexon dhe interpreton pjesën.
2. Zbërthen dhe shpjegon informacionin që merr nga fragmenti.
3. Dalloni subjektivitetin dhe emocionalitetin në këtë fragment.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: krerët bujarë, Mamica, kapedanë dhe ushtarë trima, atdhe, mynxyrën barbare etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti I nxënësit, material nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë në grupe, vështrim krahasues.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Hapi i parë: Punë në grupe
Nxënësit ndahen në grupe dhe secili do të trajtojë një nga çështjet :
Grupi i parë: Të tregojnë se ku u mbështet Barleti për shkrimin e kësaj vepre.
Grupi i dytë: Të zbërthejnë dhe shpjegojnë informacionin që merrni nga fragmenti për sa u përket personazheve, datave, numrave, ngjarjeve dhe atmosferës.
Grupi i tretë: Të gjejnë në këtë fragment ngjarje ku ndihet subjektiviteti dhe emocionaliteti
Hapi i dytë: Vështrim krahasues
Pasi lexojmë shprehjen e kësaj vepre: “Lirinë nuk e solla, por e gjeta unë këtu” etj. E krahasojmë këtë fjalim të Skënderbeut para popullit të Krujës me atë përpara princërve.</td></tr>
</table>



Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke I vlerwsuar ata.

Detyrë: Dalloni llojet e paragrafëve në këtë fragment.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsia e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Fragment nga "Historia e Skënderbeut" , libri i parë (ora e dytë)		**Situata e të nxënit:** Shek XV	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan larminë e fjalëve të Skënderbeut. 2. Diskuton rreth llojit të ligjërimit dhe pranisë së një stili të rrjedhshëm dhe dinamik. 3. Krahason paragrafët e fragmentit, duke identifikuar këndvështrimet e ndryshme të ngjarjeve. Gjen dhe analizoni detaje të leksikut.		**Fjalët kyçe:** *hero, Skënderbeu, osmanlinj, kala.*	

Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: praktikë e drejtuar, praktika e pavarur, krahasim.	
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë:** Praktikë e drejtuar Pasi rilexojmë edhe njëherë tekstin përshkruajmë larminë e fjalëve të Skënderbeut. Ai karakterizohet nga : - ligjërimi i saktë; - ndërtimi i fjalisë; - zgjedhja e fjalës; - përdorimi i përemrit. **Hapi i dytë:** Praktika e pavarur Nxënësit punojnë duke dalluar në fragment disa nga figurat letrare të përdorura. Figura Lloji Kryetrima Epitet Mynxyrën barbare Në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat M'u derdhët me vrap **Hapi i tretë:** Krahasim Në bazë të fragmenteve të gjetura analizojmë leksikun e përdorur në secilën prej tyre.	
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke i vlerësuar ata.	
Detyrë: Dalloni se në cilat fragmente Skënderbeu na shfaqet një herë si i mbinatyrshëm dhe njëherë si njerëzor.	

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Pjetër Bogdani, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Bogdanit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij. 2. Vlerëson figurën dhe kontributin e Bogdanit. 3. Rendit veprat kryesore të tij.		**Fjalët kyçe**: *Bogdani, erudit, njohës i teologjisë, sibila, letërsi e vjetër etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti, teksti Letërsia e vjetër shqipe.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit, punë me grupe, stuhi mendimesh, diskutim.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Pema e mendimit

Mësuesja në dërrasë shkruan emrin e Pjetër Bogdanit. Nxënësit plotësojnë atë.



Hapi i dytë: Punë me grupe

Ndahet klasa në grupe. Secilit grup i caktohet nga një detyrë.

Grupi 1: Të përcaktojnë rolin e Pjetër Bogdanit si erudit dhe njohës i veprimit.

Grupi 2. Të përcaktojnë rolin e Pjetër Bogdanit si njohës i teologjisë dhe shkrimtar.

Grupi 3. Te tregojnë rolin e tij në raportin që vendosi me Vatikanin për problemet e kohës.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

Mësuesja i drejton pyetje klasës rreth informacionit të marrë.

- Ku qëndron suksesi I shkollimit të Bogdanit?
- Ç'ndikim pati modeli që ai ndoqi dhe si shfaqet në çdo aspekt të veprimtarisë së tij?
- Si vihen në funksion të ndërsjellë veprimtaritë e fetarit dhe atdhetarit?

Hapi i tretë: Diskutim Themi që Bogdani krijoi një kryevepër të letërsisë shqipe, vetëm për shkak të ideve apo dhe prej përdorimit të veçantë të gjuhës? Pse ai me veprën e tij konsiderohet si tejkalues i kohës së vet? Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke vlerësuar disa prej tyre.
Detyrë: Lexoni në linkun: VEPRA E PJETËR BOGDANIT NGA ASPEKTI I TRADITËS KULTURORE KOSOVARE shkruar nga Prof. dr. Engjëll Sedaj.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Analizë e veprës "Çeta e Profetëve"		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		**Fjalët kyçe:** *strukturë biblike,sibila libika,krijimi i botës, poetika etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, gjuha shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: konkurs, pyetje-përgjigje, pyetje me shtjellim.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe diskutim

Lexojmë materialet plotësuese të Lasgush Poradecit dhe Ibrahim Rugovës dhe më pas diskutojmë me nxënësit rreth vlerësimit që I kanë bërë këta emra të rëndësishëm të letërsisë shqipe veprës së Bogdanit.

Hapi i dytë: Harta e veprës

Mësuesja shkruan në dërrasë titullin e veprës dhe më pas e plotësojmë aleatë.



Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje

Pas leximit të materialit mbi veprën "Çeta e Profetëve" mësuesja i drejton pyetje klasës.

- Cila është arsyeja që Bogdani e botoi veprën e tij dhe në italisht? Pse autori priti dhe ngulmoi gjatë deri në publikimin e saj?
- Si është ndërtuar vepra? Cila është struktura e saj?
- Ku ngjajnë dhe ku dallojnë ato? Në cilat fusha autori e kapërcen konceptin biblik?
- Çfarë simbolizojnë sibilat?
- Në ç'mënyrë zbërthehet simbolika e sibilave ?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke I vlerësuar ata.

Detyrë: Lexoni poezitë " Krijimi i rruzullimit" dhe "Sibila Libika"

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi e vjetër shqipe **Tema m**ësimore: Fragment nga "Krijimi i rruzullimit", "Sibila Libika"		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale 4. Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Lexon dhe interpreton poezitë dhëna. 2. Shpjegon kuptimin që përcjell autori në këto poezi. 3. Diskuton mbi llojin e vargjeve dhe të rimës së përdorur nga autori.	**Fjalët kyçe:** *sibila Libika, nierëz dvekëtar, dielli veshun, qiell, yll, hana, sheu si shqype, refe.*
Burimet: teksti I nxënësit, material nga interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, gjuha shqipe.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim, pyetje-përgjigje, ditari dypjesësh, krahasim, diagrami i Venit, tabela e figurave.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim

Lexojmë të dyja poezitë duke punuar edhe me materialin shpjegues dhe pyetjeve rreth saj.

1. Pasi lexojmë poezinë " Krijimi I rruzullimit" nxënësit I vendosin një titull tjetër kësaj poezie.
2. Shpjegojnë kuptimin që përcjell autori në dy vargjet e para dhe të fundit të poezisë.
3. Përcaktoni për këtë sibilë tematikën dhe mesazhin që përcjell.
4. Shpjegoni kuptimin në vargun e parë: "Si njeri po vjen ndër njerëz'dvekëtar".
5. **Hapi i dytë:** Pyetje përgjigje
6. Mësuesja i drejton pyetje klasës:
7. Poezia " Krijimi I rruzullimit" ka karakter filozofik, historik, fetar apo sociologjik?
8. Si jepen kontrastet e mëdha në ndryshimet që pëson kozmosi? A dëshmon ky informacion për dije të mëtejshme të autorit?
9. Megjithëse e shkurtër, kjo poezi ka kontrast, dramë, konflikt, raporte, pushtete etj. Çfarë tregon kjo?
10. Ç'janë sibilat? Ku duket fati i parathënë prej sibilave?
11. Si ndërtohet raporti midis pikëpamjeve fetare dhe atyre jetësore të autorit në këtë poezi?

Hapi i tretë: Ditari dypjesësh

Pasi rilexojmë edhe njëherë pjesët komentojmë fragmente të saj.

Krijimi i rruzullimit	
Vargje	**Komente**
As niegullë me shi, as breshen, as Refe As Deti me Valë epte të madhe gjëmë As lymenatë me Breg, ishin zanë	

Sibila Libika	
Vargje	**Komenti**

Hapi i katërt: Krahasim, diagrami i Venit

Autori përshkruan emocione që burojnë nga marrëdhëniet e ngushta njerëzore. Përshkruani emocionin që krijon përfytyrimi rreth Marisë dhe Krishtit, duke e krahasuar atë me atë të një nëne dhe të birit të saj në jetën e përditshme.



Dashuria e nënës

Hapi i pestë: Tabela e figurave

Pas leximit të dy pjesëve gjejmë dhe analizojmë figurat letrare.

Figura	**Lloji**
As niegullë me shi, as breshen, as Refe	
epte të madhe gjëmë	
As Deti me Valë epte të madhe gjëmë	
Me djell veshur e mbathunë me hënë	

Hapi i gjashtë: Praktikë e pavarur.

- Të dallojnë llojin e vargjeve dhe të rimës.
- Të dallojnë foljet që sjellin idenë e lëvizjes.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke i vlerësuar ata.

Detyrë: Bëni një përshkrim në prozë me tematikën e poezisë së Bogdanit.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Pjetër Budi , jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale* 4. *Kompetenca digjitale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Pjetër Budit. 2. Rendit veprat e plota të këtij poeti. 3. Diskuton mbi karakteristikat e poezisë së tij. 4. Identifikon disa terma të doktrinës së krishterë, që në poezitë e Budit fituan tipare njerëzore.		**Fjalët kyçe:** *poet i parë shqiptar, Gur i Bardhë i Matit, Doktrina e Kërshtenë etj.*	
Burimet: teksti I nxënësit, material nga interneti		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, fjalori mitologjik.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe interpretim, pema e mendjes, stuhi mendimesh.

Organizimi I orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe interpretim

Lexojmë materialin plotësues të Martin Camajt për Pjetër Budin.

Budit i ishin dashur më shumë se 300 vjet që të rigjente vendin e tij në letërsinë shqipe, si njëri nga autorët më të rëndësishëm të saj. Ndërkohë në vendlindjen e vet, rikthimi i Budit do të kërkonte edhe shumë vite të tjera. Kjo ka ndodhur zyrtarisht në 400 vjetorin e lindjes së Budit. Pikërisht këtë rikthim në vendlindje do ta citonte nga lajmet e Tiranës edhe revista Shejzat. Në numrin 9-12 shtator-dhjetor 1966, krahas shkrimit të Camajt do të gjejmë edhe këtë njoftim:

Kremtohet 400 vjetori i Budit

Tiranë, 22 fruer 1966

Në shtator të këtij viti do të festohet 400 vjetori i ditëlindjes së Pjetër Budit, figurë e shquar e letërsisë sonë të vjetër. Me kët rast u krijua nji Komisjon qendror me në krye Rektorin e Universitetit shtetror të Tiranës Kahreman Ylli dhe përbëhet nga përfaqësuesa të Ministris së Kulturës dhe Arteve, Lidhjes së Shkrimtarve dhe Artistve të Shqiprisë, Institutit të Historis dhe Gjuhësis dhe Komitetit ekzekutiv të Këshillit popullor të rrethit të Matit.

Në mbledhjen e tij të parë Komisjoni aprovoi programin e aktiviteteve qi do të zhvillohen në përkujtim të Pjetër Budit. Në Tiranë e Burrel do të bëhen mbledhje solemne, ndërsa Instituti i Historis dhe i Gjuhësis do të organizojë nji sesjon jubilar kushtuar jetës dhe veprimtaris së Pjetër Budit.

Në shejë kujtimi dhe nderimi në fshatin e tij Gur i Bardhë të rrethit të Matit do të ngrihet nji bust. Gjithashtu do të botohen artikuj përkujtimorë dhe do të fillojë puna për botimin e veprave të tij.

Ishte ky edhe shkaku që Martin Camaj do të përcillte për lexuesit e revistës, në të njëtin numër, një shkrim të cilin e shoqëron edhe me një nga krijimet poetike të Budit. Në shkrimin e titulluar thjeshtë: Pjetër Budi, Në rasën e katërqindvjetorit të lindjes Camaj fillimisht jep të dhënat për jetën e shkrimtarit e poetit të Gurit të Bardhë, së bashku me vlerësimet për figurën e tij. Ja se çfarë shkruan mes të tjerash Camaj:

Si njeri qe tejet energjik dhe mendekthielltë. Si meshtar sherbej** *në* **anat e Kosovës e Maqedonisë, ku sigurisht ra në kontakt me nji botë jo shqiptare, sllave, turke dhe ndoshta greke lindore si bashkëvllaznit e tij imzot Ndre Bogdani dhe ma vonë Pjetri i nipi që qindron si yll në historinë e kulturës shqiptare, si shkrimtar stilist i radhës së parë. Budi ngjan të jetë qenë nji tjetër temperament, ma me pak fat dhe pa shum miq se sa shkrimtari i Hasit. Patjetër Budi ishte njeri i squtë, por ndoshta me atë cilsi kompleksi të njeriut që e kishin pengue rrethanat të fitonte nji dijeni organike.

Më tej ndjek një vlerësim për veprën dhe gjuhën e përdorur nga Budi, të cilat Camaj duket se e ka studiuar me themel, pasi nuk mungojnë as analiza e fjalëve dhe komentet për mënyrën e shkrimit të tyre:

Tue analizue hollë veprën e tij, del në shesh se ai u përpoq të gjejë nji rrugë të veten, ndoshta tue mos iau vu fort menden shkrimeve shqipe të përparëshme. Dhe kur përkthen mban at theksën e vet personale, prandej** përdor **nji shqipnim kuptimuer, mun shpesh shkon dhe m'andej tue shkoqitë mendimin e origjinalit lirisht në gjuhën shqipe. Këtu ka dhe nji rrethanë tjetër: në Pasqyrën e të Rrëfyemit (Speculum Confessionis) nga E. de Bonis, Budi nuk e ndien vehten** *të* **lidhun** *për origjinal si do të kishte* **ngja poqese do të kishte përkthye Shkrimin Shëit, ku kriteret në besniki ndaj tekstit ishin tejet të rrebta. Edhe për këto arsye puna e filologut në krahasimin e veprës së Budit me origjinal asht e randë, sa që në fillim ai ka përshtypjen si me pasë hy në nji pyllë** *të* **dendun pa spatë.

Me kohë njeriu mësohet me stilin e Budit dhe tue qenë se fjalët janë të lidhuna njana me tjetrën tue trajtue** kështu togje fjalësh të **përngjituna, ka përshtypjen se asht tue ndigjue nji bisedë që dalë ngadalë bahet e kumbueshme dhe errjedhëshme. <u>Ma tepër se te shkrimtarët tonë të vjetër gjuha e Budit asht verte popullore, ndoshta me shum elemente të matjanes së lashtë.</u>

Dhe është e pritshme që poeti Camaj të ketë vlerësimin e tij për më të hershmin e poetëve shqiptarë Pjetër Budi, prej të cilit shkëput dhe boton edhe 5 strofë me nga katër vargje:

<u>Budi 'a'sht dhe poet, sigurisht jo me shum talent, por asgjamangut farkues i mirë i vargut tetërroksh.</u> Prej 229 faqesh të Pasqyrës kemi 54 faqe vjerrsha** që ai **quen "imne" d.m.th. hymne, si p.sh. mbi Ditën e Gjyqit, mbi Mkatin e parë, ku ngjarja mes Adamit, Evës dhe Gjarpnit "asht e dramatizueme.

Mbetet pa analizue metrika nëse kjo pasqyron nji traditë të vargnimit populluer apo të ndoj tradite kishtare. Auktori përpara se t'a mbyllë veprën e vet me nji mbasthanje** të **zakonëshme, e nis këtë nga Roma për në Arbën me këtë vjerrshë, që po e paraqesim këtu poshtë.

I madhi Zot kjosh levduom,
Per gjithë kaqe të mirë,(1)
Qi s'e kam u merituom
Me ndoonje sherbëtyrë.(2)
Qi më dhee kaq hijr,
Ketë kafshë(3) me mbaruom,
Si e paçë zanë fijll,
Gjithëherë tue shkruom.
Posi mendia më percijll,
Nd'Arbenë me ua derguom
Per kishë e per munështijr(4)

Pak ndë mend me i trazuom.
Ata merre me deshijr(5)
Mkatit me u peenduom,
Posi pemëtë ndë Prijll
Ndë shpijrt me lulëzuom.
E si zogzit ndë pyyllt
Zoti im me të levduom,
Ndierë(6) vete nata mbyyllt,
Me nje zaa t'ambletuom.

Hapi i dytë: Pema e mendjes

Mësuesja shkruan në dërrasë emrin e Pjetër Budit dhe më pas së bashku me nxënësit e plotësojmë atë duke iu referuar materialit në libër por dhe asaj që ata kanë mësuar deri tani.



Hapi i tretë: Stuhi mendimesh Mësuesja i drejton pyetje klasës. • Në ç'mënyrë u përfshi Pjetër Budi në problemet e kohës? Si vlerësohet patriotizmi I tij? Po angazhimi fetar? • Cili qe synimi i Budit në përkthimin e veprave fetare në gjuhën shqipe? • Çfarë natyre kanë veprat e para të Budit? Pse themi që krijimtaria e Budit në fillimet e veta krijon premisë për një autonomi të letërsisë nga feja? Ç'përfaqëson secila nga veprat e tij? • Cilat janë disa terma të doktrinës së krishterë që në poezinë e Budit fituan tipare njerëzore?
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke i vlerësuar disa prej tyre.
Detyrë: Lexoni poezinë "Të mbraztit e jetës" nga Pjetër Budi.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi e vjetër shqipe **Tema mësimore:** Fragment nga "Doktrina e Kërshtenë"		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale* 4. *Kompetenca digjitale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Identifikon disa motive jetësore të kësaj poezie. 2. Analizon tonet madhështore të vargjeve. 3. Zbulon origjinalitetin e Budit përmes frazeologjisë, leksikut dhe shprehësisë.		**Fjalët kyçe:** *i pafati nier, pleq bujarë, djelm* të ri, *letërorë.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, gjuhën shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti, punë në grupe, praktikë e pavarur.			
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë:** Lexim dhe shpjegim teksti Lexojnë poezinë duke punuar edhe me pyetjet e rubrikës së parë te studimi i tekstit. 1. Prej titullit të poezisë çfarë pritet të shtjellojë më tej autori? 2. Si realizohet përmes strofës së parë kalimi në atmosferën e përgjithshme të krijimit? (O I pafat…..Ku janë ata pleq bujarë. Nga numri njëjës në shumës) Kujt i drejtohet poeti fillimisht? (I pafati nieri) Si e sheh ai njeriun e ditëve të tij? (të pafat)			

3. Çfarë e shqetëson më tepër poetin? 4. Pse poeti i drejtohet kohës së shkuar? **Hapi i dytë:** Punë në grupe Klasa ndahet në grupe dhe më pas secilit grup i jepet nga një detyrë. Grupi 1. Identifikojnë disa motive jetësore të kësaj poezie. Grupi 2. Shpjegojnë pse Budi konsiderohet nismëtar i vargëzimit shqip. Grupi 3. Identifikojnë vargjet që tregojnë mbështetjen e Budit në krijimtarinë popullore. Grupi 4. Gjejnë figurat letrare të përdorura në këtë poezi. **Hapi i tretë:** Praktikë e pavarur Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me disa nga pyetjet e studimit të tekstit. 1. Gjejnë shprehje frazeologjike. 2. Gjejnë mbiemrat e përdorur: i pafat, bujarë, sqimatarë, të ri, të bukur, të lulzuem etj. 3. Gjejnë apostrofin (O i pafat), antitezën (vobeg - begatë).
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke i vlerësuar ata.
Detyrë: Përshkruani ose portretizoni një personazh nga ditët e sotme që ka madhështinë e personazheve të Budit në këtë poezi.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Letërsi shqipe **Tema mësimore:** Bisedë letrare për letërsinë e vjetër shqipe		**Situata e të nxënit:** Bisedë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton kushtet historike dhe kulturore në të cilat u shkrua letërsia e vjetër shqipe. 2. Rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së vjetër shqipe. 3. Analizon vepra të kësaj letërsie.		**Fjalët kyçe:** *formula e pagëzimit, dokumentet e shqipes.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjuha shqipe,fotografia, piktura,teatri.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit, lexim dhe interpretim, diskutim.			
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë:** Pema e mendimit **Letërsia e vjetër** shqiptare daton nga Barleti e deri te De Rada. Pikërisht në këto kushte, shkrimtarët e kësaj periudhe duke u nisur edhe nga qëllimet patriotike shkruan edhe vepra			

mësimore e didaktike. Ndonëse e kufizuar në tematikë dhe në numër të paktë veprash përsëri ajo ka rëndësi se është shprehje e vitalitetit të popullit shqiptar, e qëndresës së tij kundër pushtuesit e kulturës së huaj. Nëpërmjet veprave të kësaj letërsie u ruajt e gjallë dashuria për gjuhën shqipe dhe tradita për shkrimin e saj. Në rrjedhën e saj historike letërsia e vjetër shqiptare nuk ka një njësi e vazhdimësi të caktuar,për shkak të kohës dhe rrethanave kulturore ku është shkruar.

Ajo është letërsi e qëllimshme sepse:

1. Ngre lart heroizmin kombëtar.
2. Bën më të kapshëm moralin dhe ligjet e krishterimit.

Veçori e rëndësishme e kësaj letërsie është shfaqja në të e autorit si hartues e prodhues. Letërsia e vjetër shqiptare si letërsi me qëllime të caktuara krijon format dhe modelet e veta, që për nga ndërtimi dhe mënyra e të shprehurit mbështeten në modelet retorike, ato të bindjes dhe të argumentit.





Hapi i dytë: Lexim dhe interpretim
Lexojmë pjesë të ndryshme nga letërsia e vjetër shqipe.
Lexojmë parathënien e " Rrethimi i Shkodrës" nga Marin Barleti.
Pasthënia e "Mesharit" të Gjon Buzukut (1555) :
U Donih Gjoni,biri hi Bdek(1) Buzukut, tue u kujtuom(2) shumë herë se gluha jonëh nukë kish gjaa të endigluom(3) ensëh shkruomit shenjtë(4), ensëh dashunit(5) sëh botësë sanëh(6), desha me u fëdigunëh(7) për saa mujtah meh ditunëh, meh zdritunë pak mendetë e atyneh qi t'eh endiglonjinëh, për seh ata tëh mundëh mernëh(8) saa hi naltë e hi mujtunë(9) e hi përmishëriershim(10) anshtë Zotynë atyneh qi tah duonë em gjithëh zemërë. U lus enbas sodi maa shpesh të vinih em kishëh, përseh ju kini meh gjegjunë(11) ordhëninë e Tinëzot. E atëh nëh enbaroshi (12), Zotynëh tëh ketëh mishërier enbii juu, e atah qi u munduonëh dierie tash maa mos u mondonjënëh.E ju t'ini tëh zgjiedhunitë e Tinëh Zot, e përherë Zotynë kaa meh klenëh me juu: ju tueh endiekunë tëh dërejtënë e tueh lanë tëh shtrenbënë; e këta(13) ju tueh baam,Zotynë ka me shtuom endër juu,se tëh korëtë tajh(14) tëh englatetëh(15) dierie ensëh vjelash, e të vjelëtë dierie ensë enbiellash.E u' maa due tëh enbaronj vepërënë teme, Tinë Zot tueh përqyem. Endëh vjetët MDLIV njëhzet dit endëh mars zuna enfiill e enbarova endëh vjetët MDLV, endëh kallënduor V dit. E seh për fat nëh keshë kun enbëh endonjë vend fëjyem(16), u duoh tuk të jetëh fajtëh, aih qi tëh jetë maa hi ditëshim seh u', atah fajh e lus tah trajtonjëh(17) endë e mirë. Përseh nukë çuditëm seh në paça fëjyem, këjo tueh klenëh maa e para vepërë e fort e fështirëh për tëh vepëruom enbëh gluhët tanëh. Përseh mund mund e qëllonjinë(18), se fajh të mos banjinë; përseh përherë ëndajh tah nukë mundëh jeshëh u' tueh enbajtunëh njëh klishëh enbëh të dyy anët mëh duhë meh shërbyem. E tash u jam enfalëh gjithëveh, e lutëni Tinëh Zonëh endeh për muoh.

Në këtë fragment autori tregon për jetën dhe përgatitjen për të shkruar një libër. Gjon Buzuku ishte prift i malësisë së Mbi Shkodrës. Veprën e shkroi nga 20 marsi 1554 deri më 5 Maj 1555 duke treguar edhe vështirësi në shtypjen e tij. Rëndësia e këtij libri për gjuhën,letërsinë dhe kulturën shqiptare është e jashtëzakonshme, sepse aty gjendet shqipja e asaj kohe, me pasuri të madhe fjalori, me një gegërishte veriore.

Sqarime:

(1) Bdek, Benedekt.
(2) Tue u kujtuom, tue kujtue, tue sjellë në mend.
(3) Të endigloum, që kupton.
(4) Ensëh shkruomit shenjtë, prej shkrimit të shenjtë, prej librave fetarë.
(5) Ensë dashunit, prej dashurisë.
(6) Botësë sanëh, gjindjes, popullit tonë.
(7) Me u fëdigunëh, me u mundue, lodhë.
(8) Tëh mundëh mernëh, të mund të marrin me mend,të marrin vesh.
(9) Hi mujtunë, i fuqishëm.
(10) Hi përmishëriershim, fort i mëshirueshëm.

(11) Meh gjegjunë, me gëgjue.
(12) E atëh nëh enbaroshi, e taë punë në e bëfshi,e në veprofshi kështu.
(13) Këta, këtë, këtë gjë.
(14) Tajh, tuaj.
(15) Tëh englatetëh, të zgjatet.
(16) Fëjyem, gabuar.
(17) Tah trajtonjëh, ta ndreqë.Tueh kleneh etj.:kuptohet që kjo është e para vepër që përkthen Buzuku;
mund të nënkuptohet edhe se ai nuk njeh tjetër vepër të përkthyer para tij.
(18) Nukë mund e qëllonjinë etj., nuk mund t'ia qëllonin aq mirë punës sa të mos bënin gabim.

Parathënia e fjalorit latinisht-shqip (FRANG BARDHI)
Tue pasunë ditë e përditë, të dashunitë e mij, mbassi hina ndë Kolexhë, kujtuem(1) me qish(2) copë librë keshë me ndihmuem mbënjaanë gjuhënë tanë, qi po bdaretë e po bastardhohetë saa maa parë të ve(3); e maa fort me ndimuem gjithë atyne qi janë nd'urdhënitë Tinëzot e të shintesë kishë katolike, e s'dijnë gjuhënë latine, paa të sijët askush s'munë shërbenjë si duhetë paa të madh error(4) e faj hesaapetë(5), zakonetë ë çeremoniatë e shintesë kishësë Romësë; më ndy(6) jo pak mirë me marrë e me nkëthyesë n'gjuhët cë lëtine mbë gjuhët t'arbëneshë një dicionar, qi tjetër s'ashtë veçëse nja librë, qi kaa ndë vetëhe saa fjalë e saa emëna janë e gjindenë ndë këte pjesë shekulli(7) posikuur me thanë të nierëzet e të shtazëvet e ujënavet e të malevet e të fushavet e të saa tjera kafshëve(8), qi gjindenë ndënë qiellt, ende mbë qiellt, posikuur të Tinëzot, të engjiet e të shintënet... I silli librë më pëlqei e m'u duk se kishte me u qenë për ndoonja ndimë, ndoonëse të pakë e të moritunë(9).
Prashtu, mbassi u daashë Kolexhiet cë Zonjësë ndë Lurijt e ershë mb'Romë pr'urdhënit të Kuvendit Shint(10) e të ndriçmit nderueshimit zot upeshkëpit Sadrimësë, tim ungjë, pr'emënë Gjeçi i Bardhë(11), fisit sinë e ndoret sonë, shumë i urtë e i vëjyeshim, i cilli, prej së dashunit të Tinëzot e së shintit Atë Papë Urbanit VIII, ashtë tash krijuem e baam argjupeshkëpi i Tivarit; e hina në Kolexhë te janë shkollarëtë, oo ata qi xanë, me vonë mbasandaj ndër të paafeet me çtuem shintenë e të vërtetënë feenë tanë,zunafijll tue këthyem këtë dicionaar mbë gjuhët tanë, e këtheva nsi(12) gjithë qish mujta; e mbassi e solla(13), m'u duk i pakë e i vogëlë, prashtu hina tue kujtuem(14) e shkrova mbe gjuhët tanë maa parë do të falunazë(15), qi kanë zakon e banjënë t'Arbëneshëtë kuur, së largu oo s'të këtje(16), mb'udhë mpiqenë, tue vumë përngjat(17) tyne ende mbë gjuhët të Latinjet; ashtu ende do proverbia oo të thana, ncë sijashit disa kanë zakon e i thonë Latinjtë e disa Taliantë; do adverbia ende, e gjithë saa kafshë janë në këtë copëzë librë, i vuna fjalë për fjalë, e maa parë mbë disa vuna latinisht, ani(18) përngjat oo përfundit vuna arbënisht, e mbë të tjera vuuna maa parë fjalënë e rieshtnë arbënisht, ani përfundit latinisht, ashtu qi ata qi të fëdigenë(19) e të duenë më xanë gjuhënë latine maa mirë e maa udob(20) t'u vinjë ...
...Prej Rome, dit ndë maj 30, ndë vietëtë Krishti 1635. Shërbëtori i zotënijsë saaj, unë D.Frangu i Bardhë, shkollaar ndë Kolexhë të Shintesë Fee.

"Parathënia" është nxjerrë nga origjinali, që ruhet në Bibliotekën Kombëtare. Në këtë parathënie gjejmë disa te dhëna kryesore mbi jetën e Bardhit.
(1) Kujtuem - sjellur ndër mend,menduar.
(2) Qish - çfarë.
(3) Saa maa parë të ve - sa më shumë shkon koha.
(4) Error, it. - gabim,
(5) Hesaapetë, tq. - konceptet.
(6) Mëndy - m'u duk.
(7) Në këte pjesë shekulli - në këtë pjesë të botës, në këtë vend.
(8) Kafshëve, sendeve.
(9) Të moritunë - të pakë,të dobët. Lurij,(Loreto), qytet në Itali, ku ishte një kolegj, me emër "Kolegji Ilirian", që
përgatiste priftërinj e misionarë edhe për Shqipërinë. Punën për fjalorin B. e filloi duke qenë akoma nxënës.
(10) Kuvendit Shint - Kuvendi i Propagandës së Shenjtë, një si organizatë e Vatikanit për propagandën fetare në vendet e
ndryshme. Mbasi kreu studimet në Loreto, B. i vazhdoi ato në një seminar të Propagandës së Shenjtë ("Propaganda Fide").
(11) Gjeçi i Bardhë, vdiq më 1647. Familja e Bardhajve duket se ishte një familje priftërinjësh, që lojtën rol me rëndësi në
kishën katolike të vendit tonë, veçanërisht që nga pjesa e dytë e shekullit XVI e gjer në pjesën e parë të shekullit XVII.
Daja i Gjeçit, Nikolla, dhe Gjeçi vetë, patën marrë pjesë në lëvizjet kryengritëse të vendit kundër Turqisë.
(12) Nsi - prej tij.
(13) E solla - e përktheva.
(14) Hina tue kujtuem - u vura të mendoj.
(15) Të falunazë - përshëndetje.
(16) S'të këtje - së afërmi.
(17) Përgjat - pranë, përkrah.
(18) Ani - pastaj.
(19) Fëdigenë - lodhen,përpiqen.
(20) Udob - lehtë

Fjalori i Frang Bardhit ka rëndësi të veçantë sidomos për fjalët e urta dhe sentencat shqipe,shumica e të cilave janë shqip,disa të përshtatura nga latinishtja dhe një numër të marra si formulime nga Shkrimi i shenjtë. Fjalët e urta tregojnë se Bardhi është mbledhës i parë i kulturës popullore shqiptare. Ato shprehin një sistem të menduari, kulturë karakteristike veriore të formuar.

HASAN ZYKO KAMBERI

PARAJA

Mbreti, ç'urdhëron dynjanë,
Që ka vënë taraphanë
E i presënë paranë,
Ja di kimenë parasë.
Dhe veziri, q'është veqil,
Zë sikur të bënet' adil
E mos thotë dot kaly-kil,
Ja di kimenë parasë.

Sheh Islami, q'ep fetfanë,
Që di qitapëtë ç'thanë,

Nukë kaçirdisë paranë,
Ja di kimenë parasë.
Myfti edhe myderizë
Edhe kyrra e vaizë
Kanë ujdisur' iblizë,
Ja di kimenë parasë.
Dhe kadiu i mehqemesë,
Që rri sipër sixhadesë,
Edhe shehu i teqesë,
Ja di kimenë parasë...
Dhe pashallarë, bejlerë,
Edhe avamë të tjerë,
Për para apënë krerë,
Ja di kimenë parasë...
Kadiut, t'i rrëfesh paranë,
Ters e vërtit sherianë,
Për para se ç'e shet t'anë,
Ja di kimenë parasë..."

Hasan Zyko Kamberi është satiriku i parë I letërsisë shqiptare. Te "paraja"jo vetëm si domosdoshmëri për ekzistencën,por edhe si provë morale,del se para pasurisë dhe ambicies thyhen të gjitha shtresat shoqërore. Para parasë bien të gjitha vlerat morale e njerëzore: kultet fetare, pushtetore e shpirtërore. Në këtë mënyrë duke krijuar një tekst të ndërlikuar me funksion të dyfishtë: paraja është gjithçka, i mund të gjitha, por dhe i humbet të gjitha. Këtu ai zhvesh lakuriq botën e shthurur njerëzore, që nga djepi deri në varr. Kritikon fort e njëkohësisht e vajton atë dhe provon se qeshja, përqeshja e vaji janë të lidhura fort me botën e krijuesit.

Kënga e përshpirtshme L. Matrënga

Gjithëve thëres, kush do ndëlesë,
të mirë të krështë, burra gra,
mbë fjalët e Tinëzot të shihi meshë,
se s'ishtë njerii nesh çë mkatë s'kaa;
e lum kush e kujton se ka te vdesë,
e mentë bashkë mbë Tënëzonë i kaa,
se Krishti ndë parrajsit i bën pjesë,
e bën për bljr të tij e për vëlla.

Është vjersha e parë e dëshmuar deri më sot në gjuhën shqipe. Kjo këngë ka tekstin më të fuqishëm e më me vlerë të të gjithë veprës. Ajo përmbledh doktrinën e Matrëngës dhe qëllimin e tij për ta dhënë me një trajtë të kultivuar letrare-poetike. Forma e saj e përsosur, vargu i rregullt 11-rrokësh, rima dhe figurat e saj dëshmojnë për mjeshtërinë poetike të autorit në shqip dhe për një kulturë të moçme poetike shqiptare.

Hapi i tretë: Diskutim
Pas leximit të tyre dhe të pjesëve të tjera që vetë nxënësit kanë sjellë, diskutojmë mbi to. Rolin që luajnë, rëndësinë që patën në zhvillimin e letërsisë së vjetër shqipe, mesazhet që përcjellin, gjuhën e përdorur etj.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit dhe bëjmë disa vlerësime.

Detyrë: Lihet në dëshirë të mësueses për të dhënë ose jo detyrë.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Punë me projekte **Tema mësimore:** Dramatizim i veprës "Romeo dhe Zhuljeta", U. Shekspir		**Situata e të nxënit:** Roli im në dramë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit • Kompetenca e të menduarit • Kompetenca e të mësuarit për të nxënë • Kompetenca personale • Kompetenca qytetare • Kompetenca digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Merr njohuri për teatrin,dramën dhe dramaturgët më të mëdhenj. 2. Njihet me subjektin e tragjedisë. 3. Përzgjedh materialin që do të dramatizohet. 4. Përzgjedh nxënësit që do të marrin pjesë. 5. Drejton punën në grup. 6. Merret me ndarjen dhe specifikat e pjesëve për interpretimin e rolit. 7. Mbledh grupin e punës. 8. Prezanton punën individuale. 9. Bën provën e përgjithshme para shfaqjes. 10. Bën reklama para shfaqjes. 11. Prezanton punën e tyre. 12. Përballet me reagimin e spektatorëve.	**Fjalët kyçe**: *rol, punë në grup, aktor, mizanskenë, projekt,teatër etj.*
Burimet: teksti mësimor, materiale nga interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjuha shqipe, fotografia, piktura, teatri.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë individuale, punë në grup, interpretimi, mbajtja e shënimeve, lexim njëri pas tjetrit, diskutim, vlerësim, nxjerrja e informacionit nga teksti.	

Organizimi i orës së mësimit

Temat e njohurive kryesore që rrimeren në këtë projekt:

- Teatri dhe zhvillimi i tij
- Ndarja e roleve
- Ndarja e pjesëve
- Punë në grup
- Punë individuale
- Teksti
- Prova gjenerale
- Shfaqja

Partnerët: prindërit, nxënësit, aktorë që do na vijnë në ndihmë, mësues.

Numri i orëve që do të shfrytëzohen për realizimin e projektit : 5 orë

- ✓ Prezantim dhe njohja me temën e projektit
- ✓ Kontroll i ecurisë së projektit
- ✓ Vlerësim i të nxënit përmbledhës (puna me rolin)
- ✓ Vlerësim I të nxënit përmbledhës (prova gjenerale)
- ✓ Prezantimi i projektit dhe vlerësimi i tij

Numri i nxënësve në projekt: Të gjithë nxënësit e klasave X.

Qëllimi i projektit: Vënia në lëvizje e burimeve të ndryshme fizike, emocionale dhe mendore, për të ndihmuar nxënësit në përvetësimin praktik të kurrikulës,si dhe për të

zgjuar tek ata kreativitetin lëndor, për të zhvilluar komunikimin, për të rritur mundësinë e punës individuale dhe në grup përmes një aktiviteti të larmishëm.

Faza e parë

Ora 1: Prezantim dhe njohja me temën e projektit

Në pjesën e parë të kësaj ore rikujtojmë disa nga njohuritë për teatrin, dramën dhe dramaturgët më të mëdhenj

Teatri I ka fillesat në antikitet,në atë që quhet teatri grek I cili e ka origjinën në ritet që I bëheshin Dionisit. Skena antike kishte këngëtarë me lirë ose aktorë që imitonin heronjtë nga mitologjia

- Eskilin solli në skenë aktorin e dytë, si dhe futi elementin e korit.
- Euripidi futi aktorin e tretë, duke e bërë skenën mjaft të gjallë, aq sa të zbulohej dhe psikologjia e personazheve.
- Sofokliu ruajti natyrën e heronjve eskilianë dhe përsosi teknikat e dramës
- Aristofani ndërroi fytyrën e skenës nga tragjike në komike.

Rilindja solli në skenë veset dhe pasionet njerëzore.

- Shekspiri përmes konflikteve të forta,mjeteve artistike,gjuhës dialoguese e monologuese dhe shpejtësisë së veprimit ndërtoi një shkollë të re teatri

Klasicizmi pati një kthim tematik në antikitet, por përmes rregullave, të cilat u kthyen në filozofi krijimi.

- Molieri babai I komedisë së kësaj periudhe në veprat e tij demaskoi vesin përmes ironisë dhe së qeshurës.
-





Ora 2: Krijohen grupet e punës për të ndarë detyrat.
Grupi 1. Rendit pjesëmarrësit në një teatër dhe detyrat e secilit.

- Drejtori i skenës dhe i aktivitetit: monitoron gjithë sallën, skenën, kujdeset për harmonizimin e punës së të gjithëve, merret me promovimin e shfaqjes, posterat, njoftimet, ftesat etj.
- Regjisori : drejton lojën e aktorëve, provat dhe shfaqjen.
- Aktorët: interpretojnë rolet.
- Kostumografët: merren me skenën, ideimin dhe pajisjen e saj.
- Tekniku i zërit, i dritave, i skenës.
- Regjistruesit e shfaqjes: fotografë, kameramanë etj.

Grupi 2. Prezanton hapat e projektit.
Hapat e projektit:
✓ Jepen këshilla për punën me projekt.
✓ Jepen dhe shpjegohen disa njohuri për teatrin.
✓ Prezantohet vepra "Romeo dhe Zhuljeta".
✓ Bëhet i ditur qëllimi i projektit.
Grupi 3. Ndan pjesët për interpretimin e roleve.

- Regjisori ndan pjesët.
- Pjesët ndahen sipas roleve përkatëse.
- Pjesët rishkruhen ose fotokopjohen, mbahen vazhdimisht përpara derisa të mësohen përmendësh, mund të pësojnë ndryshime të vogla gjatë interpretimit, nënvizohen për të veçuar detajet e rëndësishme, studiohen sipas rendit të ngjarjeve, ndahen në njësi më të vogla, mësohen përmendësh etj.

Faza e dytë
Kjo fazë është një proces vazhdimësie dhe nënkupton një punë sistematike individuale të secilit aktor.
Ora 3: Kontrolli i projektit
Gjatë kësaj kohe aktori-nxënës:

- Ka lexuar dhe rilexuar veprën, ka lexuar kritikë mbi veprën, mbi lojën aktoriale, ka dëgjuar në internet për interpretime të ngjashme të rolit.
- Ka ndarë pjesët e tij, ka parë me vëmendje rolin, fjalët dhe frazat dhe ka studiuar personazhet që do të ndërveprojnë ose jo me të në skenë.
- Ka kuptuar qartë mesazhin e veprës duke zbuluar dhe njohur kontekstet historike e kulturore të kohës.
- Ka ndjekur ndonjë provë të kolegëve, duke u konsultuar vazhdimisht me regjisorin e shfaqjes.
- Ka përmirësuar veten gjatë provave, duke punuar pa u lodhur, duke demonstruar vullnet.

Mbledhja e grupit të punës: Në këtë mbledhje duhen të jenë të pranishëm të gjithë, pasi qëllimi nuk është të dëgjosh vetëm veten, por edhe të tjerët.

- Provohen rolet njëri pas tjetrit.
- Bëhen korrigjime të drejtpërdrejta dhe kërkohet përmirësimi i menjëhershëm i tyre.
- Shfaqet roli udhëheqës i regjisorit.
- Diskutohen pakënaqësitë për veten dhe të tjerët.

❖ Bëhen përgjithësime, dallime dhe specifikime.

Në fund arrihet një përfundim i përgjithshëm dhe lihen detyra.

Faza e tretë

Ora 4: Prova e përgjithshme (gjenerale) para shfaqjes

Kjo fazë mund të zgjasë disa ditë, të cilat mund të jenë të mbushura plot punë dhe aktivitet deri në ditën e shfaqjes. Kjo fazë realizohet mbi reflektimet e diskutimit në seancën e kontrollit të ecurisë dhe konkretizon rritjen profesionale të të gjithë pjesëmarrësve në projekt.

Prova e përgjithshme (gjenerale)

Pas reflektimit vjen prova gjenerale dhe përgatitjet për të. Kjo është një shfaqje e vërtetë. Ndryshimi midis saj dhe finales është se salla mund të mos jetë e mbushur plotësisht dhe nxënësi ka mundësi të rregullojë gabimet e veta.

Reklama para shfaqjes

Dramatizimi është një shfaqje e vërtetë. Si e tillë ajo ka nevojë për një reklamë të mirë, me të cilën merret drejtori i shfaqjes.

Reklama mund të bëhet:

- ➢ në gazetën e shkollës;
- ➢ në senatin e shkollës përmes një lajmërimi që ai shpërndan;
- ➢ në TV,radio,gazetë lokale etj.;
- ➢ përmes rrjeteve të ndryshme sociale;
- ➢ me një poster ose fletëpalosje.

Ora 5: Dita e shfaqjes, interpretimi dhe vlerësimi i saj

Në këtë ditë gjithçka është gati. Grupet e punës kanë realizuar punët dhe detyrat e tyre që nga akomodimi I njerëzve, prindërve, mësuesve etj. që kanë ardhur për të parë shfaqjen, skena, kostumet, ndriçimi, kamera etj.

Japim disa këshilla:

- Të mos harrojnë skedën e përgjithshme të tekstit.
- Të përsëritim me vete sa herë të mundni pjesët tuaja.
- Të mbajnë nën kontroll stresin dhe emocionet.
- Të rregullojnë ndonjë detaj të fundit.
- Të kujdesen për veshjen, grimin dhe mimikën.
- Të hyjnë në rol përpara se shfaqja të fillojë.

Në fund kur gjithçka është gati, ngrihet perdja dhe fillon shfaqja.

Vlerësimi: Në fund të orës të shfaqjes bëhet dhe vlerësimi i nxënësve sipas detyrave apo roleve të përcaktuara.

Detyrë: Mblidhni vlerësime që janë bërë shfaqjes së tyre nga mësues, nxënës, prindër etj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Rilindja
Tema mësimore: Rilindja; Dante Aligeri, jeta dhe vepra</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Italia brenda vargjeve; foto, muzikë italiane</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3.Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Diskuton rreth zhvillimit të humanizmit dhe të Rilindjes evropiane si lëvizje e rëndësishme kulturore, letrare dhe artistike.
2. Veçon përfaqësuesit kryesorë të kësaj epoke në Evropë.
3. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Aligerit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij.
4. Veçon veprat kryesore të Aligerit.
5. Diskuton rreth vlerave, strukturës, filozofisë dhe rëndësisë së “Komedisë hyjnore”.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: Rilindje evropiane, Dante Aligeri, Beatriçja etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia, arti, piktura.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: një pyetje shumë përgjigje, përmbledhje e strukturuar, stuhi mendimesh, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Një pyetje shumë përgjigje:
Lexojmë vlerësimin e T.Eliot “Asnjë varg i ndonjë poeti tjetër nuk kërkon një përkthim absolutisht fjalë për fjalë si ai i Dantes, sepse asnjë poet nuk na bind si ai, tërësisht që fjala që përdor ishte ajo që donte dhe që asnjë fjalë tjetër nuk funksionon”.
Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre. Më pas shkruhen në tabelë këto pyetje.
Ç’është rilindja?
Ç’është alegoria në letërsi?
Rilindja është një periudhë e gjatë treshekullore që u shoqërua nga një lëvizje e rëndësishme përparimtare,shkencore, letrare-artistike, filozofike, pedagogjike që synonte çlirimin e personalitetit të njeriut nga vargonjtë e mesjetës feudale, duke vënë në qendër të vëmendjes njeriun.
Alegoria si figurë është e afërt me metaforën, aq sa mund të kundrohet si trajtë e zgjeruar e saj. Ajo bart një kuptim të fshehur e të thellë, ndaj me anë të saj ke rastin të shprehësh një mori idesh dhe gjendjesh. Ka mendime se teknika kryesore e alegorisë buron nga personifikimi.</td></tr>
</table>

Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar

Mësuesja shkruan në tabelë emrin e Dante Aligerit dhe nxënësit e plotësojnë atë.



Hapi i tretë: Stuhi mendimesh

Pas dhënies së informacionit të ri mësuesja i drejton pyetje klasës.

- Dante spikati si njeri fisnik dhe i mençur. Ku dhe si dëshmohet kjo në rrethanat e kohës?
- Pse takimi me Beatriçen është në kufijtë e ideales,simbolikes dhe reales në të njëjtën kohë?Si e përfaqëson ajo dashurinë e poetit?Si ndërthuren në personazhin e saj idetë e autorit për drejtësinë dhe të vërtetën?
- Si ndikuan 20 vitet e mërgimit të Dantes në veprën e tij?
- Ç' koncept të ri për dashurinë solli Dante në letërsinë e kohës? Ku mbështetej ky koncept?
- Çfarë shpreh poeti te "Jeta e re"? Ç'element shtoi ai te libri Gostia?

Hapi i katërt: Diskutim

Lexojmë vlerësimin e Ismail Kadaresë për Dante Aligerin.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke bërë edhe vlerësimin e tyre.

Detyrë: Lexoni dhe komentoni vargje nga Dante, duke interpretuar mesazhet që përcillen.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Analizë" Komedia Hyjnore", Dante Aligeri; punë me tekstin		**Situata e të nxënit:** Ferri dhe parajsa. Diskutojmë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton arsyet se pse kjo vepër u quajt "Komedia hyjnore". 2. Shpjegon kompozicionin e veprës me bazë numrin 3. 3. Përshkruan udhëtimin e Dantes.		**Fjalët kyçe:** *I egri pyll, valë, kodër, diell.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, harta e veprës, punë në grupe.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Diskutim

Lexojmë thëniet:

Hegel: "Komedia hyjnore është vepra më e plotë dhe më e pasur, eposi artistik i vërtetë i mesjetës katolike, argumenti dhe poema më madhështore"

R. Luperini: " Vepra danteske është aktuale,sepse Dante babai i gjuhës dhe i letërsisë italiane, është për letërsinë dhe qytetërimin Italian, ashtu siç është Bahu për muzikën perëndimore, vepra e tij më shumë se shprehje artistike, shërben si model jetësor dhe vijë ndarëse e gjykimit moral, politik etj."

Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre.

Hapi i dytë: Harta e veprës



Hapi i tretë: Punë në grup Mësuesja ndan klasën në grupe ku secilit grup i jep nga një detyrë. Grupi 1. Të tregojnë se si konceptohet udhëtimi dantesk dhe sa zgjasin përshkrimet. Grupi 2. Të shpjegojnë kompozicionin e veprës me bazë numrin tre. Grupi 3. Të përshkruajnë Ferrin dhe mënyrën e vendosjes së personazheve në të. Grupi 4. Të shpjegojnë mekanizmin e pastrimit të shpirtrave në Purgator. U lëmë nxënësve kohën e mjaftueshme (7 min) dhe më pas diskutojmë për detyrën.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen:
Detyrë: Përshkruani mendimin e Dantes kur ai kalon mes për mes Parajsës.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja Tema mësimore: Fragment, Këngë 1 "Komedia hyjnore" Dante Aligeri.		**Situata e të nxënit:** Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet e dilemës së Dantes për të hyrë në pyll. 2. Përcakton simbolikën e pyllit, të kodrës, të diellit, të valëve. 3. Identifikon mbiemrat dhe thotë cili është roli i tyre.		**Fjalët kyçe:** I egri pyll, diell, valë, kodër, luginë.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga internet, libri "Komedia Hyjnore".		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti , ditari dypjesësh, praktikë e drejtuar, tabela e figurave, praktikë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti
Një nxënës lexon këngën e parë dhe më pas punojmë me pyetjet e studimit të tekstit.

- Në cilën fazë të jetës është autori dhe si ndihet ai? (Ai është në mes të udhëtimit të tij të jetës dhe na shfaqet plot dilema.)
- Çfarë informacioni i jep Dantes udhërrëfyesi që e bind të pranojë udhëtimin? (E paralajmëron për ardhjen e një langoi dhe e fton që ta ndjekë nëpër Ferr e Purgator për t'i shpëtuar rrezikut.)
- Si e shpjegoni dilemën e Dantes në hyrje të pyllit?
- Autori paralajmëron se do të rrëfejë. Ç'efekt ka ky paralajmërim për lexuesin?
- E ndieni frikën e Dantes? Me se është e lidhur ndjenja e tij?
- Pse autori thotë se vdekja është më e hidhur se mëkati? Çfarë nënkupton ai?

Hapi i dytë: Ditari dypjesësh
Të shpjegojnë vargun.
Vargu
Komenti
Atje ku përfundon lugina, që me aq tmerr në zemër më kish trazue
Dërmue si u çlodha pak mbi ato gurisht
Ia nisa rrugës nëpër breg t'shkretuem
çdo herë kamba e ndalun ma poshtë ishte
Hapi i tretë: Praktikë e drejtuar
Mësuesja shkruan në dërrasë këto fjalë: pyll, kodër, diell, valë, panterë, luan, ujkonjë. I fton nxënësit të zbërthejnë simbolikën e tyre, duke e ilustruar dhe me shembuj nga teksti.



Hapi i katërt: Tabela e figurave

Hapi i katërt: Tabela e figurave

Figura	**Shembull**
Anafora	
Similitudë	

Hapi i pestë: Praktikë e pavarur Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me rubrikën Fjala dhe përdorimi i saj. Mbiemrat e përdorur: I egri, i ashpër, i fortë. Rima AAB Aliteracioni (ai i egri pyll, i ashpër pyll hata etj.) Fjalë dialektore: ta mejtoj – ta mendoj, ç'të mirë kam gjetë - çfarë të mire kam gjetur etj.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku.
Detyrë: Ndajeni përmbajtjen e kësaj kënge në disa kryesore, duke bërë një lloj kronologjie të zhvillimit të ngjarjeve.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore**: Fragment Paolo e Françeska, Dante Aligeri		**Situata e të nxënit:** "Njeriu pa dashuri si kufomë që shkon me leje" Remark	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* 2. *Kompetenca e të mësuarit për të nxënë* 3. *Kompetenca personale*			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan ngjarjen që ndodh në këtë fragment. 2. Përshkruan momentin e veçantë të lindjes së dashurisë midis Françeskës dhe Paolës. 3. Zbulon elemente të rrëfimit në këtë fragment dhe analizon rolin e tyre 4. Kthen në prozë vargjet e këtij fragmenti.		**Fjalët kyçe:** *Françeska, Paolo, dashnija, Kaina, fatzinë.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pyetje- përgjigje, ditari dypjesësh, shkak-pasojë, punë me shkrim, praktikë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Pyetje-përgjigje

Mësuesja vendos dy nxënës për të lexuar tekstin e më pas i drejtojmë pyetje klasës për ta zbërthyer më mirë atë.

- Kujt I kushtohet kjo këngë?
- Kush është në të vërtetë mësuesi? Ç'përshtypje na lë shfaqja e këtij personazhi të njohur?
- Si e shpreh poeti këndvështrimin e tij për dashurinë? Ç'përmasa i jepet dashurisë në këtë perceptim?
- Si e përjeton poeti çastin e takimit me Françeskën?
- Ç'qëndrim mban autori ndaj letërsisë kalorësiake?

Hapi i dytë: Ditari dypjesësh

Nxënësit gjejnë momentin kulmor të këtij fragmenti më pas e komentojnë atë.

Vargjet	**Komenti**
Kur unë dëgjova ata shpirtën t'shkretë, Kokën e ula e ndeja gjatë n'mendim Dersa poeti tha:" Pse ashtu ke mbetë?"	

- Vini re se si mungesa e dashurisë e çon poetin në shfrim dëshpërues. Shpjegoni dëshpërimin e tij.

Vargjet	**Komenti**
S'paska idhnim më të madh,m'u gjegj tue fsha, se me mendue për kohët e haresë n'mjerim e vajë"	

Hapi i tretë: Shkak -pasojë

Nxënësit janë të lirë të analizojnë shkakun dhe pasojën e ardhjes së dashurisë.

Shkak		Pasojë
	Poeti e quan të pashmangshme dashurinë dhe gjithçka që vjen nga ajo.	

Hapi i katërt: Punë me shkrim

Nxënësit të përshkruajnë momentin e veçantë të lindjes së dashurisë midis Françeskës dhe Paolos.

Hapi i pestë: Praktikë e pavarur

- Cili është funksioni i fjalës së përsëritur "dashnija"?
- Shpjegoni shprehjen : për kohët e haresë – për kohët e lumtura.
- Zëvendësoni me fjalë të përafërta shprehjen "na u ndezën sytë shkëndija" (ndjeheshim të dashuruar, të lumtur).

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku.
Detyrë: Një nga teknikat e shkrimit është dhe kthimi i vargjeve në prozë. Kthejini këto vargje duke pasur parasysh atmosferën në rrethin e dytë te Ferrit, ku qëndrojnë mëkatarët e pasionit të dashurisë.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja Tema mësimore: Humanizmi dhe Rilindja Europiane		**Situata e të nxënit:** Njeriu qenia e universit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton termin "Rilindje". 2. Diskuton për temat e mëdha të humanizmit dhe idealin e rilindësve. 3. Analizon termat "humanizëm" dhe "rilindje"duke shpjeguar marrëdhënien e varësisë midis tyre. 4. Flet për kontributin e Petrarkës dhe të Bokaçios. 5. Gjen mendime të ndryshme mbi zhvillimet e artit dhe të letërsisë në kohën e Rilindjes.		**Fjalët kyçe:** *Rilindje, humanizëm, Petrarka, Bokaçio, Tomas Mani.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, pema e mendimit, Diagrami I Venit, pyetje- përgjigje.			

Organizimi I orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë termin Rilindje. Nxënësit më pas e plotësojnë atë.



Hapi i dytë: Pema e mendimit



Hapi i tretë: Diagrami i Venit

Pas leximit të informacionit në libër mbi humanizmin dhe rilindjen,japim të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre.



Hapi i katërt: Pyetje-përgjigje Pas leximit të informacionit të lexuar nga nxënësit në libër, mësuesja i drejton pyetje klasës. • Si mundi të rilindej kultura dhe arti në shërbim të njeriut në këtë epokë plot jetë? • Ç'vlera mori njeriu në këtë periudhë? • Në ç'mënyrë ndikoi kultura greke në veprat dhe idealet e Rilindjes? • Cilat janë temat e mëdha të humanizmit? • Çfarë marrëdhënie varësie krijohet midis termave " humanizëm" dhe "rilindje"? • Cili është kontributi i Petrarkës dhe i Bokaçios?
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke u bërë atyre vlerësimin.
Detyrë: Gjeni mendime të ndryshme mbi zhvillimet e artit dhe të letërsisë në kohën e Rilindjes.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Gjuhë Shqipe	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Rubrika: Punë me shkrim **Tema mësimore:** Përmbledhja (ora e parë)		**Situata e të nxënit:** Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Lexon modele përmbledhjesh 2. Rendit karakteristikat e përmbledhjes 3. Tregon teknikat që përdoren për të shkruar një përmbledhje. 4. Bën përmbledhjen e paragrafëve		**Fjalët kyçe:** *paragraf, sintezë, rrëfyes, paraqitës, brendi, subjekt.*	
Burimet: teksti i nxënësit, material të ndryshme (paragrafë, tekste të shkurtra) etj.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjuhën shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: përvijim i mendimit, përmbledhje e strukturuar, lexim, punë me grupe, praktikë e pavarur.			

Organizimi I orës së mësimit

Hapi i parë: Përvijim i mendimit
Mësuesja tregon në mënyrë të përmbledhur se përse shkruhet një përmbledhje.

Është një nga shprehitë e të menduarit dhe është e nevojshme sa herë që na duhet të mbajmë mend diçka, sa herë që duhet të përcjellim një mesazh apo sa herë që nuk duam ta lexojmë të gjithë tekstin.

Përmbledhja

Për ta ilustruar mësuesja merr një fragment nga *(të plotësohet) ku jepet përmbledhja e pjesës.

Poezia "Fluturimi" nga Lasgush Poradeci
Tashi kujtò m'i që të gjitha... stolitë e jetës një
-nga-një... Atë vështimin më të parë, q'u mbyll në shpirt e s'doli më..
. Magjinë e pamjeve të tua qepallë-derdhurat përdhé...
Dy sytë e tu të dhemshuruar ndaj mbanje turp si nuse e re...
Vështrim e pamje e sy të dhemshur një dëshërim plot shkrepëtim,
Një mall e zjarr që ndrin në zemër prej yllit tënd, prej yllit tim,
Që zjen e shfren me gumëzhimë, posi valomë e posi det,
Valomë e det i uluruar nga fund '
i zemërës së shkret.
Dhe ja pushtohemi nër kraha lot ëmbëlsi! plot fshehtësi!
Si rrjedh kaq hir, e motr '
e jetës, ku dashuron kaq dashuri!
Si djeg kaq flakë e flakërohem, e përvëlohem orë-e-ças,
Un' ëndërronjësi i përgjumur, ti vigjëllonjësja me gas!
Dh' ashtu çlirohemi prej krahash, sikur me turp, sikur me faj,
Sikur me shpirt të shërëmtuar kundrojmë veten pasandaj,
Kundrojmë e pshojmë e perëndojmë, dorë për dorë-e-sy nër sy,
Veç mall e zjarr e flakë e dritë, e dehje e prehje që të dy....
Dhe kur të ndaheshim përhera-o! Shpirt me shpirt, o!
Lot me lot!O! shpirt me shpirt që dot nuk ndahesh, o!
lot me lot që s'ndahesh dot!
O! shpirti im nga shpirt '
i dhemshur, nga lot '
i dhemshur loti im: A kur të ndaheshim përhera,
kap shpirti shpirtin me rrëmbim!

Poezia e mrekullueshme "Fluturimi" ka një prerje sa filozofike aq edhe poetike, artistike. Që në titull, duket sikur vetë teksti na ngre peshë e na çon lart, në qiell dhe prej lartësive shohim se si burojnë ndjenjat nga shpirti i dashuruar.

Tashi kujtò-
m'i që të gjitha... stolitë e jetës një
-nga-një... Atë vështrimin
më të parë, q'u mbyll në shpirt e s'doli më..
. Magjinë e pamjeve të tua qepallë-derdhurat përdhé... Dy sytë e tu të dhemshuruar ndaj mbanje turp si nuse e re...

Në vargjet e para paraqitet me nostalgji fillimi i dashurisë, njohja e parë dhe dashuria me shikim të parë, një dashuri e përjetshme që "u mbyll në shpirt e s'doli më". Vargu i rimuar 16-rrokësh premton një poezi ritmike. Përdorimi i apokopave, rënies së fonemave në fund të fjalës, në strofën e

parë "q'u mbyll në shpirt" dhe në të dytën "nga fund' i zemërës së shkret", në

të tretën "e motr' e jetës", "Un", në të katërtën "Dh'ashtu", si edhe të tjera në vazhdim, janë përdorur, pikërisht, për t'i dhënë vargut ritmin e duhur dhe harmoninë tingullore. Duke lexuar poezinë nga fillimi në fund vërejmë se tensioni e zjarri i brendshëm sa vjen e rritet, kulmon në strofën e gjashtë dhe më pas vendin ia le dhembshurisë për çastet e lumtura e të kaluara dhe për jetën që ka fluturuar lart në përjetësi.

Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar
Nxënësit lexojnë në tekst karakteristikat e përmbledhjes.

Karakteristika të përmbledhjes:

- ✓ Përmbledhjet ndryshojnë nga njëra-tjetra.
- ✓ Përmbledhja karakterizohet nga ruajtja e informacionit bazë duke I hequr pjesë të tepërta (informacion, figura letrare).
- ✓ Përmbledhja përmban informacionin bazë,rendin e ngjarjeve dhe elementët kryesorë: detaje, personazhe, opinione etj.
- ✓ Përmbledhja ka këtë strukturë: hyrje, zhvillim dhe përfundim.
- ✓ Gjatë përmbledhjes ndodhin këto procese.



Hapi i tretë: Lexim
Nxënësit lexojnë modele përmbledhjesh.
Model 1



Model 2.



Hapi i katërt: Punë në grupe
Mësuesja e ndan klasën në grupe.



Grupi 1: Të përmbledhë subjektin me fjalët e tyre si dhe idenë e kësaj poezie.
Grupi 2: Të zgjedhë një poezi dhe të shkruajë përmbajtjen e saj.
Grupi 3: Të zgjedhë një paragraf dhe të shkruajë përmbajtjen e saj.
Hapi i pestë: Praktikë e pavarur
Nxënësit pasi lexojnë fragmentin e shkëputur nga "Historia e Skënderbeut" bëjnë përmbledhjen e tij.
Këndo, engjëll, urtësinë,
Edhe gjithë mirësitë,
Skënderben, e trimërinë,
q'i dha Shqipërisë dritë
Të lumtë goja,këndona,
Në gjuhë t'ëmblë si mjaltë
Skënderben' e math tregona,
Trimnë e burrë, Zotnë e naltë.

Punëtë që ka punuar Kordhëtari i vërtetë, Kombinë duke nderuar Dhe Shqipërinë përjetë. Nga gjiri i Perëndisë Pa m'i sill nër mënd të mija, T'i ap dritë Shqipërisë Nga shpirt'i ndritshëm i tija. Ëngjëll i bukur, pa zbritmë, Dhe me dritët të uruar Shko përpara mej'e ndritmë, Të shoh gjithë ç'kanë shkuar. Që kur ngrehu gjithësinë Zot'i madh e i vërtetë, Ka bërë dhe Shqipërinë E shqipëtarët në jetë. Shqipëria kurdoherë Ka qënë shum' e lëvduar, Ka pasur burra të ndjerë, Trima t'urt' e të dëgjuar. Pati mbretër' e të parë Fort të mëntshim e të mirë, Burra, trima, shqipëtarë, Që kan' emrë të pavdirë. Ishte vënt' i Perëndisë Që së pari Shqipëria Mëmëdheth'i urtësisë, Që del soje mirësija. Aleksandr'i Math e burrë I cili s'pat shok në jetë, Nukë ka pasurë kurrë Dhe kurrë do të mos ketë Piro trimi e të tjerë Burra shumë të lëvduar, Që kanë qënë një herë, Edhe sot s'janë harruar, Qenë gjithë shqipëtarë, Ishin djemt' e Shipërisë, Nuk' ishin greq e bullgarë, Po nga vënd'i Perëndisë.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive.
Detyrë: Punë përgatitore: Mendoni romanin tuaj të preferuar dhe realizoni skedën e tij.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Punë me shkrim **Tema mësimore:** Përmbledhja (ora e dytë)		**Situata e të nxënit:** Punë me shkrim	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Ndërton përmbledhjen e romanit 2. Punon me kujdes sipas teknikave të përcaktuara 3. Ndërton fjali me kuptim por edhe të rregullta nga ana gjuhësore		**Fjalët kyçe:** *përmbledhje, fjalë kryesore, ligjëratë e zhdrejtë, roman, vepër letrare dhe jo letrare etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjuha shqipe.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë me shkrim.			
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Punë me shkrim: Pasi kanë bërë fazën e tyre përgatitore në shtëpi nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në fletoren e punës me shkrim. Nxënësit ndërtojnë përmbledhjen e romanit të tyre të preferuar. Duhet të tregohen të kujdesshëm: ✓ Përmbledhja të mos jetë as shumë e gjatë, as shumë e shkurtër. ✓ Përmbledhja të ketë informacionin kryesor. ✓ Të hiqen pjesët e panevojshme. ✓ Të ndërtojnë fjali me kuptim, jo shumë të gjata. ✓ Të tregohen të saktë nga ana gjuhësore.			
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet vlerësimi i punëve me shkrim.			
Detyrë: Bëni përmbledhjen e një libri të lexuar kohët e fundit.			

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Shkalla:** V	**Klasa:** X
Rubrika: Humanizmi dhe Rilindja evropiane **Tema mësimore:** Miguel De Servantes Saavedra, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit:** Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Servantesit që ndikuan në krijimtarinë e tij; 2. Veçon veprat kryesore të Servantesit; 3. Gjykon për mënyrën se si filozofia e Rilindjes gjen shprehje në krijimtarinë e Servantesit.	**Fjalët kyçe:** *Servantes, Spanjë, romane kalorësiake, mbledhës taksash.*
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, pyetje- përgjigje, diagram i Venit.	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja i pyet nxënësit: Ç'dini për Servantesin?



Hapi i dytë: Pyetje-përgjigje

Mësuesja i drejton pyetje klasës pas marrjes së informacionit.

- Si ndikuan udhëtimet, shkollimi dhe ngjarjet e mëdha të kohës në krijimtarinë e mëvonshme të Servantesit?
- Cila janë veprat e para dhe zhanret që lëvroi ky autor?
- Si kalon autori nga forma predikuese në atë demaskuese? Ç' atmosferë dhe frymë përmbajnë këto vepra?

Hapi i tretë: Diagrami i Venit. Përshkruajmë ndryshimet në tematikën e veprave nga Novelat Didaskalike deri te Don Kishoti?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Si lidhet stili I jetës së Servantesit me veprën dhe stilin e veprës së tij?*

Detyrë: Zbërtheni thënien e Fan Nolit për veprën e Servantesit: "Don Kishoti i Mançes ka qenë, për çdo kohë e për çdo vend një nga veprat më popullore të botës, popullore edhe për çiliminjtë, edhe për filozofët e vrenjtur, si Kanti dhe Shopenhauri. Po kjo vepër nuk do të ishte aq e bukur, sikur të na bënte vetëm të qeshnim. Na bën edhe të qajmë" .

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Analizë "Don Kishoti" M.De Sevantes; Rilindja dhe Servantesi, donkishotizmi		**Situata e të nxënit:** Letërsia kalorësiake	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Tregon përmbajtjen e romanit. 2. Diskuton mbi stilin dhe gjuhën e kësaj vepre. 3. Diskuton mbi veprat humane që përcjell vepra. 4. Shpjegoni përmes shembujve se cilat janë disa nga vlerat e donkishotizmit		**Fjalët kyçe:** *Rilindje Evropiane, Don Kishoti, Sanço Pança, Dylqinja e Tabozës,mullinjtë e erës etj.*	
Burimet: teksti I nxënësit, materiale nga interneti, romani Don Kishoti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: ritregim, portretizim i personazheve, diskutim, pyetje-përgjigje, lexim.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Ritregim

Nxënësit ritregojnë përmbajtjen e më pas e plotësojmë atë me detaje të tjera.



Hapi i dytë: Portretizimi i personazheve
Dimë se personazhet kryesorë të këtij romani janë Don Kishoti dhe Sanço Pança. Së bashku me nxënësit përcaktojmë karakteristikat e tyre.



Hapi i tretë: Diskutim
Mësuesi/ja drejton pyetjen: *A keni dëgjuar të thonë "Ai njeri është donkishot?"*
Bëhet sqarimi i termit në tabelë.



Hapi i katërt: Pyetje-përgjigje
Pas leximit të informacionit mësuesja i drejton pyetje klasës
1. Si do ta përcaktonit apo karakterizonit kohën në të cilën u shkrua kjo vepër?
2. Çfarë ndodh me personazhin e Don Kishotit në roman? Si e parodizon Servantesi botën dhe jetën përmes tij? Nga buron komizmi?
3. Cilat janë të veçantat e subjektit të veprës?
4. Me ç'mjete artistike zbërthehet marrëzia e Don Kishotit në këtë vepër?
5. Pse gjithmonë Don Kishoti shihet I lidhur me personazhin e Sanço Pançës? Ku qëndron vlera e kontrastit midis tyre?

6. Ç'pyetje-dilemë shtrohet te vepra Don Kishoti? Si ndiheni dhe si reagoni ju përballë kësaj dileme? Kush është në të vërtetë Don Kishoti? **Hapi i pestë**: Lexim dhe interpretim Lexojmë materialin plotësues mbi donkishotizmin, interpretimet rreth saj si dhe komentojmë thëniet e Alfred Uçit, A.Kastro, M.Fuko etj.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Cili është roli I moralizimeve të Don Kishotit? Pse këshillat e tij janë mësime të vyera për jetën dhe njeriun?*
Detyrë: Lexoni prologun nga romani.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Fragment, prologu "Don Kishoti" M. De Sevantes		**Situata e të nxënit:** Letërsia kalorësiake	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Njihet me informacionin që na jep prologu. 2. Shpjegon pse kjo është një histori e thjeshtë dhe pa ngatërresa. 3. Vlerëson qëndrimin e autorit ndaj njerëzve të thjeshtë dhe identifikon hapat që ndjek ai për të kaluar nga thënia deri në bindje. 4. Diskuton mbi mënyrën e të shprehurit të autorit në prolog.		**Fjalët kyçe:** *Don Kishoti, libri, miku im.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, shkumësa me ngjyra, libri.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti , punë në grupe, rrjeti i diskutimit.			
Organizimi i orës së mësimit **Hapi i parë:** Lexim dhe shpjegim teksti Së bashku me nxënësit lexojmë fragmentin hyrës të romanit. Më pas punojmë me pyetjet e rubrikës: Kuptim dhe shpjegim teksti 1. Ç'informacion na jep prologu I veprës si strukturë hyrëse? Kujt i drejtohet ai? 2. Cili është qëllimi i shkrimit të kësaj vepre, sipas autorit? Po i vetë prologut? 3. Si e kuptoni shprehjen: "Lexues I plogësht"? Po atë që vjen më pas: "O lexues I shtrenjtë?" Në ç'raporte shpirtërore e vendos autori veprën dhe lexuesin?			

4. Ç'lloj kulturash,autorësh dhe veprash referon Servantesi në prologun e tij?
5. Pse kjo është një histori e thjeshtë pa ngatërresa?

Hapi i dytë: Punë në grupe

Mësuesja e ndan klasën në grupe ku secili grup merr nga një detyrë.

Grupi 1. Të dallojnë lirinë, por edhe respektin që krijon autori në vepër.

Grupi 2. Te tregojnë temën dhe mesazhin që përcjell ky fragment.

Grupi 3. Të tregojnë mendimin e Servantesit për romanet kalorësiake.

Grupi 4. Të tregojnë dy risitë kryesore të veprës.

Hapi i tretë: Rrjeti i diskutimit

Së bashku me nxënësit diskutojmë mbi mënyrën e të shprehurit në këtë prolog.

PO		JO
	Si shprehet autori në këtë prolog? A i përshtatet ky stil mesazhit të veprës?	

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Diskutoni mbi Don Kishotizmin*

Detyrë: Nisur nga prologu dhe mesazhi që ai përcjell bëni një diskutim rreth vlerës së librave që qarkullojnë në treg. Sipas jush ç'rol luan shkolla në referimet drejt librit të duhur dhe shijeve të leximit?

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Fragment, kreu XXII-XXIII		**Situata e të nxënit:** Fan Noli, përkthimet e tij	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Rendit detajet kryesore të situatës në të cilën ndodhen personazhet. 2. Klasifikon fjalët e urta në bazë të tematikave. 3. Gjen kështillat që tregojnë thjeshtësi arsyetimi e gjykimi. 4. Diskuton mbi vlerën e humorit në to. 5. Nxjerr dhe komenton disa nga mesazhet që përcjellin këto fjalë të urta.		**Fjalët kyçe:** *Don Kishot, Sanço Pança, duka etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, piktura.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti, punë në grup, diskutim.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti

Nxënësit lexojnë fragmentet nga romani dhe më pas punojmë me pyetjet e rubrikës: Kuptim dhe shpjegim teksti.

1. Identifikoni tre situatat në të cilat vendosen personazhet tanë dhe më pas tregojmë se cila prej tyre shtjellohet në këtë fragment.

Situatat:

a) Shfaqja e magjistarit Merlin që deklaron se magjia e Dulqinjës do të zhduket nëse Sanço Pança do të vetëfshikullohet me 3300 kamxhikë
b) Aventura e dy heronjve që marrin përsipër të shpëtojnë personazhet e magjepsur nga magjistari Malambruno.
c) Duka e emëron Sançon si Guvernator të ishullit Barataria.

Në këtë fragment shtjellohet situata e tretë.

2. Renditni detajet kryesore të situatës në të cilën ndodhen personazhet në këtë fragment

a) Don Kishoti i jep këshilla Sanço Pançës para se ai të niset.

Hapi i dytë: Punë në grupe

Sipas objektivave të përcaktuar e ndajmë klasën në grupe dhe i japim nga një detyrë.

Grupi 1. Klasifikojnë fjalët e urta në bazë të tematikave

Grupi 2. Shpjegojnë kuptimet e pesë këshillave të dhëna nga Don Kishoti

Grupi 3. Të bëjnë krahasimin midis këshillave të Don Kishotit dhe këshillave që përdorim në ditët e sotme

Grupi 4. Të gjejë ndryshimet midis bllokut të parë dhe bllokut të dytë të këshillave.

Hapi i tretë. Diskutim

Këto fragmente kanë shumë këshilla të cilat ndikojnë në zbulimin e karaktereve të personazheve. Çfarë del midis tyre marrëzia apo mençuria e Don Kishotit? A janë ato argëtuese sesa moralizuese? Në ç'raport janë midis tyre lodhja dhe mërzitja nga njëra anë, me argëtimin dhe humorin nga ana tjetër? Ku qëndron rëndësia e fjalës te to, në përqendrimin te informacioni, apo në detajin që spikat?

Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre duke ilustruar edhe me shembuj nga teksti

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke bërë vlerësimin e tyre me notë.

Detyrë: Për të pasur një panoramë sa më të plotë për veprën mjaft i rëndësishëm është dhe mendimi i kritikës për të. Diskutoni mbi të dhëna të tilla përgjatë analizës dhe komentit të kësaj vepre.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Uilliam Shekspir, jeta dhe vepra		**Situata e të nxënit: informacion nga Shekspir**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan momentet kryesore të jetës së Shekspirit, të cilat ndikuan në krijimtarinë e tij. 2. Veçon veprat kryesore të Shekspirit. 3. Diskuton dhe vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Shekspirit në letërsinë botërore.		**Fjalët kyçe:** Stradford mbi Avon, 1564, u martua 18 vjeç, Otello, Hamlet, Makbeth etj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, muzika, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, pema e mendimit, përmbledhje e strukturuar, pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit, punë me shkrim.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë emrin e Shekspirit, nxënësit plotësojnë ç'dinë rreth tij.



Hapi i dytë: Pema e mendimit

Lexojmë materialin në libër e më pas diskutojmë rreth krijimtarisë së tij.



Hapi i tretë: Përmbledhje e strukturuar

Së bashku me nxënësit ndërtojmë skeda të informacioneve të mësimit

MENDIMI FILOZOFIK I TRAGJEDIVE

- Tragjedi të mbarsura me mendim filozofik mbi problemet e jetës së njeriut.
- Zgjidhja e konflikteve kuptim të fortë përgjithësues.
- I mëson njerëzit të njohin jetën dhe vetveten.
- Mbron idenë humaniste të barazisë midis njerëzve.

TIPARE TË KOMEDISË SHEKSPIRIANE

1. Trajtojnë vlerën e drejtësisë,sinqeritetit,ndershmërisë, miqësisë. E dashurisë në marrëdhëniet njerëzore.
2. Heronjtë dalin gjithmonë fitues pasi janë njerëz me iniciativë e me qëllime të përcaktuara.
3. Personazhet shprehin gjendjen shpirtërore të epokës së Rilindjes.

VEÇORI TË TEATRIT SHEKSPIRIAN

1. Paraqet jetën reale përmes lojës së fantazisë dhe realitetit të historisë.
2. Shfrytëzoi tragjedinë klasike të antikitetit, dramën popullore angleze, komedinë italiane.
3. Përvijon normat për një teatër të ri.
4. Njeh psikologjinë e personazheve.
5. Personazhet janë qenie të gjalla me pasione e vese të shumta.
6. Temat e parapëlqyera janë: dashuria, lufta për pushtet, madhështia dhe mjerimi etj.
7. Gjuha shumë e pasur rreth 20000 fjalë me përdorim të dendur të fjalëve të urta.

Hapi i katërt: Pyetje-përgjigje
Mësuesja i drejton pyetje klasës për të kuptuar edhe më mirë informacionin e ri.

- Si ndikuan në veprën e Shekspirit zhvillimet e kohës?
- Çfarë ju bën më shumë përshtypje në ndryshimet e ndryshme mbi Shekspirin?
- Çfarë informacionesh ka mbi jetën e Shekspirit? Si ndikuan në shkrimin e veprave të tij këto detaje të jetës që ai bëri?
- Kur I pati Shekspiri kontaktet e para me teatrin? Si I ngjiti ai shkallët e karrierës në të?
- Pse themi që krijimtarinë e periudhës së parë të Shekspirit e karakterizon optimizmi?
- Cilat janë disa nga tematikat dhe konfliktet e veprave Shekspiriane? Kujt I hapi luftë autori përmes tyre?
- Ç'mund të themi për Shekspirin humanist?
- Si ndryshojnë komeditë nga tragjeditë e tij?
- Cilat janë karakteristikat e periudhës së dytë dhe të tretë?
- Ç'e bën të veçantë gjuhën Shekspiriane?

Hapi i pestë: Rrjeti i diskutimit
Mësuesja shtron një çështje nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre

PO		JO
	Personazhet e Shekspirit janë qenie plot pasione dhe vese	

Hapi i gjashtë: Punë me shkrim
Të përshkruajnë në fletore madhështinë e periudhës së dytë shekspiriane, ku jeta dhe lufta e njeriut për të, e tejkalojnë pesimizmin e autorit. Mendimi mund të ilustrohet me shembuj nga veprat e tij. (jo më shumë se gjysmë faqe)

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Roli i Shekspirit në letërsinë botërore.

Detyrë: Sillni në klasë një sonet nga Shekspiri.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Analizë "Hamleti" U. Shekspir		**Situata e të nxënit:** Tragjeditë e Shekspirit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Flet shkurtimisht mbi subjektin dramatik,duke ndjekur rrjedhën e ngjarjeve. 2. Analizon raportin midis dyshimit hamletian dhe çmendurisë së tij. 3. Analizon kompozicionin e veprës.		**Fjalët kyçe:** Hamlet, Gertruda, Klaud, fantazma e vdekur, Horati, Marceli etj.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, kinematografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: harta e veprës, portretizimi i personazheve, lexim dhe interpretim, pyetje-përgjigje.			

Organizimi i orës së mësimit

Punë parapërgatitore: Shohim në videoprojektor pjesë nga tragjedia "Hamlet" luajtur nga aktorët tanë të Teatrit Kombëtar,ose pjesa e luajtur nga A. Moisiu,biseda me kafkën.

Hapi i parë: Harta e veprës

Mësuesja shkruan në dërrasë titullin e veprës dhe së bashku me nxënësit e plotësojmë atë.



Hapi i dytë: Portretizim i personazheve
Hamleti është epiqendra e tragjedisë. Mësuesja shkruan në dërrasë emrin e tij dhe nxënësit plotësojnë atë me informacionin që dinë dhe atë që ka libri.



Hapi i tretë: Lexim dhe interpretim
Lexojmë thëniet e Eliot, Gëte, Niçe, Bredli, R. Luperini, M. Fuko mbi tragjedinë "Hamlet". Nxënësit janë të lirë të bëjnë interpretimet e tyre.
Hapi i katërt: Pyetje-përgjigje
Pas leximit të informacionit mësuesja i drejton pyetje klasës.

- Kujt periudhe të krijmtarisë shekspirane i përket vepra "Hamleti"?
- Për çfarë shquhet kjo periudhë?A përmban hamlet karakteristika të saj?
- Si ndërtohet kompozicion I veprës?Pse themi se ka një strukturë model?
- Ku e ka burimin lufta e brendshme e personazhit të Hamletit?A mishëron ai ideale të Rilindjes?

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke bërë edhe vlerësimet me notë.

Detyrë: Lexoni aktin I, skena II-III nga tragjedia "Hamlet".

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Fragment "Hamlet" akti I, skena II-III		**Situata e të nxënit:**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton motivet shekspiriane në këtë tragjedi. 2. Gjen fjalët dhe shprehjet që tregojnë aftësinë parashikuese të Hamletit. 3. Shpjegon dhe diskuton mbi figurat mitologjike që dalin në këtë skenë. 4. Nënvizon qëllimin parësor të teatrit shekspirian. 5. Dallon përmes formës së ligjërimit dialogun dhe monologun.	**Fjalët kyçe:** Laerti, Ofelia, Poloni, Hamleti
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, tragjedia, videoprojektor.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, kinematografia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti, ditari dypjesësh, pyetje përgjigje, punë në grupe, rrjeti i diskutimit.	

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti

Nxënësit lexojnë sipas roleve aktin I, skenën II dhe III. Pas leximit punojmë me rubrikën 1.

- Hamleti është shkruar në periudhën e dytë të krijimtarisë së Shekspirit dhe mbizotërohet nga notat e melankolisë dhe pesimizmit.
- Nënvizoni qëllimin parësor të teatrit shekspirian që demonstrohet në këtë fragment.
- Analizoni këshillat që Poloni i jep të birit. Cila është këshilla mbi këshillat? (mbaji besë vetes) Pse babai e sheh të arsyeshme të këshillojë të birin?
- Analizoni strukturën e veprës.
- Hamlet është vetëm. Si ndihet ai? Përshkruani shenjat e dyshimit të tij? I mërzitur, plot mllef. (Po plas o zemër se s'do hapur goja.

Hapi i dytë: Ditari dypjesësh

Mësuesja shkruan në tabelë disa shprehje, nxënësit i komentojnë ato.

Vargje	**Komenti**
Udhën e mbarë e paç uratën Në kokë ç'ke mbi gjuhë mos e nxirr, Mos shfaq me vepër një mendim pa vend Ji familjar dhe jo vulgar aspak Mos lodh dorën duke përkëdhelur etj.	Nëpërmjet shprehjeve popullore Polloni tregohet një baba i kujdesshëm, por tepër i kujdesshëm për fatin e të birit.

Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje

Mësuesja i drejton pyetje klasës në lidhje me të dy fragmentet.

- Cili nga motivet shekspiriane trajtohet në këtë tragjedi? Ç'pjesë e problematikave jetësore integrohen me tematikën e tragjedisë?
- Në aktin e parë mbizotëron pikëllimi dhe dyshimi apo ndrojtja e dilema? Dashuria dhe urrejtja apo guximi dhe vetëmohimi?

- Ku duket në fragment që Hamleti respekton kodet dhe zakonet? (na u martua nëna me tim ungj/me të kunatin me të vëllanë e babës etj)
- Çfarë ndodh në të vërtetë në skenën e tretë?
- Ç'mendim filozofik bart vepra e Hamletit?
- Ç'nënkupton vargu: " Se er'e mirë po i fryn pëlhurët?"

Hapi i katërt: Punë me grupe

Mësuesja e ndan klasën në grupe.

Grupi I. Tregojnë se si përshkruhet mbreti I vrarë dhe nëna e Hamletit në këtë akt (Skena II)

Grupi II. Gjejnë fjalët dhe shprehjet që tregojnë aftësinë parashikuese të Hamletit për ngjarjet që do të pasojnë.

Grupi III. Gjejnë figurat mitologjike që dalin në këtë skenë dhe diskutojnë mbi to.

Hapi i pestë: Rrjeti i diskutimit

Mësuesja hedh për diskutim këtë shprehje: "Dobësi,ke emri n grua", duke u bashkangjitur me veprimin e Gertrudës dhe të Ofelisë.



Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit, duke bërë vlerësimet përkatëse.

Detyrë:

- Dalloni përmes formës së ligjërimit monologun dhe dialogun në aktin e parë nga akti i dytë.
- Lexoni aktin II, skena II, aktin III, skena I .

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Rilindja **Tema mësimore:** Fragment skena II, akti III		**Situata e të nxënit: Diskutim mbi Hamletin (pjesë)**	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Rendit disa nga arsyet e qëndrimit ironik të Hamletit 2. Shpjegon raportin midis qëllimit hamletian dhe realitetit. 3. Analizon karakteristikat e monologut të famshëm hamletian.		**Fjalët kyçe:** *Hamlet, Gildersterni, Rozenkranci, Hamlet.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, koreografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti , diskutim, pyetje përgjigje, praktikë e drejtuar , lexim .			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti

Nxënësit lexojnë të dy fragmentet e shkëputura nga tragjedia.

Akti II,skena II. Klaudi u kërkon miqve të Hamletit të zbulojnë shkaqet e " transformimit" te tij. Polloni mendon se është Ofelia shkaku, po mbreti dhe mbretëresha nuk binden.

Akti III,skena I. Monologu i Hamletit është një nga pjesët më të bukura.

Pas leximit për të kuptuar dhe më mirë atë punojmë me rubrikat.

- Vini re tonet ironike të Hamletit në fillim të fragmentit. Rendisni disa nga arsyet e këtij qëndrimi.
- (Do t'ju them përse: kështu, meqenëse e mora vesh punën para se të ma zbuloni, s'keni nevojë t'i thoni mbretit dhe mbretëreshës që ma treguat dhe s'ju bien pendët në sy të tyre etj.)
- " Imzot,s'kam patur një gjë t'atillë ndër mend". Si do ta përshkruanit prej këtij vargu miqësinë e Rozenkrancit e të Hamletit? (mosbesues)
- Më në fund jemi mirëfilli në mes të konfliktit shekspirian. Një mbret dhe një mbretëreshë bëhen bashkë. Cili është qëllimi I tyre dhe çfarë konflikti ndez ai? Veçoni pikën kulmore.
- (Mbreti dhe mbretëresha janë bërë bashkë për të zbuluar arsyen e çmendurisë së Hamletit.)

Këtu ndeshen njeriu pa vese me njeriun e drejtë.Si jepet kjo luftë midis së mirës dhe së keqes?Nëpërmjet monologut Hamleti kërkon të godasë padrejtësitë. Më shumë se të hakmerret për të atin,kërkon të ndreqë prapësinë e botës. Kjo shprehet që në fillim kur Hamleti thotë: Të rrosh, a të mos rrosh – kjo është çështja….

- Për ç'arsye e ndërpret monologun në fund Hamleti? (Ai e ndërpret monologun në fund kur shikon Ofelinë, e cila hiqet sikur ka shkuar aty për t'i kthyer atij dhuratat që ky i ka bërë asaj.)

Hapi i dytë: Diskutim
Mësuesja I fton nxënësit të diskutojnë mbi këto çështje: (Ata janë të lirë të japin mendimin e tyre.)

1. Mesazhi: "Njeriu s'më gëzon"
2. Dilemën e famshme të Hamletit: "Të rrosh atë mos rrosh, kjo është çështja"

Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje
I drejtohen pyetje klasës mbi fragmentet.

- Hamleti u mban shokëve të tij një leksion, në qendër të të cilit është pikëpamja e tij për njeriun. Kur dhe si është I vlefshëm njeriu, sipas Hamletit?
- Pse u gjet tematika e aktorëve nga hamlet?
- Ç'përfaqëson Hamleti? Çfarë misioni merr përsipër ai? Si jepet nga mjeshtri i tragjedisë ky mision?
- Hamleti del si njeri I veprimit apo I ëndrrës?
- Cilat janë disa nga karakteristikat e monologut të famshëm hamletian?

Hapi i katërt: Praktika e drejtuar
Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur më disa pyetje nga rubrika.

- Shpjego peshën kuptimore të fjalës ose të togut të fjalëve në shembujt e dhënë: zemërdhembje, mijëra tronditje ,lëngimin e dashurisë. (Nëpërmjet këtyre metaforave emërore, jepet gjendja shpirtërore e vet Hamletit, padrejtësitë dhe vuajtja e njerëzve të virtytshëm.)
- Cili është roli i foljeve dhe i emrave që ndërtojnë sinonimi dhe antonimi si në rastin e shembujve: vdeç - të flesh,gjumë -vdekje. (Na shërbejnë për të treguar dilemën e vetë Hamletit.)
- Gjeni fjalët kyçe në vargjet që pasojnë dhe shpjegoni kuptimin që Hamleti u jep atyre. "Njeriu s'më gëzon, jo, as gruaja, ndonëse me nënqeshjen tuaj më dukeni sikur thoni që po."

  Fjalët kyçe: pritje kreshmore, blatime, kalorës i aventurave, tragjedianët e qytetit.

Hapi i pestë: Lexim
Lexojmë material nga internet mbi oratorinë në antikitet.
Historia e arteve përfshin çdo aktivitet ose produkt të krijuar nga njeriu për qëllime estetike ose komunikuese që shprehin ide, emocione ose në përgjithësi, një vizion të botës. Arti përdor metoda të ndryshme, të tilla si plastike, gjuhësore, sonore apo të përziera. **Historia e arteve** si një disiplinë akademike si dhe mjedisi institucional (muzetë, tregu i artit, departamentet e universiteteve dhe shtëpitë botuese) e kanë zakon ta kufizojnë atë në të ashtuquajturat arte pamore ose plastike (në thelb piktura, skulptura dhe arkitektura) ndërsa që artet e tjera studiohen në mënyrë më specifike nga disiplina të tjera, të përcaktuara qartë, si historia e letërsisë apo historia e muzikës, duke qenë të gjitha objekt vëmendjeje nga e ashtuquajtura histori e kulturës apo historia kulturore, së bashku me historitë sektoriale të fokusuara në manifestime të tjera të mendimit, si historia e shkencës, historia e filozofisë apo historia e religjioneve. Disa fusha të dijes të lidhura ngushtësisht me historinë e artit, janë estetika dhe teoria e artit. Përgjatë kohës arti ka qenë klasifikuar në mënyra të ndryshme, që nga ai mesjetar në arte liberale dhe arte mekanike, në klasifikimin në arte të bukura dhe arte të aplikuara dhe deri te përcaktimet bashkëkohore, ku arti shihet

si një shfaqje e kreativitetit njerëzor. Një ndarje e shekullit të XX e arteve, megjithëse nuk i përfshin të gjitha, është ajo e "nëntë arteve". Ajo u hartua fillimisht në vitin1923 nga poeti Italian Ricciotto Canudo dhe u zgjerua me dy zërat e fundit nga kritiku francez Claude Beylie në 1964. Kështu, lista e arteve kryesore në shekullin e XX përfshinte: arkitekturën, kërcimin, skulpturën, muzikën, pikturën, poezinë (e përshkruar gjerësisht si letërsi me funksion estetik, e cila përfshin edhe llojet e veçanta të teatrit dhe rrëfimit), kinemaja, radio-televizioni dhe tregimet figurative (comics). Tanimë, përveç formave të vjetra të shprehjes artistike po konsiderohen edhe mënyra të reja shprehjeje artistike si moda, gastronomia, compiuter art-i, artet grafike, performaca, reklama, animimi dhe videolojërat. Historia e artit është një degë e arteve dhe shkencave, që kërkon një ekzaminim objektiv të artit përmes kohës, duke klasifikuar kulturat, vendosur periodizimet dhe duke vëzhguar karakteristikat dalluese dhe ndikuese të artit. Studimi i historisë së artit u zhvillua fillimisht gjatë Rilindjes, me qëllimin e saj të kufizuar në prodhimin artistik të qytetërimit perëndimor. Gjithsesi, me kalimin e kohës, vendosi një shikim më të gjerë të historisë së artit që ka një përmbledhje të përgjithshme të gjithë qytetërimeve dhe analiza të prodhimit të tyre artistik sipas vetë vlerave të tyre (relativizmi kulturor) dhe jo vetëm sipas historisë së artit perëndimor.

Sot, arti gëzon një rrjet të gjerë studimi, përhapja dhe konservimi i gjithë trashëgimisë artistike të njeriut përgjatë historisë. Shekulli XX ka parë përhapjen e institucioneve, fondacioneve, muzeve dhe galerive të artit, në sektorin publik dhe privat, dedikuar analizave dhe katalogimit të punëve artistike ashtu si dhe ekzibicione që synojnë një audiencë të zakonshme. Ngritja e mediave ka qenë themelore në përmirësimin e studimit dhe përhapjes së artit. Ngjarje ndërkombëtare dhe ekzibicione si Whitney Biennial dhe bienalet e Venecias dhe São Paulos ose the Documenta of Kassel kanë ndihmuar zhvillimin e stileve dhe trendeve të reja. Çmime si ai Turner i Tate Gallery-së, Wolf Prize in Arts, Pritzker Prize i arkitekturës, Pulitzer i fotografisë dhe ai Oscar në kinematografi promovojnë gjithashtu punët më të mira krijuese në një nivel ndërkombëtar. Institucione siUNESCO, me vendosjen e listave të World Heritage Site, ndihmon gjithashtu në konservimin e monumenteve kryesore në botë.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke bërë vlerësimin e nxënësve.

Detyrë: Komentoni vargjet: Kush vallë barra e mban e kush dërsin/ Rënkon nënë një jetë të mërzitur.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: letërsi</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Bisedë letrare
Tema mësimore: Bisedë letrare për letërsinë e Rilindjes</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Bisedë, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3. Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Përcakton kushtet historike dhe kulturore në të cilat u shkrua letërsia e rilindjes
2. Rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së rilindjes
3. Analizon veprat e kësaj letërsie.
4. Përcakton momentet kryesore të jetës së De Radës.
5. Rendit veprat e tij.
6. Tregon subjektin e veprës.
7. Analizojmë gjuhën stilin, motivet e poemës “Këngët e Milosaos”.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: letërsi e Rilindjes, De Rada, Milosao, motiv i dashurisë, motive patriotike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Me historinë,gjuhën shqipe,fotografinë,pikturën,teatrin</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe interpretim, stuhi mendimesh, analizë, harta e veprës, dëgjim.</td></tr>
</table>

Organizimi I orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe interpretim

Nxënësit lexojnë krijime të ndryshme nga Letërsia e Rilindjes, nga N. Frashëri, Z. Serembe, G. Dara, J. De Rada, Çajupi, N. Mjeda etj.

Hapi i dytë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë termin Letërsi e Rilindjes.





Hapi i tretë: Analizë Për ta bërë më konkretë këtë zhvillim të letërsisë së Rilindjes ne marrim si përfaqësues të saj J. De Radën dhe veprën e tij "Kënga e Milosaos".

Në fillim nxënësit tregojnë ç'dinë për jetën veprën e tij. Këto mund të shoqërohen edhe me fotografi apo material të ndryshme nga internet.



Hapi i katërt: Harta e veprës

Nxënësit diskutojnë mbi veprën e De Radës "Këngët e Milosaos" duke përqendruar vëmendjen te:

- ✓ Subjekti
- ✓ Kompozicioni
- ✓ Personazhet
- ✓ Motivet
- ✓ Gjuha e përdorur



Hapi i pestë: Lexim dhe dëgjim

Nxënësit lexojmë pjesë të ndryshme nga vepra duke e shoqëruar edhe me komente.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhët vlerësimi me notë i nxënësve.

Detyrë: Përshtatni në prozë një nga këngët e poemës " Këngët e Milosaos".

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: **Tema mësimore:** Përsëritje		**Situata e të nxënit:** Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton kushtet historike që ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e letërsisë së vjetër shqipe. 2. Flet mbi vlerat e mëdha të artit të Rilindjes. 3. Rendit disa nga veprat e para të letërsisë së vjetër shqipe. 4. Lexon dhe interpreton pjesë nga Dante, Servantesi dhe Shekspiri. 5. Shkruan panoramën e plotë të veprës së Dantes, "Komedia hyjnore". 6. Argumenton origjinalitetin e veprës "Don Kishoti". 7. Analizon rolin e gjuhës monologuese të Shekspirit.		**Fjalët kyçe:** *kushte historike, letërsi e vjetër shqipe, letërsi e Rilindjes, P. Bogdani, P. Budi, Komedia hyjnore, Don Kishoti, Hamleti, monolog, donkishotizëm etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, foto të ndryshme, shkumësa me ngjyra etj.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pyetje-përgjigje, analizë përmes shembujve, punë në grupe, prezantim, lexim dhe interpretim.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Pyetje-përgjigje

Kjo përsëritje konsiston në informacionet që kemi marrë deri tani për: Letërsinë e vjetër shqipe, Letërsinë e Rilindjes dhe përfaqësuesit kryesorë me veprat e tyre. P.Budi, P.Bogdani, Servantes, Shekspir etj. Mësuesja i drejton pyetje klasës**.**

- Një letërsi zhvillohet paralele me historinë e kombit të saj dhe rrethana të tjera. Cilat kushte historike ndikuan në lindjen dhe zhvillimin e letërsisë së vjetër shqipe?
- Cilët janë autorët dhe kontributet e tyre?
- Cilat janë veprat e para të letërsisë shqipe?
- Në cilat forma vepra e Bogdanit u mbështet në Bibël? Ç'detaje zbulojnë profilin filozofik të kësaj vepre? Si ndërthuret kjo filozofi me risitë poetike si dhe dijen e gjithanshme të autorit?
- Cilat janë tri pjesët e mëdha dhe nënndarjet e veprës "Komedia Hyjnore"?
- Cila është tema e tragjedisë Hamlet?
- Përse kishte ardhur koha për një vepër si Don Kishoti i Mançes?

Hapi i dytë: Analizë për mes shembujve
Në këtë rubrikë nxënësit jo vetëm japin përgjigje por e ilustrojnë atë me shembuj nga veprat e tyre

- Shpjegoni konceptin e humanizmit në veprën e M.Barletit dhe ndikimin e tij në stilin e autorit.
- Ka autorë që veprat e tyre i bazojnë në rrethana të caktuara historike, por në mënyrë subjektive. Kështu ndodh edhe me M.Barletin.Ç'qëllim I kishte vënë vetes ai?
- Si vjen figura e Skënderbeut përmes veprës së Barletit? A është ajo e përafërt me përfytyrimin që ju keni pasur deri më sot për këtë personazh historik?
- Përshkruani natyrën dhe rolin e Sibilave. Pse autori i quajti të tilla? Ku qëndron vlera simbolike dhe artistike e tyre? Pse ato shihen përmes rrëfimit edhe si fatthënëse?
- Analizoni përmes ilustrimit ngarkesën e informacionit që mbartin vargjet e Bogdanit.
- Dante ëhtë një autor që ndikoi në qytetërimin modern. Në ç'mënyrë u realizua kjo? Si i zgjedh Dante personazhet në varësi të mjedisit dhe kohës?
- Ç'argumente mund të jepni rreth origjinalitetit të veprës Don Kishoti?

Hapi i tetë: Punë në grupe
Mësuesja ndan klasën në grupe dhe përcakton detyrën për secilin grup.
Grupi 1. Flisni për autorët e mëvonshëm që janë mbështetur në veprën e Barletit. Ilustroni përmes fjalëve të Skënderbeut leksikun e pasur poetik.
Grupi 2. Moderniteti i veprës së Bogdanit. Ilustrime me shembuj (Sibilat). Flisni për gjuhën metaforike dhe simbolike të tij.
Grupi 3. Në pjesët për koment identifikoni pasurinë e madhe gjuhësore që përcjell letërsia e vjetër shqipe. Gjeni disa fjalë të vështira dhe parafrazoni kuptimet e tyre.
Grupi 4. Vepra danteske përcjell mesazhe universale që kanë vlerë edhe sot. Gjeni dhe shpjegoni disa prej tyre.
Grupi 5. Shpjegoni raportin që ekziston midis filozofisë së Rilindjes dhe personazheve të veprës së Servantesit. Humori i Servantesit. Ilustrojeni me shembuj
Grupi 6. Analizoni rolin e gjuhës monologuese të Shekspirit**.**

Hapi i katërt: Prezantim
Nxënësit janë të lirë të japin mendimet e tyre duke ilustruar me shembuj për ta bërë më konkrete por edhe më të bukur orën e mësimit.

- Gjejnë vepra të artit me subjekt figurën e Skënderbeut



- Krijime mbi figurën e Skënderbeut.

"...Kur u ngrys e kur u err,
Skënderbeu, nder,
lavdi i asqerit osmanlli
Me turq bashkë krismën merr,
Si lëfton e si humbet Ditën e Rushajevet... ...
Pastaj sulet si shigjeta
Me treqint pothua veta
Nëpër lum`e pyll e garth
Përmi malet Argjendar (malet e Sharrit në Kosovë)
Dhe me zemrën plot gëzim
Kapërceu lumin Drin...
...Ja kështu Skënderi trim
Mori Krujën plot gëzim." Henri Llongfellou (1807-1882)

- Ilustrime mbi personazhet e Don Kishotit dhe Sanço Pançës.

Hapi i pestë: Lexim dhe interpretim
Lexojmë dhe interpretojmë pjesë nga Dante, Sevantesi, Shekspir.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke bërë edhe vlerësimin me notë.

Detyrë: Të bëjnë portretin e një prej personazheve të veprave të Dante Aligerit, Servantesit, Shekspirit.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Klasicizmi, përfaqësuesit kryesorë dhe veprat e tyre.		**Situata e të nxënit:** Informacion mbi klasicizmin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton parimet dhe rregullat e klasicizmit. 2. Rendit autorët më të famshëm të kësaj periudhe. 3. Shpjegon rregullën e tri njësive të marrë nga antikiteti.		**Fjalët kyçe:** *klasicizëm, rregulla e tre njësive, La Fonteni, Zh. Rasin etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, piktura, muzika.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, përmbledhje e strukturuar, harta e shkrimtarëve, pyetje -përgjigje .			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë fjalën: Klasicizëm. Nxënësit e plotësojnë atë me informacionet e tyre dhe nga teksti.



Hapi i dytë: Përmbledhje e strukturuar

Pasi krijuam një informacion të përgjithshëm për klasicizmin kalojmë në parimet e tij. Në bazë të informacionit në tekst ndërtojmë një tabelë përmbledhëse



Hapi i tretë: Harta e shkrimtarëve

Pasi u njohëm dhe me parimet e tiparet e klasicizmit, lexojmë materialin në libër për përfaqësuesit e kësaj rryme.



Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje Mësuesja i drejton pyetje klasës. • Pse koha në të cilën lulëzoi teatri francez u quajt "shekulli i artë"? • Rryma letrare e klasicizmit pati parimet dhe rregullat e saj. Në cilën vepër u sanksionuan ato dhe cili qe ndikimi i saj në gjithë krijimtarinë e klasicistëve? • Renditni autorët më të famshëm të kësaj periudhe dhe thoni se në cilat letërsi paralele e filozofi u mbështetën ata? • Flisni për ndikimin e teatrit antik në veprat e kësaj periudhe. Shpjegoni rregullën e tri njësive që u mor nga antikiteti. Ku mbështetej mbizotërimi i arsyes dhe ideja e harmonisë së dukshme me moralin në këto vepra? Si ju duket parimi klasicist: Autori duhet ta prekë spektatorin, por jo ta tronditë atë? • Cilat ishin disa nga temat universale dhe si ndikuan ato në dhënien e personazheve të pandryshueshme në veprat e autorëve klasicistë? Si duhet të ishte raporti i të vërtetës me jetën në veprat e kësaj rryme? • Çfarë kanë në thelbin e tyre teatri i Kornejit, i Molierit dhe i Rasinit? Shpjegoni karakterin didaktik të veprave të tyre në përshtatje me rrymën klasiciste. Pse këta shkrimtarë të mëdhenj ia dolën mbanë të ishin klasicistë të mëdhenj pa u bërë rob të rregullave të ngurta? • A kemi nota të klasicizmit në letërsinë shqipe?
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Pse klasicizmi përmes veprave të tij synonte ta bënte njeriun dhe jetën më të mirë?
Detyrë: Sillni materiale të ndryshme nga letërsia klasiciste, përtej tekstit.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Molieri, jeta dhe vepra.		**Situata e të nxënit:** Informacion mbi jetën dhe veprën e Molierit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton momentet kryesore të jetës së tij. 2. Rendit veprat e Molierit 3. Tregon veçoritë e teatrit të Molierit.		**Fjalët kyçe:** *Teatri i ndritur, aktor, avokat, teatër, veprat kryesore.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, gjeografia, arti, piktura, kinematografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: stuhi mendimesh, harta e mendimeve, pyetje-përgjigje, rrjeti i diskutimit.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Stuhi mendimesh

Mësuesja shkruan në dërrasë emrin e Molierit nxënësit e plotësojnë atë.



Hapi i dytë: Harta e mendimeve

Pas informacionit që morëm për Molierin, kalojmë te veprat dhe rëndësinë e teatrit të tij. Së bashku me nxënësit ndërtojmë hartën.





Hapi i tretë: Pyetje-përgjigje
Mësuesja i drejton pyetje klasës:

- Si e nisi rrugën e artit Molieri? Sa ndikuan në rrugëtimin e tij si artist tradita familjare, rastësitë e jetës dhe studimet që kreu?
- Çfarë shërbeu si shkollë e vërtetë për Molierin? Ç'ndikim pati puna si aktor shëtitës në shkrimtarin e mëvonshëm?
- Pse u krijua dhe pse pushoi së ekzistuari shumë shpejt teatri që krijoi ai?
- Molieri siguroi mbështetjen e oborrit mbretëror. Si ndikuan përmbajtjet, tematikat dhe fryma e komedive të tij për këtë arritje?
- Renditni disa vese të shoqërisë franceze që autori i vinte në lojë dhe shpjegoni mënyrën e zgjedhur nga ai si ndikim për një shoqëri ndryshe. Pse ai e quante komedinë në pasqyrë publike?
- Molieri ishte sa një klasik i madh, aq edhe pararendës i realizmit. Si e shpjegoni ju këtë duke iu referuar veprave të tij?

Hapi i katërt. Rrjeti i diskutimit.
Shpesh në biseda apo referime të ndryshme, ne ndeshemi me etiketime të tipit: koprac, mizantrop, don zhuan etj. Jo të gjithë e dinë që këto janë personazhe të krijuara nga Molieri. Përse emërtime të tilla janë bërë kaq popullore? Diskutoni mbi përdorimet simbolike që burojnë nga veprat e Molierit. Nxënësit janë të lirë të shprehin mendimet e tyre.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: Çfarë ka marrë Molieri nga letërsia pararendëse dhe çfarë të rejash solli ai në letërsinë e kohës?

Detyrë: Përmendni komedi të Molierit që keni parë në televizor. Diskutoni mbi temat e trajtuara, karakteret, gjuhën e përdorur.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Analizë "Tartufi" Molier		**Situata e të nxënit:** Analizë e veprës "Tartufi"	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përshkruan rrethanat, në të cilat lindi dhe u publikua komedia Tartufi 2. Përmbledh subjektin e kësaj vepre, duke u ndalur te: tematika, motivet etj. 3. Fleti rreth trajtimit universal që i ka bërë hipokrizisë Molieri. 4. Diskuton mbi zgjidhjen e situatës dramatike në vepër.		**Fjalët kyçe:** *Tartufi, hipokrizi klerikale, Orgoni, Elmira.*	

Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, komedia, vënie të veprës në skenë në Shqipëri.	**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, koreografia, psikologjia.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: harta e veprës, harta e veprës, rrjeti i diskutimit.

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Harta e veprës

Pasi bëjmë edhe njëherë një përmbledhje të informacionit të mëparshëm kalojmë te analiza e veprës. Mësuesja shkruan në dërrasë titullin e veprës. Nxënësit e plotësojnë atë.





Hapi dytë: Punë me grupe

Mësuesja ndan klasën në grupe dhe secilit grup i ngarkon nga një detyrë sipas objektivave të përcaktuara.

Grupi 1. Përshkruan rrethanat në të cilat lindi dhe u publikua komedia Tartufi

Grupi 2. Përmbledh subjektin e kësaj vepre, duke u ndaluar te tematika, motivet, personazhet, dramaciteti.

Grupi 3. Flet rreth trajtimit interesant që i ka bërë hipokrizisë Molieri.
Grupi 4. Tregon raportin e Molierit me jetën dhe njerëzit e thjeshtë.

Hapi i tretë: Rrjeti i diskutimit

PO		JO
	Diskutoni mbi zgjidhjen e situatës dramatik. Në vepër. Ç'mendim keni për të? A ju lë ky fund një shije artistike pozitive apo do të zgjidhnit një përfundim tjetër?	

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjen: *Pse vepra Tartufi është aktuale edhe sot?*

Detyrë: Krijoni një miniskenë të vogël në klasën tuaj dhe interpretoni pjesë të zgjedhura nga komedia "Tartufi".

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Fragment akti I, skena V		**Situata e të nxënit:** Diskutim dhe koment i fragmentit nga Tartufi	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përcakton vendin e Orgonit dhe Kleantit në këtë komedi. 2. Identifikon humorin në këtë fragment. 3. Përshkruan hapat e besueshmërisë e të verbërisë së Orgonit.		**Fjalët kyçe:** Rilindje, Orgoni, Kleanti.	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, koreografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti, ditari dypjesësh, Diagrami i Venit, praktikë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti

Nxënësit lexojnë fragmentin sipas roleve. Në këtë fragment Kleanti përpiqet t'i hapë sytë Orgonit në lidhje me Tartufin dhe i kërkon të mbajë premtimin për ta martuar Marjanën me të fejuarin e saj Valerin. Orgoni tregon arsyet që e kanë shtyrë ta sjellë Tartufin në shtëpi. Në këtë skenë mësojmë se si mashtruesi i djallëzuar Tartuf, duke shfrytëzuar ndjenjat fetare të Orgonit naiv, ka fituar besimin e tij.

Pas shpjegimit punojmë me pyetjet e rubrikës.

- Cili është vendi i Orgonit dhe i Kleantit në këtë komedi? Pse Kleanti quhet një personazh "ngacmues" për Orgonin? (Sepse ai mundohet t'i hapë sytë Orgonit në lidhje me Tartufin.)
- Ndiqni rrëfimin e Orgonit dhe përmes justifikimit të tij drejtuar Kleantit, thoni se çfarë po ndodh në të vërtetë në vepër?
- Identifikoni në këtë fragment humorin, si bosht i komedisë. A shkon ai deri në sarkazëm?

Orgoni
Në kishë vinte si shenjtor çdo ditë
Pa gjynjëzohej mu përpara meje
E falej me kaq zjarr e devocion
Sa gjithë kthenin sytë nga ai,
Binte në ekstaz'me shpirtin lart në qiell

- Ndryshe nga Orgoni që flet dhe e zbërthen vetë figurën e tij, natyra e Tartufit paraqitet vetëm nga fjalët e Orgonit. Si del në pah hipokrizia e tij dhe deri në ç'pikë shkon ajo?

Hapi i dytë: Ditari dypjesësh

Nxënësit komentojnë vargjet e mëposhtme duke nxjerrë në pah se cilin problem të kohës vë në lojë përmes tyre Molieri.

Vargjet	**Komenti**
E falej me kaq zjarr e devocion Sa gjithë kthenin sytë nga ai Binte në ekstaz' me shpirtin lart në qiell E ulej orë e çast e puthte dhenë	Nëpërmjet këtyre vargjeve autori kërkon të nxjerrë në pah një nga problemet kryesore që është hipokrizia etj.

Hapi i tretë: Diagrami i Venit

Nxënësit në bazë të fragmentit, por duke e vendosur brenda gjithë komedisë diskutojmë mbi dy personazhet e Orgonit dhe Kleantit.

Hapi i katërt: Praktikë e pavarur. Nxënësit punojnë vetë në mënyrë të pavarur me rubrikën fjala dhe përdorimi i saj. • Gjejnë shprehjet tipike që ndihmojnë në përftimin e qesharakes në fragment. Sa gjithë kthenin sytë nga ai/ Binte në ekstaz' me shpirtin lart në qiell/E ulej orë e çast e puthte dhenë • Gjejnë shprehje frazeologjike dhe shpjegojnë rolin e tyre për kuptueshmërinë e mesazhit të veprës. Shprehje frazeologjike: Në zemër do t'ju hynte, ma gjeti e mira derën, s'ja ndan sytë, më ruan nderin.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke vlerësuar disa prej tyre.
Detyrë: Diskutojnë nëse autori e shpalos qartazi fytyrën e vërtetë të Orgonit. Pse ai e bën haptazi dhe që në fillim këtë? Ka të bëjë kjo me strukturën e veprës dhe stilin e klasicistëve?

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Fragment Akti III, skena II, Akti IV, skena V		**Situata e të nxënit:** Koment dhe analizë vlerësuese e fragmentit	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Plotëson përmbajtjen e veprës përmes kësaj skene. 2. Përshkruan karakterin e Dorinës. 3. Shpjegon natyrën e Elmirës. 4. Shpjegon mesazhin e këtij fragmenti		**Fjalët kyçe:** *Tartufi, Dorina, Elmira, hapsanikët, zjarminë brenda etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti.		**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** historia, koreografia.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: lexim dhe shpjegim teksti, praktikë e drejtuar, praktikë e pavarur, lojë me role.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Lexim dhe shpjegim teksti

Lexohen me role fragmentet e shkëputura nga komedia.

Në skenën II Tartufi tregohet si një besimtar I madh, i rreptë me veten, që lutet e bën bamirësi, që e mundon trupin, duke bërë një jetë asketike, pa e përfillur hijeshinë femërore. Dorina e ka kuptuar që Tartufi kërkon të duket ndryshe nga ç'është, prandaj e ironizon dhe tallet me të, pastaj e njofton se zonja po vjen ta takojë.

Në skenën V, Elmira takon Tartufin, ndërkohë që Orgoni i fshehur ndjek bisedën mes tyre. Në këtë episod metateatral, Elmira pasi e bind "dhelprën e vjetër" për arsyet e qëndrimit të saj, i shpreh dashurinë por dhe frikën që ka nga njollosja e shkeljes së kurorës, prishja e shpirtit nga kryerja e mëkatit. Tartufi përpiqet ta bindë me faktin se mëkatet kur bëhen me qëllim të mirë dhe fshehtas nuk konsiderohen mëkate dhe se vetëm skandali përbën krim.

Më pas punojmë me pyetjet e studimit të tekstit.

- Cili moment i veprës jepet në skenën II dhe për çfarë dialogohet midis personazheve?
- Si nis këtu hipokrizia e Tartufit dhe ku mbaron?
- Si realizohet vetëdemaskimi i Tartufit këtu?
- Shpjegoni natyrën e Elmirës. Si i dredhon ajo synimit të Tartufit dhe si shfaqet personaliteti i saj para syve tanë?
- Me cilat fjalë dhe argumente kërkon Elmira të vërë me shpatulla pas murit Tartufin?
- Në cilat vargje demonstrohet arsyeja e vërtetë pse Elmira po bisedon në këtë mënyrë me Tartufin?

Oh! Ç'është ky nxitim i tepruar?!
Mos më shtyni që gjer sot në këtë pikë
Unë e di sa më erdhi që ju ç'faqa
Kjo dashuria juaj
Sillet tamam si një tiran i egër
më turbullon e ma prish mendjen fare
Dhe kësaj zemrës sime i vë krusmën

Hapi i dytë: Praktikë e drejtuar

Disa nga pikat e pyetjeve të të dy fragmenteve kërkojnë një analizë, për këtë arsye se bashku me nxënësit arrijmë të punojmë me to.

- Gjeni dhe shpjegoni fjalët që tregojnë " shenjtërinë"dhe më pas "donzhuanizmin" e Tartufit.

.



- Si ndikon qëndrimi ironik i Dorinës në qartësimin e situatës? Ku kalon në sarkazëm ironia e saj? *Çfarë shtinjaku e çfarë batakçiu!*
- Si ndryshon Tartufi këtu? Cilat cilësi të tij dalin në pah?
- (Tartufi ndryshe flet, ndryshe vepron, hiqet si një njeri që ka hequr dorë nga çdo e mirë tokësore, flet me kamxhik e grathore. Po këtu fillon të shfaqë fytyrën e vërtetë të hipokritit, lakmitarit, mosmirënjohësit etj.)

Hapi i tretë: Praktika e pavarur Nxënësit punojnë në fletore: • Shpjegojnë mesazhin e shprehjes: "Të mirën sa më pak ta meritosh, aq më shumë dyshon se ia arrin". • Gjeni disa mbiemra që Tartufi i vë figurës së Elmirës. (Zonjë e ëmbël). **Hapi i katërt:** Lojë në role Lexojmë fragmentet të ndarë në role. Pas dëgjimit vëmë re notat e humorit.
Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke vlerësuar disa prej tyre.
Detyrë: Përshkruani portretin e Tartufit nga fillimi deri në fund . Si ndryshon ai?

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	**Lënda:** Letërsi	**Klasa:** X	**Shkalla:** V
Rubrika: Klasicizmi **Tema mësimore:** Përsëritje		**Situata e të nxënit:** Punë me teskstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë 3. Kompetenca personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Përmend vendet dhe filozofitë mbi të cilat u ndërtua klasicizmi. 2. Krahason të përbashkëtat midis letërsisë antike dhe asaj klasiciste. 3. Analizon elementet klasiciste të veprave të Molierit, E. Haxhiademit etj.		**Fjalët kyçe:** *klasicizëm, rregulla e tri njësive, parimet, antikiteti, Molier, Rasin, La Fonten, Veset, Komedia, ironia etj.*	
Burimet: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, foto, piktura të ndryshme, shkumësa me ngjyra etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia, piktura, muzika.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, stuhi mendimesh, pema e mendimit, lexim, punë e drejtuar, ditari dypjesësh, punë e pavarur.			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi i parë: Pyetje përgjigje

Mësuesja i drejton pyetje klasës.

- Cilat ishin vendet dhe filozofitë mbi të cilat u ndërtua klasicizmi? Si e mori emrin "shekulli i artë"koha në të cilën lulëzoi ky llojn arti?
- Megjithëse u mbështet në rregulla të ngurta, filozofia e klasicizmit u botua në veprën" Arti poetik" të Nikola Bualoit, vetëm pasi veprat e klasicistëve të mëdhenj ishin botuar dhe vënë në skenë. Ç'tregon kjo?
- A zbatohen rregullat e klasicizmit në komedinë Tartuf?
- Si u zbatuan këto rregulla te shkrimtarët e mëdhenj: Korneji, La Fonten, Rasin?
- Si zbulohet personazhi i Tartufit në vepër?

Hapi i dytë: Analizë përmes shembujve.

Në këtë rubrikë nxënësit jo vetëm japin përgjigje por edhe e ilustrojnë atë me shembuj.

- Shpjegoni raportin që vendoset midis temave me karakter universal dhe veprimeve të personazheve.
- Krahasoni të përbashkëtat midis letërsisë antike dhe asaj klasiciste.
- Diskutoni mbi konceptin moralizues të veprave. A e dëmtoi artin fakti që u kthye në një shkollë virtyti?

Hapi i tretë. Reflektim kuptimor. Analizojmë veprën Tartufi duke diskutuar dhe reflektuar mbi të.

zgjedhja	argumenti
Nëse do të zgjidhnit të ishit një interpretues në veprën e Molierit, cilin personazh do të luanit?	

Hapi i katërt: Diskutim

Diskutojmë së bashku me nxënësit mbi:

- gjuhën dialoguese në veprën Tartufi;
- ironinë në përballjen me të vërtetën dhe dramën njerëzore;
- karakterin popullor të veprës së Molierit.

Vlerësimi: Në fund të orës së mësimit bëhet një përmbledhje e njohurive që morëm së bashku me nxënësit duke vlerësuar shumë prej tyre.

Detyrë: Teatri i Molierit është një nga shkollat më të ndritura: ideore, interpretuese dhe skenike.

- Zgjidhni një vepër të Molierit që ju tërheq më shumë. Interpretoni në klasë një prej skenave të saj.

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</td><td>Lënda: Letërsi</td><td>Klasa: X</td><td>Shkalla: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rubrika: Klasicizmi
Tema mësimore: Test kontrolli</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Testim</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:
1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
3. Kompetenca personale</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:
1. Trajton tiparet kryesore të klasicizmit dhe rregullat e tij.
2. Analizon veprën dhe rolin e Molierit në letërsinë botërore.
3. Vlerëson donkishotizmin edhe si dukuri bashkëkohore.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe: klasicizmi, rregulla e tri njësive, antikiteti, veset e shoqërisë, ironia, e qeshura etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i nxënësit, shënime të mbajtura gjatë këtij moduli, material filmike, interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: historia, gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutim, stuhi mendimesh, pema e mendimit, lexim, punë e drejtuar , punë e pavarur.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit
Testi ka pyetje me alternativë dhe me pyetje të hapura.
Pyetjet bëhet me sistem pikëzimi .
Testi ka një fragment nga Tartufi dhe pyetjet ngrihen rreth tij.
Testi mat aftësitë e nxënësve në disa drejtime dhe fusha
Testi duhet të zhvillohet brenda 40 minutave.
Pas testit diskutohet për vështirësi dhe paqartësi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Në fund të orës së testit nxënësit vlerësohen të gjithë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrë: Diskutohet mbi përgjigjet e testit, vështirësitë dhe paqartësitë.</td></tr>
</table>

Model Testi 1

Euripidi

Medea
(fragment)

Kori

Grua fatkeqe!
Medet! Medet!
Je një e mjerë
me dhembje plot!
Nga t'ia mbash?
Te cili mik
ose shtëpi,
në ç'tokë vallë
ke për të gjetur
shpëtim nga vuajtjet?
Në këtë dallgë
aq të tmeruar
dhe plot mjerime,
nonjë nga hyjtë
Mede, të hodhi.

Medea

Keq për mua punët nga të gjitha anët;
kush do thotë"jo"?
Po kështu nga Hera-mos besoni kurrë-
s'kanë për të shkuar.
Ka akoma luftëra për nusen e dhëndrrin.
dhembje, hidhërime për vjehrën e vjehrin.
A kujton se unë këtij nonjë herë
do t'i flisnja me fjalë me përkëdheli,
po të mos shpresoja të fitoja diçka
ose t'i kurdisnja mirë ndonjë plan?
Jo, nuk do t'i flisnja, as edhe me dorë
Nukë do ta preknja. Po ky është bërë
aqë i çkalluar, sa që ndonse mundte
të më nxirrte jashtë nga ky vend këtu
dhe t'i prishte fare planet që kam bërë,
për sot më dha leje të qëndroj këtu;
sot të tre armiqtë do t'i shtrij të vdekur:
atin me të bijën edhe burrin tim.

Kam shumë mënyra shpirtin t'ua marr,
po s'e di, moj shoqe, cilën nga këto
të përdor më parë; s'di se si të bëj;

Hajde, pra , Mede!
Mos lë pa përdorur gjith' ato mënyra
që i ke mësuar; ecë gjer në fund;
ja kjo është dita që kërkon kurajë.
Nuk shikon se ç'vuan? Dasma e Jasonit,
dasm' e Sisifidve, s'duhet kurrsesi
të t'bëj qesharake, ty që ke një atë
tepër të dëgjuar, që ke stërgjysh Djellin.
A po s'je e ditur? gratë, ne pastaj
prej natyre jemi shumë të pa afta
për nonjë të mirë, ndërsa për të liga
jemi vetë dora.

(Medea hiqet më nj'anë dhe qëndron aty pa nxjerrë zë nga goja).

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Medea është një vepër e gjinisë: 1 pikë

A) epike;
B) lirike;
C) lirike-epike;
D) dramatike.

2. Subjektin mitik Euripidi në veprat e tij: 1 pikë

A) e ndryshon duke ia përshtatur domethënies dhe mesazhit që ai dëshiron të japë;
B) e ndryshon në përshtatje vetëm me idenë e që të mos jetë si paraardhësit;
C) nuk e ndryshon subjektin mitik në asnjë rast;
D) nuk e ndryshon subjektin mitik vetëm në rastin e Medeas.

3. Personazhet në veprën e Euripidit paraqiten: 1 pikë

A) siç janë në realitet;
B) siç bëheshin në jetën e përtejme;
C) siç kishin qenë në të shkuarën;
D) si simbolikë thjeshtë hyjnore.

4. Togfjalëshi *Grua fatkeqe!* formohet nga: 1 pikë

A) emër + mbiemër;
B) mbiemër + përemër;
C) folje + ndajfolje;
D) emër + përemër.

5. Si zgjidhje për problemin e saj Medea shtron: 1 pikë

A) hakmarrjen;
B) marrëveshjen;
C) harresën;
D) durimin apo përshtatjen.

6. Medea plot urrejtje të mbushur duket më shumë te shprehja: 1 pikë

A) kam shumë mënyra, shpirtin tua marr;
B) keq për mua punët nga të gjitha anët;
C) do t'i flisnja me fjalë me përkëdheli;
D) ose t'i kurdisnja mirë ndonjë plan.

7. Mesazhi që përcjell Eruripidi në këtë vepër është: 1 pikë

A) Mbroni virtytet, lidhjet, familjen, mirënjohjen.
B) Urreni dëshirën për pushtet.
C) Admironi madhështinë e mbretit.
D) Asgjë nuk ndryshon, nëse nuk ndryshojnë fëmijët.

8. Çfarë ndjell fjala: *Medet?* 1 pikë

9. Në cilin mit u mbështet Euripidi për të shkruar veprën Medea?
A e ka ndryshuar subjektin mitik mbi të cilin është mbështetur në këtë tragjedi Euripidi?
Pse? Ç'tipar i dha ky element veprës së tij? 3 pikë

a. _____

b. _____

_____

_____

c. _____

10. Si vjen konflikti më këtë vepër? Po në këtë fragment? Identifikoni dy momente të këtij

konflikti duke veçuar pikë kulminante të tij. Pse ajo konsiderohet e tillë? 4 pikë

a._____

_____

b. _____ _____

c. _____

11. Si paraqitet bota e brendshme e Medeas në këtë fragment? Gjeni dy detaje që e tregojnë këtë. Pse ajo ndodhet në këtë situatë? Ç'përfaqëson Medea? 4 pikë

a. _____

_____

b. _____ _____

c. _____

d. _____

_____

12. Si jepen lidhjet midis personazhit dhe veprimeve që ai kryen? Cili është qëndrimi i tragjedianit të madh për këtë? Ku duket kjo në këtë fragment? 3 pikë

a. _____

b. _____

c. _____

13. Nga e huazoi Euripidi elementin e korit? Cilat janë informacionet bazë që merren nga kënga e korit? Ç'efekt kanë ato? 3 pikë

a. _____

b. _____

_____

c. _____

_____

14. Kush i drejton fatin e njeriut në antikitet. Ku duket kjo? 2 pikë

_____ _____

15. Si e kuptoni faktin që subjekti i veprës Medea është i ngjeshur? Shembull. 2 pikë

_____ _____

16. Gjeni dhe shpjegoni këtu dy elementë të gjinisë dramatike dhe argumentoni rolin e tyre në fuksion të ideve të autorit. 3 pikë

a. _____ _____

b. _____

17. Ese:
Argumentoni pse Medea është vepër e pasionit. 8 pikë
Argumentoni rolin ndikues në jetë të pasioneve negative te njeriu.
Krahasoni Medean me një figurë tjetër femërore nga letërsia

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët	1	1	1	1	1	1	1	1	3
Pyetja	10	11	12	13	14	15	16	17	**Gjithsej**
Pikët	4	4	3	3	2	2	3	8	**40 pikë**

Model Testi 2

Gjegj Elez Alia
(fragment)

Qat'herë trimi a'nisë me dredhë tu shpija
Edhe shokt'të gjith m'i ka bashkue:
"Po ndigjoni, more shokt' e mij:
Falë u kofshin sarajet e mija,
Falë u kofshin tanë paret e mija,
E u koftë falë krejt malli e gjaja e shpisë,
- amanet motra e Gjergj Elez Alisë!"
Edhe shtatit trim i paska dhanun
Motërzezën ngrykas kesh me u marrun,
Të dy zemrat priherë po janë ndalun!
Gjamë të madhe shokët qi kanë ba,
Po ia cilin një vorr t'bukur t'gjanë,
Vlla e motër ngrykas për me i xanë.
E i muranë t'bukur e kanë mbarue,
Vlla e motër kurr mos me u harrue.
E i bli t'bukur qi m'ia vndajnë tu kryet,
Zogu i verës gjithmonë me pushue.

Kur ka nisun mali me u dushkue,
A ndalë qyqja n'muranë t'vorrit t'ri!
Ka gjetë blinin të tanë degash tha.
Ka flurue përmbi' i Saraj të zi,
Ka gjetë kulmin të tanë shembë përdhe.
M'nji prezor si m'paska hypë
Ka përbe shtegtarin kah po shkon:
"amanet, more shtegtari i malit,
N'kofsh tuj kndue ksajt, kajkën për me e pushue
N'kofsh tu' kajtë ksajt, gjamën për me e xanë!
Kah verova gjithkund vrri e n'vrri.
Kah mjerova gjithkund shpi e n'shpi,
Kërkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali!"

1- Gjergj Elez Alia është: 1 pikë

A) kënga hyrëse e ciklit të kreshnikëve;
B) kënga hyrëse e këngëve të historisë;
C) kënga mbyllëse e këngëve të dasmave;
D) kënga hyrëse e këngëve të motmotit.

2- Gjergj Elez Alia është personazhi që: 1 pikë

A) lufton për atdhe dhe për familje;
B) lufton për pasuri;
C) lufton për të ruajtur historinë;
D) lufton për të parët e këtij vendi.

3. Këngëtari popullor thotë: trim mbi trima Gjergj Elez Alia sepse: 1 pikë

A) vlerëson mbijetesën e Gjergjit në raport me vuajtjen dhe angazhimin;
B) vlerëson fjalët që Gjergji i thotë Bajlozit;
c) vlerëson situatën kur ai flet me të motrën;
D) vlerëson faktin që ai godet në shenjë.

4. Hiperbolizimin si tipar artistik të Ciklit të Kreshnikëve gjendet në: 1 pikë

A) faktin që Gjegj Elez Alia fiton me Bajlozin megjithëse ka 9 plagë;
B) faktin qe ai del për hir të dashurisë për të motrën;
C) faktin që atij ia kërkojnë këtë dyluftim;
D) faktin që ai edhe mund të vdesë duke luftuar.

5. Mënyra e dhënies së subjektit këtu është: 1 pikë

A) zhveshja nga ngjarjet e parëndësishme;
B) zhveshja nga figuracioni;
C) dhënia vetëm e një motivi kryesor;
D) dhënia e çdo elementi të subjektit.

6. Në cilën mënyrë është folja *m'paska hypë?* 1 pikë

A) Habitore.
B) Dëftore.
C) Urdhërore.
D) Dëshirore.

7. Cilës klase fjalësh i përket fjala *gjithmonë:* 1 pikë

A) Emër.
B) Ndajfolje.
C) Folje.
D) Përemër.

8. Mesazhi në vargun e fundit është: 1 pikë

A) Gjergji ishte trim mbi trima, me një nam fantastik.
B) Gjergji nuk do të kujtohej gjatë.
C) në çdo krahinë kishte nga një Gjergj trim.
D) askush nuk e njihte Gjergj Elez Alia.

9. Çfarë jepet në pjesën e parë të fragmentit? Jepeni me një fjali të përbërë kuptimin për të. 2 pikë

a. _____

b. _____

10. Cili është detaji që tregon se tashmë është stinë e vyshkun? 1 pikë

_____

11. Cila është arsyeja pse ai u drejtohet shokëve? Cilat janë momentet kyçe të subjektit të këngës? 4 pikë

- _____
- _____ _____ _____

12. Gjeni anaforën dhe aliteracionin në fragment dhe shpjegoni rolin e tyre. 3 pikë

- _____
- _____
- _____

  _____

13. Ç'lloj ligjërate është përdorur te vargu: "Po ndigjoni, more shokt' e mij"? Shpjegoni funksionin e saj nëpërmjet shembullit. 2 pikë

- _____
- _____

14. Përshkruani me fjalët tuaja ndonjë tregues të traditës popullore në këtë fragment dhe argumentoni rolin e tyre në këtë trashëgimi. 2 pikë

15. Ese: I-III 8 pikë

Koncepti i të jetuarit në kujtesën e njerëzve dhe të kohës është një koncept i njohur edhe sot. Në gjuhën popullore thuhet: që të mbahesh mend për mirë duhet të kryesh vepra të mira.
Argumentoni këto dy koncepte.
Argumentoni peshën e amanetit në këtë fragment, nisur edhe nga tradita popullore.
Përshkruani gjendjen e Gjergjit në këtë fragment.
Krahasoni Gjergj Elez Alinë me figurën e Mujit.
Argumentoni kontributin madhështor të figurës së Gjergjit nisur edhe nga vargu I fundit:
Kërkund s'ndesha n'Gjergj Elez Ali!"
Përshkruani tiparin e veçantë të Gjergjit në këngën e Gjergj Elez Alisë.

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët	1	1	1	1	1	1	1	1	2
Pyetja	10	11	12	13	14	15	**Gjithsej**		
Pikët	1	4	3	2	2	8	**30**		

Model Testi 3

Dante Aligieri

Komedia Hyjnore –Ferri
(fragment)

Kont Ugolini

Gojën e hoq nga gjella shtazarake 1
Aj mkatar, pas flokësh tue ia fshimë
Kokës krisë grisë përmbrapa në rradake.

Pastaj filloi: ”Ti m’lyp me përtërimë 4
Dhimbjen –dëshpërim që zemrën ma copton.
Edhe pa folë, veç sa e kujtoj një grimë.

Po n’asht se fjala ime e turpnon 7
Këtë tradhtar që unë këtu po brej.
Tue folë edhe tue qa tash po m’ndigjon.

S’po dij se kush je ti; as pse këtej 10
Na paske ramë, por thjeshtë prej fjorentini
më ngjan kjo gjuha jote tek ta ndjej.

Ta dijsh se unë kam qenë Kont Ugolini, 13
E ky këtu qe kryepeshkop Rugjeri:
Tash po ta them pse iu kam ba ksi fqini.

Nuk ka nevojë ta them se unë i mjeri 16
Pata besim te ky shpirtzi, pa m’zunë,
E mbasandej më vranë; porse të bjeri

Në vesh ty s’do të ketë mundun veç nji punë, 19
Due t’them se ç’m’erdhi e zezë vdekja mizore;
Ndigjoje pra, dhe thuej a m’ka ba dhunë.

Mbrenda kuvlisë e vogëla dritore, 22
S’cilës prej meje i mbeti kullë urije,
E ku të tjerë kanë për t’u mbyllun prore.

Aq hanë mue shfaqë m’i kishte prej frangjije 25
Kur pashë andrrën e ligë, e soje m’ra

I s'ardhmes tisi grisun fije-fije.

Prijs e zot gjahu n'andërr ky m'u gja 28
Tue ndjekë nji ujk e klyshët tyne përmbrapa
N'at mal që Pizë e Lukë s'i len me u pa.

Me bushtra thatanike, t'zellshme e t'prapa, 31
Gualandat me Sismondët e lanfrangët
Prijshin përpara me të shpjetëm hapa.

Mbas nji grimë vrapi forca u erdhi mangët 34
Atit e bijve, e at-hera m'u ka dukë
Se fill jau futën n'ijtë çatajt e vangët....

1. Kjo pjesë u shkrua: 1 pikë

A) në latinisht;
B) në latinishte vulgare;
C) në italishte letrare;
D) në italishte vulgare.

2. Marrëdhënia e Ugolinit me Rugjerin në Ferr është pasojë e: 1 pikë

A) miqësisë së madhe
B) besimit të patundur
C) tradhtisë për pushtet
D) fqinjësisë së mirë

3. "*Mbasandej*" është fjalë: 1 pikë

A) e parme;
B) e prejardhur;
C) e përbërë;
D) e përngjitur.

4. Për hir të ritmit, rendi i fjalëve në fjali është shpesh: 1 pikë

A) i drejtë;
B) i përmbysur;
C) i ngulitur;
D) linear.

5. Figura kryesore mbi të cilën bazohet "Ferri" është: 1 pikë

A) alegoria;
B) personifikimi;
C) simboli;
D) metafora.

6. Fjala "*I mjeri!*" në vargun 16 është: 1 pikë

A) emër i shquar;
B) emër i pashquar;
C) mbiemër i shquar;
D) mbiemër i pashquar.

7. Tercinat janë përdorur për të simbolizuar: 1 pikë

A) mendësinë mesjetare të kohës;
B) mendësinë humaniste të kohës;
C) besimin në botën e përtejme;
D) Trinitetin e Shenjtë.

8. Cilësimet "e zezë" dhe "mizore" përcaktojnë: 1 pikë

A) kuvlinë
B) bushtrat
C) vdekjen
D) jetën

9. E folmja me të cilën Dante u drejtohet personazheve në "Ferr" është ajo _____
1 pikë

10. A arrini ta urreni Kont Ugolinin? Argumentoni pse?
2 pikë

_____

_____

11. Identifikoni të paktën 3 fjalë në pjesë, që ndryshojnë nga standardi i gjuhës së sotme shqipe. Evidentoji dhe përkrah vendos trajtën e rregullt. 3 pikë

a. _____ _____

b. _____ _____

c. _____ _____

12. **Plotëso tabelën: II** 2 pikë

Nr	Pjesa e zgjedhur	Çfarë figure stilistike është?
1	Zemrën ma copëton	
2	E zezë vdekja	

13. Renditni tri tipare humaniste, duke i ilustruar me pjesë nga teksti. I-III 4 pikë

- _____
- _____
- _____
- _____ _____ _____

14. Cilët janë dy elementet që krijojnë klimën mesjetare në veprën e Dantes? III Si jepet kjo klimë? 3 pikë

_____ _____

_____

15. Shpjegoni simbolikën e ëndrrës që sheh Kont Ugolini. Çfarë funksioni ka ajo?Veçoni shembullin nga fragmenti.

3 pikë

* _____

* _____

* _____

16. Gjeni në tekst dy cilësime të Ugolinit për Rugjerin, që shprehin qëndrimin e tij ndaj krye peshkopit. 2 pikë

_____ _____

Vini në dukje edhe mënyrën se si Ugolini e cilëson veten në ferr. 1 pikë

_____

17. Gjeni sinonimet kontekstuale të disa fjalëve në tekst: III 3 pikë

_____ _____

18 Ese: 8 pikë

Argumentoni pse Ferri konsiderohet si gjykimi i përjetshëm.
Përshkruani ndjesinë që përftoni nga udhëtimi në ferrin dantesk.
Krahasoni dy ndjenja që personazhet përjetojnë në Ferr.

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Pyetja	10	11	12	13	14	15	16	17	18
Pikët	2	3	2	4	3	3	2	3	8
Pikët gjithsej	**40**								